


Acta non verba

KÊN2

revistë e përvitshme kritike

V • 2021



Michigan

KÊNS - V/2021

▪ *revistë e përvitshme kritike* ▪

Botues:

Lisandri & Aristea Kola

Kryeredaktore:

Aristea Kola

Zv/kryeredaktor:

Fra Censor Ambrozi

Komisia shkencore:

Adrian Deva, Arben Prendi, Carrie Ann Morgan, Çezarin Toma, Eljon
Doçe, Erenestina Gjergji Halili, Marsel Nilaj, Michael Galaty

Në ballinë:

Arshi Pipa

© përpunim fotografik nga Silentius Plenus,

E-mail:

revistakens@gmail.com

© Këns: L. & A. Kola

Ann Arbor, Michigan

ISSN: 2521-7348



Dhetor 2021

KENS

Parathanie

Kêns-V/2021, asht konceptue si numër që pasqyron aktet e Simpoziumit Ndërkombtar me rastin e 100-vjetorit të Lindjes së Arshi Pipës (1920-2020), mbajtë më 12 dhjetor, 2020.* Komisioni organizues, përba prej Mithat Gashit, Ariste Kolës, Lisandri Kolës, Elton Marës dhe Armin Zotajt, mbërriti me përmbyllë me sukses një takim virtual mes studiuesish, ku u veçuen kontributet e shumta të Prof. Pipës si autor dhe studiues. Ky takim u ba i mundun falë ngulmimit të grupit organizues si dhe dashamirësisë së ligjëruesve, në një kohë kur disa katedra letërsie e albanologjie (mbrenda dhe jashtë Shqipërie), e neglizhuen ftesën e këtij eventi. Shteti shqiptar, natyrisht ishte ma në letargji se kurrë në lidhje me këtë jubile. Tek-tuk ndonji organizim sporadik, si gati-tinzash, jehoi dhe vdiq mbrenda pak orësh nëpër mediat shqiptare, tue e legjitimue edhe ma shumë mosekzistencën e një Akademie Shkencash, e cila vijon me sukses programin e hoxhalisë. Por natyrisht Pipa, sikurse dy a tre autorë të tjerë të letërsisë shqipe, mbledhin pak rreth vetes për shkak të veprës së tyre, e cila e tejkalon pellgun kulturor të Shqipërisë.

Numri V i *Kênsit*, asht konceptue në tri boshte: Sesiioni I (*Arshi Pipa, 1920-2020*), Sesiioni II (*Pipa-Arkiv*) dhe Optikon.

Në Sesiionin I të këtij numri, nuk janë përfshî të gjitha ligjëratat e mbajtura në Simpoziumin Jubilar, për shkak se disa kumtesa tashma ishin botue në vende të tjera dhe natyrisht mund të aksesohen prej organeve ku janë ba të

* <https://cla.umn.edu/french-italian/events/international-symposium-100th-anniversary-birth-arshi-pipa>

mundshme për publikun. Redaksia e kësaj reviste, asht vû në kontakt me autorë të tjerë ndërkohë, ku disa prej tyne i janë përgjigjë pozitivisht ftesës për pjesëmarrjen në këtë numër. Të gjithë autorëve në Sesionin I si edhe në Optikon, u shprehim mirënjohjen tonë ma të thellë, për kontributin dhe përkushtimin e tyne ndaj figurës së Pipës.

Në këtë sesion të parë, përfshihet artikulli i Agron Tufës, *Kredoja e mbijetesës me muzat (Mbi raportin e poetit Arshi Pipa me Muzat)*, një shkrim mbi produktin poetik të Arshi Pipës, sikurse janë edhe shkrimet e Anton Nikë Berishës, *Rreth dy krijimeve poetike tronditëse të Arshi Pipës (Poezisë "Kosovës" dhe poemës "Kanali")*, Ariste Kolës, *Giordano Bruno, mnemopoezia që aludon diktaturën dhe rezistencën intelektuale*, Veron Dobroshit, *Topika simboliste në fantazinat e Arshi Pipës* dhe i Lisandri Kolës [poezi e çështje përkthimi njëherësh], *Me përkthye poezinë e Arshi Pipës në gjuhën shqipe: sfida përvojtnie*. Të gjitha këto punime, ndërtojnë një hartë studimore mbi veprën poetike të A. Pipës, për fatin e keq kategoria ma e mohueme në kritikën e përgjithshme shqipe mbi këtë autor të fundit. Ndërsa artikulli i Matteo Mandalà-s *Arshi Pipa midis arbëreshëve sicilianë* dhe i Michelangelo La Luna-s *Arshi Pipa and Girolamo De Rada*, sjellin ndërlihdjen—jo vetëm studimore—e Pipës me botën e mrekullueshme arbëreshe: e vetmja botë e lejueshme e kontaktit fizik e shpirtnor për diasporën shqiptare, e sidomos për ata që ishin arratisë, "tradhtarët e atdheut". Raportin në fushën e gjuhësisë, si dhe të politikës gjuhësore gjatë stalinizmit shqiptar, e paraqet ma së miri shkrimi i Albana Deda (Ndojës): *Pse vazhdon me u t'huejtë Arshi Pipa?*, i cili në këtë prag 50-vjetori të Kongresit dhe të "gjuhës së njësuar" (1972), besojmë se ka me zgjue interes akademik në mos (parakuptueshëm) heshtje

totale. Gjithashtu dimensionin kritik, atë ma esencialin, në veprën e Arshi Pipës e paraqesin shkrimet e Vehbi Miftarit *Arshi Pipa: Noli vs Konica* dhe të Lisandri & Aristea Kolës *Kur dy ma të mëdhajt i bashkon një breshkë*. Në këtë vështrim përgjithësues, vepra shumëkajshe e A. P., mendojmë se del e trajtueme dhe propozon një kritikë alternative, e largueme prej sfondit monokrom (post)monist.

Sesionit II *Pipa-Arkiv* i paraprin një nënsesion *Vështrime, në të cilin janë bënë pjesë tri recensa të Anton Logorecit*, përkthye në shqip, mbi veprën e Arshi Pipës, një që mban titullin *Gjymtimi i Gjuhës* (mbi *The Politics of Language in Socialist Albanian*) dhe dy të tjera mbi *Rushën* dhe *Meridianën*. Gjithashtu asht përfshirë artikulli i hershëm me vlerë i Prof. David Lukës mbi qëndrimet e Arshi Pipës në raport me standardin e gjuhës shqipe, *Pikëpamjet e Prof. Arshi Pipës për shqipen standard*.

Në *Kritikë*, ban pjesë një studim i gjatë dhe i randësishëm i Pipës mbi humanizmin arbëresh (*Humanistë arbëreshë*). Zani bibliografik, përfshin kolonën mbi Gjergj Fishtën përpilue për *The Columbia Dictionary of Modern European Literature* (1980) nga A.P., ndërkohë që Shqipëria komuniste e kishte ekskomunikue Fishtën prej 35 vjetësh. Për ma shumë shpjegime shih *Shënimin*, që i prir tekstit. Në *Poezi* asht përzgjedhë cikli sonetor *Giordano Bruno*, një projektion vetautorial, mendojmë, në figurën e famshme të filozofit dominikan. Asht pá me vend me përkthye, e botue, disa *Letra të dërgueme shtetarëve të ndryshëm* (kryesisht amerikanë) nga A. Pipa, gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të *Vatrës* ose para asaj kohe. Siç e shpjegon edhe vetë Pipa, në *Shtojcë*, njëviti i ushtrimit të asaj detyre ishte kohë e bjerrun për punën e tij, por gjithsesi ai kishte mbërritë me themelue disa parakushte funksionale të *Federatës*, cilësi

që ishin zbehë qysh asokohe kur Konitza propozonte që kjo federatë të mbyllej. Jemi të bindun, se ajo kohë e shkurtë mes peripevice dhe intrigave ka qenë për Pipën si me qenë “tue hangër tallash”, e padyshim ma lehtë do ta ketë pasë me drejtue Katedrën në University of Minnesota sesa punët e çorientueme të Vatrës (referue dëshmime të tij). Theksojmë, se dëshmia e tij botue në *Albanica*-n e vet, flet për standarde organizative dhe pluraliste, mes “aventurave” të papërshtatshme as për karrierën akademike të tij por as për moshën.

Optikon paraqet një përzgjedhje të kontributit të studentëve [VA 2021-22] të kursit *Albanian Literature of Exile*, ligjërue prej L. Kolës, në University of Michigan, Ann Arbor, mbi punën e Arshi Pipës. Këto shkrime kanë në fokus analizat e artikujve kritikë të Pipës, kryesisht mbi Kosovën (Alexis Elizabeth Junçaj, *The Era Before The War*; Selma Zuhrić, *Kosovo in Question*) dhe situatën politike, gjatë regjimit komunist në Shqipni (Avi Patel, *The Darkest Era in Albanian History*). Në këtë përzgjedhje ban pjesë edhe një analizë e recensës së Pipës mbi veprën e E. H., *Titistët* (Maria Mejia, *Analysis of Arshi Pipa's 'Enver Hoxha, The Titoites'*).

Po e mbyllim këtë *Parathanie* tue sjellë në vëmendje—për institucionet akademike shqiptare si edhe ato albanologjike jashtë Shqipnie, kishim me shtue—pohimin aktual të Anton Logorecit: “Unë besoj se Shqipnia ka me këndë njëmend e lirë kur popullsia e saj ka me këndë e aftë me lexue, studiue e vlerësue veprat e shkrimtarëve me cilësi të naltë si Arshi Pipa.”

▪ redaksia ▪

KENS

- Sessioni I / *Arshi Pipa, 1920-2020*

- Agron Tufa
- Albana Deda (Ndoja)
- Anton Nikë Berisha
- Aristeia Kola
- Lisandri & Aristeia Kola
- Lisandri Kola
- Matteo Mandalà
- Michelangelo La Luna
- Vehbi Miftari
- Veron Dobroshti



AGRON TUFA

KREDOJA E MBIJETESËS ME MUZAT

(Mbi raportin e poetit Arshi Pipa me Muzat)

Parafjalë

Arti poetik, por edhe dijet e Arshi Pipës mbetën, për fat të keq, ende jashtë e larg auditorëve tonë, pikërisht në kohën e urisë sonë për dije. Sa më shumë kridhesh në universin artistik por dhe shkencor të Arshi Pipës, ndjen pikëllim e keqardhje për shkak të atij fataliteti të madh që quhet “fatum historik”. Kjo të bën të mendosh me keqardhje, se çfarë mrekullie do të kishte qenë, fjala vjen, ta kishe profesor në vendin tënd, atë që ligjëronte në Universitetet e Amerikës! Që në vend të Nasho Jorgaqëve e ish sigurimsave të ngjashëm, nga foltorja e auditorëve të Universiteteve tona të na ligjëronte vetë prof. Arshi Pipa.

Ndërprerja dhe skllavërimi i procesit letrar

Në dinamikën e zhvillimit të kulturës, nocionet e “ndërprerjes” dhe “mosndërprerjes”, ashtu siç i trajton semiologu rus Jurij Llotman, përcaktojnë fatin e “shpërthimit” kulturor individual dhe jashtë-individual, përderisa ato shtjellohen në një hapësirë sinkrone. Mekanizmat që i rregullojnë këto procese janë përcaktuese në vijimësinë apo në ndërprerjen e “bumit” kulturor.

Mekanizmat që instaloi në Shqipëri diktatura komuniste e ndërprejnë vijimësinë procesuale të zhvillimit të natyrshëm kulturor e letrar të viteve 1920-1944, duke e deformuar, tjetërsuar dhe nënshtruar atë. Rrjedhimisht,

duke e ndryshuar tërë tablonë e saj. Si proceset graduale, si ato shpërthyes – në një strukturë që punon në sinkron – përmbushin funksione të rëndësishme: njëra palë mundëson novatorizmin, ndërsa tjetra – trashëgiminë. Në kuadër të tablosë kulturore Arshi Pipa ishte, padyshim, një rast i rrallë, i cili po gërshetonte bukur të dy elementët, si trashëgiminë e traditës, ashtu dhe novatorizmin nga përvoja e poetikave të huaja. Duke e parë botën poetike të krijimtarisë së hershme të Pipës si asimilim përvojash gjatë përsosjes së vokacionit dhe instrumentarit poetik, për historianin e letërsisë është shumë e rëndësishme të shtrohet hipoteza e varianteve të mundshme të ecurisë së kësaj poetike, duke patur parasysh nocionet e parashikueshmërisë dhe paparashikueshmërisë. Vështrimi retrospektiv i lejon historianit ta shqyrtojë të shkuarën nga dy pikëpamje: *a*) duke u gjendur në të ardhmen në lidhje me ngjarjen apo dukurinë e përshkruar (ai e ka para syve gjithë zinxhirin e ngjarjeve të ndodhura); *b*) duke u zhvendosur me mendje në të shkuarën (duke parë nga e shkuara në të ardhmen), ai i di tashmë rezultatet e procesit.

Në përshkrimin e varianteve të mundshme e të ardhshme të poetikës së Pipës, edhe me aq sa përshkruam më lart, na dalin një tufë mundësish për një trajektore të mëtejshme të evolucionit të tij poetiko-estetik, deri në momentin e arrestimit, dhe mandej, të burgut dhe të arratisjes, apo thënë në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe tej-individuale, – deri në momentin e instalimit të diktaturës ideologjike komuniste, e cila ndërhynte dhunshëm në proces, duke e ndërprerë atë.

Kontributin letrar të Pipës, poezinë, deri tek botimi i vëllimit të tij të parë *Lundërtarë* (1944) unë e shoh si një “shpërthim”, në kuadrin e përgjithshme të poezisë së viteve ’30-40. Dhe logjika e “bumit” kulturor parakupton një zinxhir të tërë “shpërthimesh” që pasojnë, konkretisht, vijimësi të bumit letrar me pena të tjera të reja, që marrin nxitje nga “shpërthimi i parë”, ashtu siç

ndodh shpesh në dinamikat letrare të epokave (Dante dhe plejada, Pushkini dhe plejada, etj.).

Ndërhyrja e dhunës shtetërore në proces, menjëherë pas instalimit të diktaturës, ishte një situatë e paparashikuar. Nga kjo edhe vetë karakteri i situatës letrare të deriatëhershme u transformua radikalisht. Duhet nënvizuar, se vështirimi nga e shkuara në të ardhmen – nga njëra anë, dhe nga e ardhmja në të shkuarën – nga ana tjetër, e ndryshojnë thelbësisht objektin e shqyrtuar. Kur shohim nga e shkuara në të ardhmen, ne e shohim të tashmen si një radhë të tërë mundësish me gjasa të barabarta. Kur shohim në të shkuarën, realja për ne përfton statusin e faktit, dhe ne priremi të shohim në të diçka të vetme të mundshme. Mundësitë e perealizuara shndërrohen për ne në të tilla, që fatalisht nuk arritën të realizohen. Ato përftojnë natyrë efemere.

Historia e Arshi Pipës, gjyqet dhe burgjet, mandej arratisja dhe jeta e mëtejshme në emigrim, pikërisht në prapun e shpërthimit të tij poetik, sigurisht që e denatyroi procesin e “ars poetica” të tij, mahnitë e tij estetike, kadencat klasike me supersticionin plazmik shqiptar, – një pentagram të cilën ai, me dijet dhe virtuozeitetin e dëshmuar, mund ta përsoste deri në latimet më të rafinuara. Por kjo erdhi si pasojë e faktorit të jashtëm (jashtë vullnetit të tij), megjithëse ka vend të themi edhe si pasojë e vetë natyrës së pakompromis të Pipës ndaj komunizmit. Se mund të kishte vepruar dhe ndryshe, sikundër jo pak pena u rekrutuan. Porse këtu duhet bërë një dallim i madh, parimor dhe thelbësor: Arshi Pipa ishte i zgjedhuri i Muzave, shërbëtor vetëm i tyre, dhe siç e dëshmoi gjithë jeta e tij në burg e mërgim, i askujt tjetër. Pikërisht në besnikërinë e tij ndaj Muzave do të ndalemi.

Çfarë janë Muzat?

Marrëdhënia e poetit me muzat është një traditë tepër e lashtë dhe e pandërprerë, duke marrë konotacione të ndryshme në tradita të ndryshme letrare, shpesh duke shërbyer në cilësinë e formulës si truk artistik, nganjëherë ironik e parodizues. Tradita klasike, që e ka burimin në truket alegorike të antikitetit të vonë, i konsideronte Muzat si mbrojtëse të arteve, ku secila, sipas attributeve i përgjigjej një zhanri. Tradita romantike, që i ka rrënjët tek pikëpamjet platonike mbi natyrën e artit dhe që u përfaqësua mandej nga Nietzsche dhe ithtarët e tij, i quante Muzat frymëzuese të krijuesve, që “mahnisnin” shpirtin e poetit; krijimtaria në këso rastesh kundrohej si një gjendje ekstاتike, *furor poeticus*. Në gjysmën e dytë të shekullit XX u vu re tendenca për t’i rishikuar këto dy pikëpamje, për të parë se cila prej tyre kishte në vetvete më shumë të drejtë. Dhe menjëmend, Muzat pak a shumë qenë të “caktuara” në mënyrë skrupuloze sipas llojeve të artit, në rastin më të mirë në epokën e vonë helene. Ndërsa ikonografia tradicionale europiane e Muzave ka qenë një realitet i Perandorisë së vonë Romake.

Që nga lashtësia e hershme me ardhjen e Muzave lidheshin momentet më të ndritshme e më të bukura në jetë — momentet e përndritjes dhe të frymëzimit, shfaqja e diçkaje të re, takimi me ëndrrën. Përse thonë se takimi me Muzën mund të ndryshojë jetën? Përse poetët e vjetër dhe orakujt, duke filluar interpretimin e këngëve të tyre, u drejtoheshin Muzave me lutjen për të marrë bekimin e tyre? Përse grekët e vjetër, duke përcjellë miqtë e tyre në udhë të largëta apo duke i uruar ata për punët e mëdha apo hapat e rinj, shpesh thoshin: “Shko, dhe paç me vete Muzat!”? Në qendër të Athinës, në Akropol, gjithmonë ka ekzistuar një faltore kushtuar Muzave, – Muzeioni.

Po ne a jemi ndeshur në jetën tonë më këto vizitore të mrekullta e të misterta? Dhe nëse jemi ndeshur, atëherë, kur? Ndoshta jemi ndeshur atë pranverë, kur na trokiti

dashuria e parë, dhe dukej, sikur gjithçka përreth shpërtheu në lule shumëngjyrëshe, edhe pse toka dergjej ende nën dëborë? Ose atëherë, atëherë kur ne u bindëm, se e kemi gjetur më në fund punën dhe zejen e adhuruar, me të cilën do të merremi gjatë gjithë jetës? Atë moment, kur në vetëdijen tonë lind imazhi i parë, ende i paqartë, për kë dhe për çfarë ëndërrojmë, grekët e quanin “puthje të muzave”. Nga ky moment ëndrra zë vend në zemrën tonë, dhe ne e dimë se nuk mund të jetojmë më pa të. Dhe nis një udhë e gjatë për tek ëndrra, udha e provave dhe e gabimeve, por kjo është edhe udha drejt harmonisë dhe dritës së Apolonit, udha e takimit me fatin.

Kredoja e muzës së Arshi Pipës: nga estetika në etikë

Çdo poet i rëndësishëm i një kulture gjuhësore shpesh ndodh që shkëlqen me një libër, i cili veçohet në gjithë krijimtarinë e tij, duke identifikuar përvojat jetësore të shkrira me përvojat dhe konceptimet artistike. Në letërsinë shqipe kemi rastet e De Radës, Serembes, Darës, Skiroit, Naimit, Çajupit, Asdrenit, Migjenit, Camaj, Podrimjes etj. Arshi Pipa identifikohet me *Librin e burgut*. Në faqet e këtij libri përplasen fytyra e bukurisë artistike me fytyrën danteske të fatit. Personalisht më pëlqen shumë poetika e librit *Prehudet*, impresionizmi kaltrin i imazhit dhe mpiksja leksikore me interferencat semantike. Por *Libri i Burgut* është Pipa tok me fatin e tij personal, zëri njerëzor që na flet nga zgavra më të thella të Hadit, përplasja e dy lëndëve të përkohshme e të përjetshme, kundërvënia në ringun e asgjësimit ekzistencial të “shpirtërores” me “fiziken”.

Për disa nga shkaqet që i përmendëm më lart, për Pipën nuk vlen ajo që thotë në një intervistë H. L. Borges-i për veten: “*Të gjitha librat e mi, sado të ndërlikuar qofshin, i kanë rrënjët në libërthin e parë poetik – ‘Aromat e Buenos Airesit’*”. Nuk ndodhi kështu me Pipën, për shkak se vetë qenia e tij u vu përballë shfarosjes, përkritazi me kufirin e

vdekjes, prandaj dhe Muza e tij nuk është më ajo e rinisë. Pipës do t'i duhet të mbijetojë në kampin e shfarosjes në Vloçisht mes zhaurimës danteske të ferrit, siç na e sjell ai në poemën sonetike "Kanali". Marrëdhënia e tij me Muzën ka pësuar një korrektim të ndjeshëm: nga idilet nostalgjike të peizazheve psikologjike, të dashurive të pafata, ndarjeve, fëmijërisë, netëve të majit, buklikeve, baladave dhe stancave malore apo peizazheve urbane, kemi një zbritje nëpër rrathë të errët ku lëngon një galeri hijesh, mbi të cilat bien rrebesh "*shkopinj e shqelma. Britma. ... një lamsh ku qelben recka e mish njeriu*".¹ Interesante! Cila vallë është muza e poetit në këso ferri? Dhe në përgjithësi, cilat janë marrëdhëniet e Arshi Pipës me muzat?

Në krijimet elegjiake të rinisë kemi shpesh formula betimesh, pasthirrma ngjyruese si mjete sintaksore dhe emocionale të ligjërit poetik. Duke marrë shkas nga një gjeth i vyshkur vegimi poetik shtrihet e përhapet sipas një simboli të zgjeruar, megasimbol, si një paralelizëm simbolik që përfshin natyrën e sëmure, shpirtin, tërë horizontit frymor fatidik që rravgon në universumin e ngushtë fatal nën metaforën e shuarjes. Poeti i drejtohet gjethit, zemrës, stinës, fatit, andrrave ("Gjeth të veshkun"). Poeti u drejtohet me apostrofa emocionale figurave mitologjike, dukurive, toponimeve, ndjenjave e sigurisht lundrimit alegorik. Poeti është i sigurt se ndërmarrja e udhëtimit është e rrezikshme, por aq më tepër vuajtjes nuk i duhet shmangur:

*Timonieri i ynë asht Fati,
velat tonë janë Dashunija !
Për me vuejtë jemi bâ gati :
jemi nisë kah Bukurija !² –*

¹ Arshi Pipa, *Libri i burgut* ("Kanali"), bot. II. Tiranë: Eurorilindja, 1994, 63.

² Arshi Pipa, *Lundërtarë*, Tiranë: Shtyp. "Tirana", 1944, 63.

që në fund të fundit përbën edhe kredon estetike të poetit që përvijohet midis këtyre katër kategorive metafizike të estetikës. Në këtë poezi (“Lundërtarë”) si dhe në disa të tjera me spikamë në poezinë “Kanga e dehjes”, Pipa shpalos disa pikëpamje adamike (burrërore) mbi jetën (“*Pagana jemi, t’ etshëm deri n’ palcat / për bukurin antike e hiret ’ saja*”).³

Në “Poema vegetale” Pipa për herë të parë ia përshtat procesin e krijimit – mitit mbi Dafnen (Daphna). Bijë e zotit lumor Peneut, Dafne arratiset nga Apoloni i dashuruar. Sipas urdhrit të Apolonit ajo u shndërrua në lári, sapo e arriti. Përftimi i impulsit krijues deri tek poezia, është një ndjekje e gjatë pas së bukurës. Përkapja e poezisë kalon përmes një itinerari mundimesh (“*Ishe e pakapshme, si merë / tretun me gjakun, frymë...*”).⁴ Pipa përpiqet ta paraqesë krijimin e poezisë, njëlloj si një proces të vullnetshëm, si një “vrull vital” trajtëformues, sikundër ndodh me hovin organik në “Evolucionin krijues” të H. Bergson-it. Poezia për Pipën është një proces dinamik, dhe jo një rezultat statik. Urdhri i vullnetit jep pa ndërprerje imazhin-mjet që ndërkëmbehet (imazhi i brendshëm i poezisë), ndërsa ai, duke u realizuar në materialin pasiv të fjalës, na jep imazhin-rrëfim, tashmë të ngrirë (trajta e jashtme e poezisë).

Temës së krijimit Pipa i kthehet rishtas në poezinë-kredo “Ishulli”. Poezia është përfshirë në vëllimin “Libri i burgut I”, çka do të thotë se është shkruar në vitet e burgut (1949).⁵ Për nga tematika, organizimi strofik dhe vargu, kjo poezi duhet të kundrohet e pashkëputur nga poezia “Ode poezís”,⁶ e cila është një variant i dytë, një rimarrje e zgjeruar, sikundër ndodh shpesh me shumë poezi të Pipës, megjithëse “Ode” mund të kundrohet si

³ *ibid.*, 66.

⁴ Arshi Pipa, *Poezi (Meriadiana, “Poema vegetale”)*, Pejë: Dukagjini, 1998, 118.

⁵ Khs. *Poezi (Meriadiana)*, *ibid.*, 139-40.

⁶ Khs. *Libri i burgut*, 1994, *ibid.*, 107-11.

një poezi më vete që e brendashkruan poezinë “Ishulli”. Të dyja poezitë kanë një rëndësi të shumëfishtë për psikologjinë artistike dhe estetikën e Pipës, pasi në to poeti shpalos instrumentarin e ligjëratës së tij poetike, artin dhe përkushtimin e tij ndaj poezisë, duke na shpjeguar edhe estetikën që shndërrohet pashmangshëm në etikë.

Në këto dy poezi, Pipa për herë të parë i drejtohet Muzës dhe ne kemi mundësi t’i analizojmë marrëdhëniet e poetit Arshi Pipa me Muzat.

Marrëdhënia komplekse e Pipës me Muzat

Në poezitë e Arshi Pipës kemi një marrëdhënie komplekse me Muzat. Ai e identifikon veten si poet që i falet një “Muze krenare”, duke ia caktuar asaj ngjashmërinë me hyjneshën Atenë-syktthjellën që lindi nga Zeusi. Ashtu si mbron hyjnesha ledhet e Akropolit, ashtu dhe Muza e tij ia mbron të pakompromentuar dhuntinë poetike. Poezia “Ishulli” hapet me një sensacion dhe rizgjim të shqisave të topitura, një drithërimë që e shkundullon dhe trand krejt qenien, diç e ngjashme si në rastet e Zbulesës apo si me ndjesitë e profetëve para Zbritjes së fjalës hyjnore.

*Plasi nga trûtë e t’Epërmit
ngjeshun me përkrenare
hyjnesha qi për fron
ledhet pëlqeu t’Akropolit.
O Muzë imja krenare,
me të sa fort Afron!*

“Ishulli”, 139

Gjithë duke iu drejtuar Muzës (“*Un lundërtar me busullen / tande...*”) poeti pohon se ka kërkuar me të “*nji themel për virtyt*”. Ai e ka gjetur themelin në një “ishull kufitar” (ishulli si simbol i vetmisë dhe i vuajtjes

personale, por edhe i pamposhtësisë frymore) “*kur ania m’u mbyl*”, çka na lë të kuptojmë, se në vitet e tmerrshme të shpërfytyrimit njerëzor nëpër kampet komuniste të shfarosjes, Muza ka qenë Shpresa dhe forca irracionale shpirtërore që e ka mbajtur gjallë. Duke i besuar shejtnisë së Muzës, poeti pohon se “*Gjeta dijen e herëshme / qi botën ma bân timen*” – dhe, për më tepër, që në tërë atë ring asgjësimi, kur identiteti i individit shtypet e degradohet nga dhuna, është Muza që: “*m’i shlyen caqet kah ndaheshim*”, pra është mbrojtësja jo vetëm e higjienës së ekzistencës, shpirtit dhe trurit, por edhe e botës së tij, duke e shlyer/fshirë kufirin e kampit që e ndan nga bota e lirë. Besimi dhe besnikëria tek Muza është mjet shpëtimi i artistit, sepse ajo e ruan integritetin trupor e shpirtëror në emër të dhuntisë artistike: “*e mâ të pasun rimën / ma bân me shqise e mend*”.

Si duket Pipa ka zgjedhur modelin dhe imazhin antik të Muzës, të padhunuar ndër mbivendosjet e traditave letrare, madje duke e purifikuar shpërdorimin e muzës, “vesin” e të thirrunit të saj si shtampë, si klishe. Pipa pëlqen t’i rikthehet burimit zanafillor të Olimpfit dhe të Parnasit, kur nëntë motrat (Muzat) pinin në burimet e Hipokrenës, apo më saktë, marrëdhënien e stërgjyshit tonë letrar, Homerit. Muzat e shoqëronin njeriun në të gjitha çastet e rëndësishme të jetës, të tilla si lindja, vdekja, dashuria dhe martesë, krijimtaria, zgjedhja e rrugës dhe destinacioni – në momentet kur vendosej fati i tij. Me praninë e tyre ato shënojnë momentet e lindjes së të resë.

Marrëdhënia me Muzën, e cila është bërë banalitet i rëndomtë sot në Europë, në epokën homerike ka pasur një përmbajtje mjaft të ndërlikuar. Poetët e parë grekë Homeri dhe Hesiodi pohojnë një lidhje të drejtpërdrejtë të krijimtarisë së tyre poetike me Muzat. Secili sosh, në fillim të veprave të tyre, i drejtohet Muzës ose Muzave (Hom. Il. I, 1; Od. I, 1; Hes. Op.1) me lutjen për të ditur diç mbi ngjarjet konkrete, për të kënduar heroin apo Hyjtë-Muza, që ata t’i frymëzojnë. Kjo shpjegohet

thjesht: Muzat-hyjnësia dinë gjithçka, përkundër nesh që s'dimë asgjë, përveçse lutemi. Muzat u dërgojnë poetëve frymëzim, njësoj sikurse zotat i veshin heronjtë me bukurinë e jashtme të kurmit dhe të fytyrës. Në *Iliada* II 485-493, poeti para përshkrimit të gjithë fuqisë ushtarake akeje dhe trojane u drejtohet Muzave, të cilat dinë gjithçka në botë, që ato t'i ndihmojnë për t'i kujtuar me hollësi të gjitha anijet e akejeve. Në *Odiseja* VIII, 480 për këngëtarët thuhet:

Kush përveç Muzës, që i do aq fort, me këndue i ka mësue?

Dhe kur Demodoku nis të këndojë, thuhet: “*Muza e këndelli kangtarin me këndue bâmat*”. Sepse: “*hyu i dha atij zemër të na gazmojë me kangë, sado dëshirë ai për kangë mos me pasë*”. Një këngëtar tjetër, tashmë në shtëpinë e Odiseut, që argëtonte mtonjësit në mungesën e të zotit të shtëpisë, lyp lëmoshë, duke argumentuar: “*Jam një i vetmësuem, vetë hyjnia m'i ka mbjellë në zemër kangët gjithfaresh. Dhe ma merr mendja se jam aq i zoti, sa di me t'këndue kangë si për hyj. Në mos jo, prejma grykën*”. Varësia e plotë e poetit nga Muzat është demonstruar tek Demodoku edhe me verbërinë e tij. Ai është aq i kredhur në dhuntitë e Muzës, sa nuk i ka mbetur më ç'të shohë me sytë e tij fizikë (*Od.* VIII, 63.): “*Muza atë e deshti, por me një të mirë e një të ligë e pajisi: dritën e syve ia mori, porse i dha kangët e amla*”. Vetë Homeri ishte një plak aed, i verbër.

Në variantin e rimarrë të Pipës, tek poezia “Ode poezis”, poeti i rrëfen Muzës në vetë të dytë, me sinqeritet, si një personi të shtrenjtë e tepër intim, se: “*Kisha frikë se birresha, / kaq shumë ngjate larg meje / ku dergjem e s'leshoh, / o ti vetëm e ngeluna / prej çdo tjetër hareje, / sublime ndër vargoj!*” (107). Poeti “marroset” në strofat vijuese për “mallin botëror”, për “ngazëllimin e njohjes” nga prekja dhe zgjimi i Muzës dhe poetit i rreh zemra e mrekullueme “si laureshë n'agim”.

*O shembull i elementave!
O motër dashunije!
Nevojë qi dukesh trill!
- E ke t' atyne kohnave
virgjën at fllad e shije
ku dija zuni fill.*

*E n' erdhi tash prej kreshtave
t' Olympit n' anët tona
mbi Pindin epirot,
kujto pyllin ku orakullin
e hershëm pat Dodona:
pagan besuem një zot.*

“Ode poezís”, vv. 31-42, 108.

Muza është një motër e vdekur në lule të rinisë

Muza e Pipës është po ajo e miteve heleno-ilire, e gjithkohshme dhe e gjithkundshme; ajo e përshkon tërë materien fizike dhe shpirtërore shqiptare, majet e Sharit, valët e Adriatikut e Jonit, duke u shkrirë dhe identifikuar me pengjet e pamorta të poetit, si për shembull, me motrën e vdekur.

*Mos je dikur e trembuna
flatër e ndonji malli
n' idylin që s' u-korr?
Apor je vetë i dashuni
mbi tjerët e më i gjalli
shpirti i motrës në vorr?*

ibid., vv. 73-8, 109

Marrëdhënia e Pipës me Muzën, mbetet po ai imazh mitik i poetëve të vjetër të antikitetit, për të theksuar natyrën e tyre të përjetshme, porse tek Pipa kemi imazhin dinamik të mitit. Miti, para së gjithash, këtu ai i Muzave, është vetëm forma e kallëpit në të cilën merr trajtën e tij

çdo përmbajtje e lëndë bashkëkohore. Trajta apo forma e fatit është gjithmonë ai modus universal i mitit, në çdo kohë. Prandaj Muza, sipas Pipës, është dhimbja dhe pengu që ka mbetur vulë e pashlyeshme në shpirt, sikundër tek strofa e mësipërme, – më i dashuri e më i gjalli ndër të tjerë – shpirti i motrës së vdekur. Kujtimin të kësaj motre ai i rikthehet edhe në një sonet, që përmbyll poemën sonetike “Kanali”, duke iu drejtuar si një shpirti të pranishëm me dritë shprese edhe në hadesin e kampeve komuniste të vdekjes. Faktografikisht është fjala për motrën e poetit, Bedi Pipën, një vashë me bukuri të pazakontë, e cila sapo kishte përfunduar Institutin femnor “Nana Mbretëreshë”. Bedi ishte një natyrë melankolike, e kulturuar, e lexuar dhe tejet inteligjente, me një hiperndjeshmëri, e cila duket qartë nga prozat e saj, shënime ditari dhe epistolarë, tashmë të botuara në librin *Ditar intim* (2007). Ajo vdiq parakohshëm në moshën 23 vjeçare nga tuberkulozi, kur poeti gjendej në qelitë e burgut të Burrelit.

Duke qenë mbrojtëse e të gjithë shërbyesve të artit, duke falur dhuntinë e këngës, lojës në instrumentet muzikore dhe thurjen e vargjeve, Muzat nuk ia falin kujt sqimën. Prandaj një nga cilësitë kryesore të poetëve dhe artistëve të lashtësisë ka qenë pastërtia e ideve dhe e përpjekjeve, ndaj ata gjithmonë lypnin ndihmën, bekimin dhe frymëzimin e Muzave, që të mund të jepnin në veprat e tyre imazhet e shenjta hyjnore. Dhe prandaj Muzat janë të lidhura në parimin e pastrimit të shpirtit, ato janë filli lidhës ndërmjet hyjnive dhe njerëzve.

Muzat nuk ngrehin seli në zemrat e korruptuara

Pathosi etik i Pipës, është i kuptueshëm: poezia, para së gjithash, kërkon një zemër të madhe e të pastër. Në të kundërt, ku nuk ka higjienë shpirtërore, nuk banon as Muza.

Përafërsisht në ato vite kur janë shkruar këto poezi, në burg a në mërgim, në letërsinë shqipe kishte pllakosur perversioni i muzave, servilizmi i thellë dhe kopjimi më i shëmtuar i modeleve të antipoezisë. Në të ashtuquajturën reviste letrare *Literatura jonë* (që në titull – përkthim nga rusishtja – “Nasha literatura”), organ i Lidhjes së Shkrimtarëve, jepeshin modelet e importuara poetike të poetëve zyrtarë, servilë e të patalentuar, kryesisht komisarë të partisë. Në numrin 3-4 të kësaj reviste botohej poema “Tuneli rritet” e një prej adeptëve të socrealizmit, Aleks Çaçit, me subjekt – hapjen e një tuneli hekurudhor në Jugosllavi. Qorrollepsja dhe tëhuajësimi nuk mund të gjejnë apoteozë më të shëmtuar. Ja një fragment, sa për të gjykuar:

Boriç Mile, udarnik!

*Në tunelin e Vrandukut,
Lind çdo ditë njeriu i ri,
Hapet mali gjer në funt...
...Ç’po shikojnë sytë e mi!
“Tito” ngrihet gjithë tuneli,
Toka tundet nga themeli,
Gjokset turren si një zjarr,
Shkëmbi çduket menjëherë,
Shkëmbi tjetër po mer tmerre...”*

“Tuneli rritet”, *Literatura jonë* 3-4, Maj-Qershor 1947

Në traditën letrare shqiptare Arshi Pipa, ka megjithatë, një paraardhës, në marrëdhëniet e tij me muzën. Është Jeronim De Rada me Lumbardhën e tij të Anakreontit, që i kthehet idesë, se sado të ndryshojë kjo botë, në thelb, për shpirtin njerëzor gjithçka mbetet si më parë, shpirti botëror i njeriut mes përtëritjes së natyrës, mbetet po aq i ngazëllyer e i brengosur, sa ç’ka qenë në kohërat e parrokshme nga kujtesa. Ose e thënë me gjuhën e Ekleziastit, për shpirtin dhe përjetimin njerëzor “*nuk ka asgjë të re nën hënë*”. Dallimi i Pipës nga paraardhësit është

se ai kthimin dhe drejtimin e tij nga Muza, e rrëfen si varësi totale, duke ua lënë atyre “shpirtin në dorë”. Sepse nuk ka më lojë: Arshi Pipa ka vënë gjithçka: jetën dhe ekzistencën e tij. Ndaj poezinë e frymëzuar nga muzat ai e sheh si shpëtim jo vetëm të vetvetes, por të njerëzve të tij të dashur, të zemrës e të gjakut, të kombit të tij, në një art pa hile, pa truke, pa ngeshmërinë e eksperimentimit, sepse nuk ka më kohë: ai duhet të dëshmojë për mizoritë e kësaj bote, për burgun e madh ku lëngon qenia shqiptare dhe për ndonjë rreze depërtuese shprese në terrin e habit shqiptar. Për të na dëshmon megametafora e poezive të vëllimit *Libri i burgut*, por më përveçmas, marrëdhënia e tij pasionante me muzat në krijimin dhe transformimin e “udhëtarit të magjepsur” nga bukuria edhe në zgafellen e ferrit. Kjo përvojë është e tij, është reale, dhe poeti dëshmon, nuk qarravitet, përkundrazi ai e shpërndan kumtin dhe beson se me këtë kumt, përmbush një mision, për të cilin është i zgjedhur dhe se, ai si poet, përpiket për të qenë sa më i denjë në misionarizmin e tij.

*Me ty ndër gjinj do t' mundesha,
sikur ban rabdomanti,
ndër kroje t' i shpërthej
ujnat nën dhé të fjetuna;
e ku gjindet diamanti
ta gjëj, ta qes andej.*

*Ashtu qi strofat t' enduna
me matuni klasike
të rrjedhin nëpër to
mendimet mâ të ndrituna
dhe ndijet mâ fisnike,
mësim për cilindo.*

*Eja mâ shpesh, o e bukura
motër hyjnore, eja
për t' amblin frymëzim!
qi këtë dhuratë të zotave
të lashtë me fjalë të reja
t' ja kthej un kombit tim.*

“Ode poezís”, vv. 85-90.109-20, 110-11

Në këtë besim dhe besnikëri ndaj muzave, poeti Arshi Pipa gjeti jo vetëm sekretin e rezistencës, e mbijetesës, por edhe të ngushëllimit me të bukurën dhe të lartësuarën, pikërisht në epiqendrën e shëmtisë, të shpresës, pikërisht aty ku braktisej çdo shpresë. Sepse siç e thotë edhe vetë poeti në shënimet e tij për sonetet e ciklit “Kanali”:
“Mjekët nuk dijsin me spjegue se qysh të burgosunit vazhdojshin me jetue ndër kushte të këtilla. Jo se të pakët qenë ata qi vdiqën, por pritej qi të zhdukej pjesa më e madhe. – Kam vërejtë se ata qi vdisshin ishin më fort njerëz të cilët kishin humbë durimin dhe shpresën” (204).

ALBANA DEDA (NDOJA)

PSE VAZHDON ME U T'HUEJTË ARSHI PIPA?

Kontakti im i parë me Arshi Pipën ka qenë komplet spontan. Jo në auditor, as si studente, as si pedagoge qoftë edhe në ndonjë konferencë. Në 2012 unë kam botuar një shkrim në lidhje me standardin,⁷ në të cilën i referohesha pikërisht prof. Arshi Pipës me një citat të lexuar diku, po pa e pasur komplet veprën e tij të plotë dhe njëkohësisht krejt këndvështrimin e tij mbi standardin (SHNJL), të shprehur në *Politikat e gjuhës në Shqipërinë socialiste* (viceversa edicion edhe në gegnisht), e cila në Shqipëri është botuar në 2010 (Princi), por origjinali është në anglisht.⁸

Për fat të keq në atë kohë askush nga ambienti gjuhësor nuk u mor me problematikat e shtruar në atë artikull, po me faktin se referencën kryesore që lidhej me qëndrimin e Çabejt e kisha marrë nga Arshi Pipa. Në fillim nuk e kuptova arsyen, por perceptimi im ishte se Pipa nuk ishte fort i dëshirueshëm nga ai ambient.

Natyrisht që ky reagim dhe arroganca e zakonshme ndaj atyre që prekin çështje aq “të nxehta” si standardi, më shtynë që ta kërkoja veprën e sipërme e ta lexoja. Befasia ishte e madhe. Pikë së pari, se kisha para një punim i cili kërkonte një lexues të kualifikuar nga

⁷ <http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/>

⁸ Arshi Pipa, *The Politics of Language in Socialist Albania*, New York: Columbia University Press for East European Monographs, Boulder, 1989.

pikëpamja gjuhësore, letrare, konjitive, politike-filozofike, historike etj.

Së dyti mënyra e analizës me referenca të sakta dhe statistika të detajuara, mbështetur në literaturën e botuar në këtë kontekst ishte befasuese (dhe që nuk e kishim hasur në tekstet referente këtu në Shqipëri), duke prezantuar para marrësit një tekst me aftësi ilokutive të qëndrueshme.

Së treti metodologjia e përjasjes ndaj argumentit nga nivele studimore dhe perceptive të ndryshme, — duke përbërë dhe alternativën e kundërt skajshmërisht me atë, me të cilën je ballafaquar në ambientin gjuhësor që student, metodologji të cilën nuk e ke hasur në anën tjetër të qasjes, që në përgjithësi ka qenë thjesht preskriptive, — krijojnë mundësinë e reflektimit individual të marrësit dhe të përfshirjes në debat të tij.

Së katërti nga pikëpamja stilistike kemi përpara një tekst që përveç ftohtësisë objektive shkencore dhe poliedrisë së argumentimit, në raste të caktuara vishet me pasazhe komplet ligjërimore, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht ironi deri në sarkazëm, për mënyrën se si është trajtuar problematika, duke reflektuar si absurd mungesën e korrektësisë shkencore në trajtimin e palës tjetër (për të mos thënë dashakeqësisë nihiliste të saj).

Nga ana tjetër, ato përfaqësojnë reagime koshiente e subkoshiente të një adhurimi ekstrem të autorit ndaj kombit të tij, kodit të tij, mallit zhuritës për të e pamundësisë për të kontribuar e ndikuar sadopak në lidhje me atë që kishte ndodhur.

Lexuesi i këtyre radhëve modeste duhet ta kuptojë se një hyrje e tillë, që zakonisht do të ishte pjesa e përfundimeve, u kushtëzua pikërisht nga teksti dhe stili i Pipës dhe nga fakti që vetë si personalitet shkencor i përkiste, sipas nesh, antikanonizmit.

Nuk kemi ndër mend që në këtë artikull të bëjmë një recensë të librit të tij, po të shohin se a qëndrojnë apo kanë rënë tezat kryesore të tij, ato që lidhën me planifikimin gjuhësor dhe atë që u vendos në lidhje me të, që kanë

pasur dhe kundërshtime të ashpra në Shqipëri, duke e lënë të paktën Pipën dhe veprën e tij deri tani në aspektin profesional akoma në ekzil dhe në pamundësi kontakti real përmes studimit me grupet e interesit.

Siç theksuam, libri i shkruar nga Pipa në 1989 ka pasur reagime mjaft të ashpra. Po çfarë kishte në këtë tekst që nxiti edhe etiketime të tilla si “botimi i vitit me mendësinë më të prapambetur”, “monografi e mbushur me llaftari”, “arshishkencë”, “Ai ndërmerr një shkatërrim tërësor të historisë, të bazës, të lëndës, të strukturës, të sociologjisë, të teorisë dhe të vlerave të gjuhës letrare të sotme”, “I gjithë libri i Arshi Pipës mund të shërbejë si rast klasik për shqyrtimin frojdian.” etj. etj.

Që në parathënie Pipa shtron përfundimin e këtij punimi, duke thënë “*Në fakt SHNJL nuk asht tjetër veçse një variant i përpunuem i toskënishtes si fonologji e gramatikë, kurse fjalori i saj përmbledh pjesën më të begatë të leksikut dhe frazeologjisë geqe, e shpërlame kjo me fono-morfologji toske, sa mos me lanë asnjë shenjë, as gjurmë se prej kah vjen. Kjo dukuni e çuditshme e një kolonializmi krahinor gjuhësor e ka shpjegimin e vet në faktin se Shqipëria antikomuniste e veriut u shtrëe ushtarakisht prej një ushtrie partizanësh e udhëhequn kryekrejtë prej gjeneralësh e komisarësh komunistë toskë. Sot për sot gegnishtja letrare praktikisht asht e vdekun.*” (A. Pipa, 2010: 24).

Në shtjellim të kësaj ideje ai sqaron se në fakt ky libër në bazë ka tezat e Janet Byron *Selection among Alternates in Language Standardization: The case of Albanian*, 1976, (Mouton, Hage & Paris) mbi planifikimin gjuhësor dhe rrugën e ndjekur në përcaktimin e SHNJL-së në Shqipëri.⁹

Edhe vetë Pipa pohon se në këtë libër rimerr tezat e Byron-it dhe i sqaron në mënyrë të detajuar (A. Pipa.

⁹ Po të shohim pohimin e Pipës dhe atë të Byron-it (1976: 65), të cituar dhe nga Pipa (2010: 52) shikon se në thelb ngjashmëria është shumë e madhe.

2010: 27): “*Monografia ime i konkretizon kta përfundime (të Byron-it, A.D.) me përlllogaritje statistikore.*”

Në këtë kontekst ai fillimisht jep një pasqyrë të shqipes së shkruar geqe e toske deri në kohën e Kongresit të Manastirit. Gjithkush që e lexon këtë listë tekstesh, megjithëse i mungon pjesa tjetër që vijon deri në 1944, mund të vërë re se një ndër argumentet e përdorura nga hartuesit e platformës së 1972, që theksonte se gegnishtja nuk kishte një traditë të konsoliduar letrare, kurse toskërishtja po dhe prandaj kjo e fundit kishte përparësi ndaj asaj të parës, bie menjëherë.

Siç thekson më tej Pipa, synimi i monografisë është “...*me përcaktue natyrën dhe shkallën “e njësimit” gjuhsor në fjalë.*” (Pipa, 2010: 36).

Në këtë logjikë ai kalon në një skaner të detajuar të gjitha ndryshimet që vihen re mes dialekteve në rrafsh fonetik e fonologjik, morfologjik dhe sintaksor. Natyrisht ajo që të bie në sy është formimi në disa nivele të studimit gjuhësor. Gjithsesi vlen për t’u përmendur një referencë e tij nga Chomsky që në atë kohë as nuk artikulohej në asnjë literaturë këtu, jo më të aplikohej. Citojmë: “*Sintaksa asht rreshtimi i fjalëve në fjali simbas marrdhanieve, që kanë në gjuhë pjesët e ndryshme të ligjëratës e, ksisoj duhet që fjalia si e tanë të ketë kuptim. Si e tillë sintaksa asht tejet treguese e strukturës së mendjes që prodhon ligjëratë. Chomsky (Çomski) flet për një “komponent qendror sintaksor” dhe dy komponentë interpretues brenda gramatikës së gjuhës, “komponentin semantik” i cili formon “strukturën e saj të thellë” dhe “komponentin fonologjik” që formon “strukturën e saj të sipërfaqes”. Kjo don me thanë që shqipja asht një dhe një e vetme me gjithë dallimet dialektore të shprehuna në fonologjinë e morfologjinë e saj dhe që shpjegohen me veprimin e faktorëve sociolinguistikë.* (A. Pipa, 2010: 50).

E dhamë këtë citat kaq të gjatë për disa arsye. Së pari nga pikëpamja sintaksore ashtu si hartuesit e SHNJL Pipa nuk vë re dallime kardinale mes dy dialekteve, gjë që shpjegon edhe faktin që nuk ka zhurmë në kanal

komunikimi në atë masë, sa që të mos kuptohet pjesa kryesore e mesazhit nga marrësit e dy të folmeve.

Së dyti besojmë se ky citim dhe gjithë njohja e të dy varianteve të shqipes, trajtimi i elementeve të tyre në detaje në ato kohë, kur ne akoma edhe sot nuk kemi korpusë të niveleve të ndryshme të studimit gjuhësor të kodit tonë, tregojnë për një intuitë informale shumë të sofistikuar, e cila nuk mund të arrihej nga individë që nuk janë gjuhëtarë të mirëfilltë (etiketim tjetër ky që i bëhet Pipës, i pëshpëritur nën zë e mbi zë në ambientet tona gjuhësore atëherë dhe sot).

Metoda e analizës dhe literatura e konsultuar

Duke qenë se ky punim i drejtohet një marrësi të kualifikuar, i cili është në dijeni të referencave dhe debateve në këtë fushë, ne fillimisht do të parashtrojmë një pjesë përcaktimesh në rrafsh teorik në lidhje me procesin e standardizimit dhe më pas do të analizojmë disa trajtime në lidhje me veprën e Pipës.

Në këtë kontekst në vijim u referohemi autorëve të tillë si Haugen (1997) dhe J. Milroy & L. Milroy (2012) në lidhje me fazat që duhet të ndjekë një proces standardizimi dhe ndikimin jashtëgjuhësor në procesin e standardizimit.

Po kështu, kemi konsultuar Crowley (2003), sa i takon politikës gjuhësore të ndjekur në lidhje me standardizimin e anglishtes, si një ndër gjuhët më të studiuara. Natyrisht në lidhje me përkufizimet kryesore të koncepteve në fjalë u jemi referuar dhe fjalorëve më të njohur të fushës si *Handbook of sociolinguistics* (2017) etj.

Në vijim të parashtrimit teorik ne do të kthehemi te tezat e Pipës dhe trajtimet e emrave shumë të njohur në gjuhësinë shqiptare si prof. Xhevat Lloshi, prof. Rexhep Ismajli, prof. Bahri Becit etj.

E bëmë këtë përzgjedhje për disa arsye: Së pari se ata janë përfaqësues të dy grupimeve kryesore që firmosën në

Kongresin e Drejtshkrimit, përkatësisht Tiranës dhe Prishtinës. R. Ismajli, nuk ka qenë pjesëmarrës direkt, po është pjesë e Këshillit Ndërakademik për ndryshimet në standard, madje ai ka shkruar dhe një libër me titull *Drejtshkrimet e shqipes*, 2005.

Së dyti në trajtimet e tyre vihet re një debat i mbështetur në argumente.¹⁰

Fazat standardizuese të një kodi

Koncepti standard si term i përket regjistrit formal, përkatësisht të specializuar. Sipas Peter Auer,¹¹ në një ligjërimit më të lirshëm, këtij koncepti i referohen dhe

¹⁰ Dhe jo si në raste të tilla si “Nuk kam thënë që ky këshill nuk duhet të ekzistojë, por nuk duhet të ekzistojë kështu siç është, si Këshill Ndërakademik, i administruar nga dy Akademitë, të cilat kanë marrë përsipër tagra që nuk u takojnë. E përsëris edhe një herë se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës si institucion nuk ka bërë ASGJË për gjuhën letrare shqipe ose, po të doni, ka bërë një ASGJË të madhe, për të mos thënë ka futur shkopinj në rrota! Tani, këta zyrtarë që kanë bërë këtë ASGJË të madhe, duan të vendosin për gjithçka dhe ashtu si duan ata, duke pretenduar se, po të mos bëhet ashtu, do të shtohet rreziku për përmbysjen e standardit! Po ç’ka bërë Akademia e Shkencave për ta mbështetur standardin në Kosovë? Ka bërë sehir, nuk ka thënë zyrtarisht asnjë fjalë, standardin e ka cilësuar (me nënkuptime të qarta) si diçka të importuar nga Shqipëria, nuk ka ndërmarrë vetë asnjë veprim për kulturimin gjuhësor, as është bashkuar në veprimet e të tjerëve e as i ka përkrahur.” (E. Lafe, <http://www.zemrashqiptare.net/news/32100/akademiku-emil-lafe-mbi-standardin-e-gjuhes.html>).

¹¹ P. Auer. (2011). *Dialect & Standard: A Typology of Scenarios in Europe*, ([http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/\(2011\)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf](http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf))

terma të tillë si *Hochsprache* ose *Bon usage* apo dhe *Literaturnyj Jazik* (Vini re dhe referencën e termit rus, aq familjar në shqipe edhe sot e kësaj dite “gjuhë letrare”).

Fjalori i Anglishtes i Oksfordit përcakton se folja *standardizoj* e ka zanafillën në shek. XIX dhe do të thotë “t’i bësh objektet dhe aktivitetet e të njëjtit lloj që të kenë të njëjtat cilësi ose tipare” (Oxford Advanced Learners Dictionary).

Ferguson (1959: 189) sqaron se në kontekstin linguistik, kjo folje përfaqëson: “*procesin se si një varietet i gjuhës bëhet më i pranuar gjerësisht nga komuniteti ligjërues si një normë mbidialektore—formën më të mirë të gjuhës—të rankuar mbi dialektet rajonale dhe sociale, megjithëse këto mund të ndihem më të përshtatshme në disa domene*”.

Si rrjedhim produkti i standardizimit, pra standardi, është varieteti që propagandohet të përdoret në arsim, kodifikohet në libra, dhe është i papëlqyeri i folësve jorajonalë (i kryeqyteteve, i metropoleve me ndikim ekonomik e politik), i një shoqërie (Hickey, 2012: 2).

Pra siç shihet nga parashtrimi i mësipërm standardi, pasi përcaktohet, krijon hegjemoninë e vet në të shkruar dhe në të folur, duke zbehur dashje pa dashje variantet e tjera. Nga ana tjetër, ai do të bëhet varianti me prestigj edhe në të folur, pavarësisht se atij në Shqipëri i referohen me emrin *drejtshkrim*.

Në lidhje me procesin e standardizimit gjuhëtari, të cilit i referohen gjerësisht është Einar Haugen.¹² Ky përcakton katër faza në lidhje me këtë proces:¹³

¹² Kujtojmë se pikërisht veprës së Haugenit i referohet edhe Pipa (2010: 18). Kemi parasysh se në parathënien e manualit *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973, nuk ka asnjë referencë teorike sociolinguistike apo që i përket planifikimit gjuhësor, të cilat ekzistonin edhe në atë kohë.

¹³https://www.researchgate.net/publication/324469698_Language_standardization_in_sociolinguistics_and_international_business_Theory_and_practice_across_the_table_Interactions_and_Policies_English_in_Europe_Volume_5

1. *selektimi i normës* (perzgjedhja)
2. *kodifikimi i formës* (gramatika, fjalorë etj.)
3. *elaborimi - përhapja* (përhapja në shkollë, administratë, media)
4. *pranimi nga komuniteti*

Milroy & Milroy (*Authority in Language*, 1985: 22) u shton katër elementeve të skemës së Haugenit edhe tre elementë të tjerë. Ata parashikojnë perzgjedhjen, pranimin, përhapjen (diffusion), mirëmbajtjen (maintance), elaborimin, kodifikimin (codification) dhe normativizimin (prescription).

Duke folur në veçanti për elaborimin J. Milroy thekson se ai nënkupton që varieteti vjen e përdoret në një numër të shtuar kontekstesh, gjë që e bën varietetin më prestigjioz dhe të dëshirueshëm për komunikime të shtrira në hapësirë (*The Ideology of the Standard Language*, 2006: 134).

Pra ky koncept mjaft i rëndësishëm ka të bëjë pikërisht me faktin se sa ka arritur të instalohet në aspektin komunikativ një variant i caktuar.

Procesi i standardizimit në Shqipëri

Nëse u referohemi fazave të standardizimit që parashtrihen te Haugeni (1966, 1972, 1987) dhe pastaj Milroy & Milroy (2012), mund të vihet re se në fakt procesi në Shqipëri nuk ka ndjekur të njëjtën, radhë si ato që jepen më sipër. Pipa në fakt e ka përmendur këtë fakt duke renditur edhe veprat që u shkruan në këtë kontekst për shqipen.¹⁴

¹⁴ Khs. *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, 1967; *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973; *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, 1976; *Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe*, 1976; *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, 1976; *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980.

Edhe lista që jep Ismajli (2005: 7) parashikon vepra të tjera pararendëse të manualit të Drejtshkrimit (1972). Është mjaft domethënëse se ky proces veprat e para i kishte të fazës së normativizimit: *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1948; *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1951; *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.

Pra pavarësisht se Kongresi i Drejtshkrimit u mbajt në 1972, të paktën nga listat më lart mund të shihet se ai ishte në fakt një akt formal, pasi puna për të kishte filluar më përpara me shumë “seriozitet”, madje kishin dalë dhe manuale preskriptive.

Këtë fakt e pranon edhe prof. Bahri Beci¹⁵ (sekretari i Androkli Kostallarit në atë kohë), i cili thekson se “*E vërteta është se diskutimet për Rregullat e drejtshkrimit të shqipes, që ishin botuar më 1967, kishin hyrë në fazën e fundit të tyre. Pra, kishte dalë nevoja e organizimit të një veprimtarie që do të finalizonte diskutimet e bëra dhe t’i jepte një formë përfundimtare drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Kjo ide, me sa duket, u përçoll në organet e larta të shtetit dhe të partisë. Kuptohet që në atë kohë pa aprovim nga lart nuk mund të bëje asgjë.*”¹⁶ (“Nxitimi” ka qenë kaq i madh atëherë dhe ky proces dhe këto vepra (*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, *Fjalori drejtshkrimor*, *Gramatika I & II*) janë vlerësuar në atë masë,

¹⁵ <http://www.panorama.com.al/kujtimet-e-gjuhetarit-bahri-beci-si-u-shnderrua-konferenca-e-drejtshkrimit-ne-nje-kongres-partie/>

¹⁶ Madje edhe emërtimi si kongres i veprimtarisë në 1972 u bë jo me paramendim gjuhësor, por në kuadrin e arritjeve të padiskutueshme të vendit e shkencës në Shqipërinë komuniste të kohës.

Beci shprehet “*Dhe askujt nuk i shkonte në mend në atë kohë se, shumë shpejt pas saj, do të organizohej një tjetër veprimtari shkencore që do të bënte të harrohej konferenca e organizuar nga Instituti i Historisë. E ky do të ishte Kongresi i Drejtshkrimit që është vlerësuar si “një fitore e vijës marksiste të PPSH-së për zgjidhjen e problemit të gjuhës sonë letrare kombëtare”* (ibid.). <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

saqë sot e kësaj dite, megjithëse është shumë e qartë nga shumë aspekte dhe është pohuar nga autorët e *Gramatikës I dhe II*¹⁷ (të cilat në fund të fundit janë përmbledhje e Fonetikës dhe gramatikës së gjuhës shqipe, 1976, ne akoma nuk kemi një gramatikë të vërtetë deskriptive për shqipen. Kjo e fundit do të duhej të ishte/të jetë gjithëpërfshirëse me elementet më redondante të dy dialekteve dhe, meqë jemi tashmë kaq vonë, të verifikojë një pjesë të të dhënave të Gramatikës preskriptive që kemi (edhe kjo me dyshime), nëse ato kanë kaluar në diakroni apo vazhdojnë të jenë në sinkroni. Për hir të objektivitetit shkencor një gramatikë e tillë deskriptive do të duhej të ishte bërë, para se të fillohej normativizimi Më pas mund të dilte gramatika preskriptive).¹⁸

Pra veprat e para në lidhje me standardizimin janë vepra që lidhen me normativizimin, ndërkohë që procesi i përzgjedhjes, megjithëse pa një metodologji të qartë shkencore (pavarësisht se më pas u shit për një projekt të

¹⁷ E. Lafe në “Ditën e librit”, në një referencë të pabotuar në 2019 pohoi, perifrashojmë, “Ne bëmë Drejtshkrimin dhe në frymën e saj ne bëmë Gramatikën”. Në fakt ky pohim është pjesërisht i vërtetë, duke pasur parasysh se as sot e kësaj dite ne nuk kemi korpus sintaksor të standardit të paraqitur në mënyrë të printuar ose elektronikisht. Kështu që të paktën *Gramatika II* mund të thuhet se nuk ka referencë më një tekst tjetër deskriptiv që të thuhet se ajo është një gramatikë normative siç nënkuptohet nga ajo që thamë më lart.

Nga ana tjetër, mënyra se si është punuar për hartimin e atyre dy veprave të thotë se nuk ka pasur hulumtim serioz në lidhje me shfaqjet e gjithë korpusit të shqipes për të përzgjedhur më përfaqësuesen, duke pasur parasysh se gegnishtja është e papërfaqësuar në këto Gramatika. Duhet thënë se dhe toskërishtja nuk është e përshkruar plotësisht në to.

¹⁸ Shih: <http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/>

mirëmenduar “i mbështetur në metodologjinë marksiste leniniste”¹⁹ kryhej paralelisht.²⁰

Kjo përzgjedhje sipas bazës teorike të sotme dhe veçanërisht produktit që paraqet ky standard, sipas nesh, përfaqëson një projekt me ide të qarta nga ana fonetike-morfologjike në aspektin preskriptiv, pavarësisht mungesës së metodologjisë së përcaktimit të tyre dhe verifikimit me të dhëna të sakta nga përdoruesit. Në lidhje me aspektin sintaksor nuk ka sqarime.²¹

Fakti se procesi ka ndodhur në këtë mënyrë mendojmë se mund të shpjegohet nga nxitimi për të realizuar hegjemoninë e asaj që u reklamua si koine, po që në fakt nuk ishte dhe nuk është aspak e tillë, gjë të cilën e thekson jo vetëm Pipa, po dhe vetë gjuhëtarët sot që janë dhe më të lirë të shprehen, e mbi të gjitha shembujt dhe trajtimi i Gramatikës I dhe II.

Në këtë kontekst na sqaron përsëri Beci: “*U hartua platforma, u përcaktuan njerëzit që do të ftoheshin dhe kumtuesit. Këto bëheshin si fshehurazi, nuk ishte shumë e qartë se si bëheshin, po një gjë dukej qartë, njerëzit e partisë ishin të gjithë në lëvizje, dukej sikur po organizohej një Kongres partie, e jo një konferencë shkencore.*”²²

Prof. Ismajli në veprën e tij *Drejtshkrimet e shqipes*, jep një pasqyrë të qartë të diskutimeve të grupeve të punës që përbëheshin jo vetëm nga gjuhëtarë të mirëfilltë, por dhe drejtues partie.

¹⁹ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973, 5.

²⁰ R. Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005. Në këtë punim jepen të gjitha takimet dhe diskutimet që nga 1948 e deri me 1972 në lidhje me standardizimin.

²¹ Beci shprehet se “*Gjuha e vendosur si standard, ka qenë më shumë një gjuhë gazetash, një gjuhë burokratike, më shumë se një gjuhë letrare e mirëfilltë; këtu përjashtoj shkrimtarin e madh Ismail Kadare, i cili diti ta lëvrojë gjuhën, ta shpëtojë nga ngurtësimi*” (*ibid.*), pra një gjuhë demagogjike si dhe fryma që kishte në bazë ajo.

²² <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

Në këtë kontekst mund të shtojmë dëshmitë reale të diskutimeve të bëra në atë kohë veçanërisht në sesionin e 1952, ku pati debat të argumentuar në lidhje me platformën e propozuar. Kujtojmë diskutimet e Xhuvanit, Çabejt, Gurakuqit, Siliqit, Myderrizit.²³ Një gjë e tillë vihet re edhe në mbledhje të tjera, po kjo prirej erdhi duke u zbehur më vonë nga frika e ndëshkimit politik.

Pra në këtë aspekt vërtetohet teza e Pipës në lidhje me ndikimin vendimtar politik të klasës në pushtet për hartimin e këtij procesi.

Pipa gjithsesi, duke mos qenë në dijeni të detajeve, po natyrisht duke e njohur mirë natyrën e politizimit të procesit, lodhet aq shumë duke na dhënë me detaje një pasqyrë aq të qartë të ndikimit të teorisë së Marr-it në këtë kontekst. Nuk mund të themi se Marr-i dhe teoria e tij nuk ka ndikuar të paktën si frymë, megjithëse Pipa thotë se Marr-in nuk e realizoi plotësisht as Stalini. Ajo që të bën përshtypje është se, pavarësisht mjeshtërisë për ta paraqitur procesin me tone gjithëpërfshirjeje, që kishin në bazë debat shkencor, në realitet u reflektua me një përthyerje kaq të fortë mes asaj që prezantohej dhe asaj që realisht induktohej, sa dhe njerëzit e thjeshtë e dallonin ndikimin politik që induktoi realisht atë që Pipa e quan “kolonializëm krahinor gjuhësor”.

Këtu duam të sqarojmë një fakt. Me aq sa kemi lexuar në lidhje me procesin e standardizimit të kodeve të tjera, natyrisht që ndikimi politik është i pashmangshëm, pasi të paktën përhapja e standardit si fazë bëhet sipas

²³ Mjaft pikante është edhe pjesa e cituar nga referimi i Shuteriqit “..lufta n.cl nxori një mori kuadrosh të reja, të cilat muarën në dorë frenat e shtetit e të gjithë veprimtarisë shoqërore. Kuadrot e reja dual sidomos nga jugu, sepse aty qe vatra ë e madhe n.cl. Këto kuadra duke përdor dialektin e tyre si gjuhë shkrimi, bënë që dialekti jugor në mënyrë spontane, të ketë një sipëri dërrmonjëse mbi dialektin tjetër.”., Buletin për Shkencat Shoqërore, IV, 1952, f.14.

udhëzimeve të institucioneve shtetërore (gjuha e shkollës, administratës, gjyqësorit, medias deri diku).

Problemi në Shqipëri qëndron në faktin se i gjithë ky proces shitej si një proces normal studimi, debati konstruktiv, madje me pjesëmarrje të gjerë dhe jashtë kufijve, kur është e verifikueshme se veprat e para ishin normativizuese dhe nuk mund të lejohej për debate të shumta në proces. P. sh. Selman Riza, një shkencëtar i mirëfilltë, një ndër gjuhëtarët më të mëdhenj tanët, sipas nesh, dhe që kishte dhënë alternativa²⁴ në këtë fushë, nuk u lejua të referonte, sipas Becit²⁵ (Do të flasim më poshtë për këtë.).

E gjithë kjo panoramë në fakt është pasqyrë se si induktohej procesi nga politika, për të krijuar hegjemoninë e variantit të tyre dhe e gjitha kjo mbulohej me demagogji gjithëpërfshirëse, praktikë e njohur diktatoriale edhe për shumë procese në shumë fusha të tjera.

Në këtë kontekst citojmë sërish Becin si dëshmitarin okular: *“Një gjë ishte e qartë: në kongres do të merrnin pjesë dhe do të mbanin kumtesa njerëz që kishin dhënë “prova” të aprovimit pa rezervë të projektit ose, siç thuhej atëherë “njerëz të devotshëm”.*

Asnjë “gabim” edhe për sa u përket kumtuesve dhe kumtesave që do të mbaheshin. Ku ishte parë që temat e kumtesave të një kongresi shkencor të përcaktoheshin nga drejtori i Institutit dhe sekretari i partisë, në bashkëpunim edhe me ndonjë vegël tjetër të tyre? Të gjitha këto fshiheshin prapa emrit të të ashtuquajturit komision organizues i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ku figuronin edhe emrat e të

²⁴ Selman Riza. (1944). *Tri monografia albanologjike*. Vepra 1. Tiranë.

²⁵ <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

ftuarve nga Kosova dhe nga arbëreshët e Italisë, po që nuk dihej ende nëse do të vinin apo jo në Kongres.”²⁶ (ibid. ibidem).

Debatet e ngritura pas botimit të veprës së Pipës

Prof. Xhevat Lloshi, një personalitet në gjuhësinë shqiptare, ka botuar në vitin 1992 një shkrim prej 29 faqesh në revistën “Sot” (“*Kultura shqiptare para shqetësimesh të reja*”, Tiranë), në të cilën prezanton një oponencë në lidhje me monografinë e prof. Arshi Pipës me tone të ngritura. Pavarësisht kësaj dhe, duke u munduar që të jemi sa më objektivë, natyrisht brenda një konteksti diskutimi mjaft të ashpër, duhet thënë se ky punim përbën oponencën më serioze që merret me shembuj konkretë nga monografia e Pipës dhe jep argumentet e veta. E theksojmë edhe një herë se do marrim në analizë vetëm ato argumente, që kanë të bëjnë me procesin e planifikimit gjuhësor dhe realizimit konkret të standardit të shqipes.

Po e nisim trajtimin sipas rendit që ka ndjekur prof. Lloshi. Një ndër këto argumente të tij ka të bëjë me faktin se ky variant i paraqitur kishte miratimin dhe firmën edhe të shqiptarëve të Kosovës. Ai shtron pyetjen: “*Si u arrit që këtë shqipe e pranuan përgjithësisht shqiptarët brenda kufijve të asaj që tashmë është ish Jugosllavia*” (Lloshi, 1992: 8).

Mendojmë se përgjigjen për këtë e gjejmë prapë të Beci që thotë:

“Mbaj mend që, kur po flitej se të ftuarit nga Kosova nuk do të vinin, e pyeta Kostallarin:

– A do të mbahet kongresi po të mos vijnë kolegët nga Kosova?

– Patjetër që do të mbahet, - më tha.

²⁶ <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

*Pra, kongresi do të mbahej edhe sikur përfaqësuesit nga Kosova të mos vinin.*²⁷” (ibid. ibidem).

Gjithsesi prof. Lloshi ngulmon, duke thënë se “Konferenca gjuhësore e Prishtinës e 1968 u mbajt nën parimin “Një komb një gjuhë”, që e paraqiti në emër të gjithë forcave intelektuale e kulturore të Kosovës profesori Ali Hadri.” (Lloshi, 1992: 8).

Në lidhje me këtë fakt po i referohemi prof. Rexhep Ismajlit, dhe përkatësisht monografisë së tij, të miratuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë.

Ismajli pranon faktin se puna për hartimin e standardit kishin filluar që më parë (siç thotë Pipa me të drejtë) dhe madje deri në 1968 punët në lidhje me këtë proces kishin qenë të ndara. Citojmë: “*Studimi i kujdesshëm i rrjedhave tregon se në Prishtinë nga viti 1952 e deri më 1968, proceset në fushën e planifikimit gjuhësor dhe krijimit të mjeteve për standardizimin u zhvilluan në duke ndaras nga zhvillimet në Shqipëri.*” (Ismajli, 2005: 6)

Gjithsesi ai pranon se kishte persona të implikuar në këtë proces (pa dhënë emra, mbase edhe ata që Pipa i quan studentë) që ndërlidhnin zhvillimet në të dy anët.

Me mjaft interes është pohimi tjetër i Ismajlit, po në të njëjtën faqe (Ismajli, 2005:6), në të cilin shprehet: “*Qarqet intelektuale, ndoshta edhe zyrtare, në Prishtinë sikur zgjodhën rrugën më të shkurtër në këtë drejtim: lanë që me çështjet e planifikimit gjuhësor-drejtshtkrimor të merreshin qarqet në Tiranë, sepse, pos të tjerash, këtu u desh të përqendroheshin në aspekte të tjera në fushën e gjuhës, në krijimin e hapësirës së lirë për përdorimin e saj.*”

Deduksioni është i qartë, duke na lënë të kuptojmë se sa ka qenë ndikimi i kësaj pale në këtë proces, pavarësisht se dhe vetë shprehen se kishin synime të tjera. Në fakt uniformiteti edhe atje kishte filluar me kohë, pasi vetë Ismajli pranon se Ortografia e botuar në Prishtinë në 1964

²⁷ <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

ishte shumë e afërt me atë të botuar në Tiranë më 1956. Megjithatë ai pohon se ka pasur edhe kontestime në lidhje me këtë proces.

Duke i shtuar këtu edhe pohimet e Becit të dhëna më sipër mund të gjykohet vetë se çfarë roli realisht ka luajtur pala kosovare dhe a mund të thuhet se pranimi ishte realisht kontribut i një pune të përbashkët. (E dimë që është një diskurs joetik, po jemi të detyruar që të japim edhe mendimin e E. Lafes të dhënë më sipër në lidhje me palën në fjalë. Citojmë shprehimisht “*E përsëris edhe një herë se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës si institucion nuk ka bërë ASGJË për gjuhën letrare shqipe ose, po të doni, ka bërë një ASGJË të madhe, për të mos thënë ka futur shkopinj në rrota!*”).

Megjithatë duhet thënë se vendimi i kësaj pale përfaqësuese të Prishtinës nuk mund të gjykohet nga pozitat e sotme, pavarësisht se ne na duket absurd sot, pasi ai kishte në themel prioritetet e tjera që lidheshin me ekzistencën politike të tyre si etni. Do ishte shumë interesante nga pikëpamja shkencore të shihnim produktin sot, nëse ata do kishin zgjedhur variantin e tyre gegë, pavarësisht se është komplet e dukshme se pranimi në masën e madhe folëse atje po e po, po dhe këtu nuk ka qenë i plotë.

Në lidhje me argumentin e dhënë nga Pipa se Komisia Letrare më lëshimet e bëra në fakt e shkatërroi parimin fonetik (Pipa, 2010: 3) që është baza e drejtshkrimit aktual, Prof. Lloshi shprehet: “*Nuk ka asnjë mundësi që drejtshkrimi i shqipes të mbështetet vetëm në parimin fonetik. Ky parim do të thotë të shkruhet siç shqiptohet. Këtë mund ta arrijë me përfaqësi alfabeti fonetik ndërkombëtar. Por edhe sikur ta marrim parasysh atë, cili shqiptim do të marrim për bazë? Të kujt konkretisht, të cilit fshat, qytet, lagje, krahinë, shtresë të popullsisë? Prandaj është i ndërlikuar ky problem, prandaj kërkon një proces të gjatë....*” (Lloshi, 1992: 13).

Duhet sqaruar se në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* (1973:7-8) përcaktohet se **parimi kryesor mbi të cilin ngrihet drejtshkrimi është pikërisht parimi fonetik**. Në

ndihmë të tij vjen në raste të caktuara ai morfologjik dhe më rrallë ai etimologjik.

Sipas kësaj logjike, nëse procesi ka qenë i mirëmenduar teorikisht, si ka mundësi që ai ka përzgjedhur parimin kryesor të kësaj ngrehine pikërisht atë parim që qenka kaq problematik dhe që në fund të fundit nuk i qenka gjetur një zgjidhje? (Ka shumë deduktime kjo pjesë, por nuk po ndalemi te të gjitha).

Po shtojmë edhe një fakt që mendojmë se është i rëndësishëm. Në vitin 2014 Departamenti i Gjuhës shqipe, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, organizoi një konferencë me titull “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe dhe diskutimet e sotme mbi të”. Në të u diskutuan propozimet e ngritura nga Këshilli Ndërakademik për ndryshimet në drejtshtkrim.²⁸

Referimet që lidheshin me propozimet e nivelit fonetik u përqendruan kryesisht në lidhje me zanoren “ë” në pozicione të caktuara (zakonisht të patheksuara). Referimet kryesore (L. Buxheli, K. Jorgaqi) vinin në dukje faktin se, pavarësisht se parimi i këtij sugjerimi kishte në bazë parimin fonetik, ato nuk ishin dakord me këtë, pasi nuk kishte (nuk ka akoma) një manual të qartë në lidhje me shqiptimin (L. Buxheli, 2014: 15)²⁹ dhe nuk mund të shkojë asnjëherë paralelisht shkrimi me shqiptimin (K. Jorgaqi, 2014: 29).³⁰

Nga ana tjetër, të dyja referueset pranojnë faktin se këto ndryshime nuk mbështeten mbi të dhëna statistikore. (Në fakt këto diskutime dhe kjo frymë pune, e cila nuk merr parasysh as parimin real fonetik dhe mbështetjen e tij në të dhëna statistikore është pikërisht ajo metodë e cila

²⁸ Shih A. Ndoja, “Mendime mbi materialin e grupit të punës së sintaksës”, *Studime Albanologjike*, nr. 1, 2014.

²⁹ L. Buxheli, “Përmirësimi i rregullave drejtshtkrimore në përputhje me realitetin gjuhësor dhe bazën e drejtshtkrimit ekzistues”, *Studime albanologjike*, nr. 1, 2014.

³⁰ K. Jorgaqi, “Reforma drejtshtkrimore dhe planifikimi gjuhësor”, *Studime Albanologjike*, nr. 1, 2014.

ishte ndjekur që herët, kur u përcaktua standardi dhe që me të drejtë e kërkonin dy referueset.)

E njëjta gjë është edhe diskutimi në lidhje me ndryshimin e *-nj* në *-j* te emrat e tipit *kufinj-kufij*.

Po si mendon prof. Beci, si një ndër foneticienët tanë më të mirë, në lidhje me parimin fonetik? Ai pohon se që në atë kohë e kishte kundërshtuar këtë parim, madje për këtë i “kishin sugjeruar” të ndryshonte referim. Citojmë: “Në një takim në drejtorinë e Institutit u diskutua edhe për kumtesat e punonjësve të tij. Më pyetën edhe mua se çfarë kumtese do të mbaja. Do të flas për parimet e drejtshkrimit të shqipes, u thashë. Me të mbaruar takimi, Kostallari më thirri në zyrë dhe më kërkoi hollësira lidhur me kumtesën që do të mbaja. Ishte i shqetësuar, ndoshta edhe kishte të drejtë, se në një mbledhje për diskutimin e projektit në Institut, unë kisha deklaruar se parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes nuk është parimi fonetik. Ka qenë i jashtëzakonshëm presioni që të ndryshoja temën e kumtesës³¹.” (ibid. ibidem).

Pra si përfundim foneticienët dhe jo vetëm (më poshtë do të japim pohime të tjera) mendonin se në fakt nuk ishte parimi fonetik ai që po zbatohet në drejtshkrim dhe, nga ana tjetër, kjo gjë u bë në mënyrë aq arrogante, pasi nuk u mbështet as në të dhëna statistikore të paktën për ta justifikuar disi këtë. Një pjesë e debateve në takimet mbi standardin kanë lidhje pikërisht me këta shembuj që lidhen me këtë parim. Ndjesë harruam se në manualin e drejtshkrimit thuhet se ishin pyetur edhe masat punonjëse, po nuk jepet asnjë përqindje në lidhje me mendimin e tyre (*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973: 19).

Në vijim të trajtimit të prof. Lloshit, në f. 21 ai vë përballë lexuesit tri teza. Citojmë: “Përmbledhtazi kemi përballë tre teza:

A. Pipa: GNL është trillim artificial, i dështuar, një shfaqje e imperializmit kolonial shtëpiak.

³¹ <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

A. Kostallari: GNL është një koine sui generis, rezultat i konvergjencës, i bashkëveprimit dialektor, ku elementet e dy dialekteve janë ndërthurur organikisht.

J. Byron: GS është rezultat i lëvrimit dhe i ngritjes në një cilësi tjetër të variantit letrar të toskërishtes.

Nga leximi i materialit të Pipës dhe stilit të tij të të shprehurit është e dukshme se ajo që merret si tezë është në fakt qëndrimi i tij ndaj tezës së artikuluar më parë e cila, siç shprehet vetë, konkretizon tezat e Byron-it (në fakt jo vetëm). Citimin e kemi dhënë në fillim të artikullit. Kështu që i bie që të kemi dy teza në analizë, atë të Kostallarit dhe atë të Byron-it e Pipës.

Nga ana tjetër konotacioni i Lloshit në lidhje me tezat e Byron-it është pozitiv, pasi thotë “*Mund ta kundërshtosh për mjaft gjëra J. Bajron, në shkencë ka dhe mendime të kundërta, por qoftë edhe nga ky paragraf i shkurtër* (teza e saj, A. D.) *mund të duket mirë se në libër* (librin e saj, A. D.) *ka një përdorim të përpiktë të nocioneve e të termave e jo një përshtjellim arshishkencor.*” (Lloshi, 1992: 21).

Në këtë mënyrë duket qartë se ai, si gjuhëtar i hollë dhe i mirëformuar në disa fusha pranon Byron-in (e nëpërmjet saj Pipën), pasi ai e dinte mirë se veç një koine nuk kishte e nuk ka në këtë standard. Në mënyrë të hapur ai flet në shumës, në emër edhe të të tjerëve duke e pohuar vetë këtë. Dhe e bën pikërisht këtë në pjesën që i referohet trajtimit të Pipës mbi Kostallarit si truri organizues i vënies së hegjemonisë së toskërishtes letrare në bazën e standardit.

Citojmë: “*Tani po themi dy fjalë për tezën e Kostallarit. Po flas në numrin shumës, sepse ky ka qenë kurdoherë mendimi i shumicës dërrmuese të gjuhëtarëve shqiptarë. Për ne ishte fare e qartë se si GS po ngrihej varianti letrar me bazë toskërishten, kjo ishte e qartë edhe me gjithë inteligjencën, njerëzit e kulturës, të shkencës, të arsimit shqiptar.*” (Lloshi, 1992:21).

Madje në vijim ai pajtohet me mendimin e Pipës që e konsideron Kostallarit diktator (Lloshi, 1992: 25)

Këtu nuk besojmë se ka nevojë për komente.

Përfundime

Në fund të këtij punimi duhet të themi se ky trajtim nuk shteron ato që mund të thuhesh në lidhje me vlerat e diskutimet në lidhje me veprën e Arshi Pipës. Po kështu ai nuk pretendon që të ketë shteruar dhe gjithë literaturën ekzistuese e në këtë kontekst argumentet e kundër-argumentet në lidhje me këtë vepër. Një nismë e tillë do të ishte në kuadrin e një monografie. Ajo që duam të themi është se edhe me aq referime sa dhamë, është i pakundërshtueshëm ndikimi politik kushtëzues në përzgjedhjen e variantit me prestigj që nuk lejoi as diskutime, alternativa apo përlllogaritje statistikore të pjesës që nuk i përkiste ai variant në raport me pjesën tjetër së cilës i përket dhe që vazhdon të jetë akoma në minorancë.

Po kështu është i pakundërshtueshëm fakti se toskërishtja përbën bazën e këtij standardi dhe ai nuk përfaqëson një koine që ka ardhur si rezultat i bashkëveprimit të dialekteve.

Parimi fonetik si baza e përcaktimit të tij pranohet dhe nga firmëtarët e drejtshkrimit se nuk ka si të jetë baza e drejtshkrimit, pasi është i pazbatueshëm (të paktën me ato rregulla që parashikon *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973).

Rolin parësor në këtë proces e ka pasur Tirana zyrtare dhe palët e tjera në përgjithësi kanë pasur një rol periferik në të, duke e justifikuar pranimin si pjesë të prioriteteve ekzistenciale të tyre si etni.

Atëherë shtrohet pyetja pse Pipa vazhdon të mos studiohet madje dhe anatemohet me vrazhdësi akoma dhe sot?

Bibliografia

Beci, B. (2021). “‘Përjetimet’ e një akademiku si Bahri Beci”, <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

Byron, J. (1976). *Selection among Alternates in Language Standardization: The case of Albanian*, Mouton, Hage & Paris.

Crowley, T. (2003). *Standard English and the Politics of Language*. Palgrave Macmillan.

Charles A. Ferguson (1959) "Diglossia," *WORD*, 15: 2, 325-340, DOI: 10.1080/00437956.1959.11659702

Deda (Ndoja), A. "Le të kujtojmë porosinë e Çabejt për standardin" (*Panorama*, 2012): <http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/>

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, Tiranë.

Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, 1973, Tiranë.

Haugen, E. (1966). *Language conflicts and language planning*. Haward University Press.

Haugen, E. (1972). *Language planning, theory and practice*, in E. Haugen (ed.), *The ecology of language: Essays* (pp. 287–295). Stanford: Stanford University Press.

Haugen, E. (1987). *Blessings of Babel. Bilingualism and language planning. Problems and pleasures*. Berlin, New York: Mouton de Gruyter.

Hickey, R. (2012). "Standard English and standards of English." *Standards of English: Codified Varieties around the World*, edited by Raymond Hickey, Cambridge UP.

Ismajli, I. (2005). *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë.

Lloshi, Xh. 1992. "Kultura shqiptare para shqetësimesh të reja". *Sot*. Tiranë.

Milroy, J.& Milroy, L. (1985). *Authority in language*. Routledge.

Milroy, J. (2006). *The ideology of the standard language*. Routledge.

Riza, S. (1996). *Vepra 1*. ASHAK. Prishtinë.

Studime albanologjike, 2014/2. Tiranë.

Shuteriqi, Dh. (1952). *Buletin për Shkencat Shoqërore*, IV. Tiranë.

ANTON NIKË BERISHA

RRETH DY KRIJIMEVE POETIKE TRONDITËSE
TË ARSHI PIPËS
(Poezisë “Kosovës” dhe poemës “Kanali”)

Po e nis këtë kumtesë timen me një falënderim drejtuar Këshillit organizues të Simpoziumi jubilar Arshi Pipa 1920-2020. Nuk po i përmend arsyet e tjera, po njëherë nga më të rëndësishmet po e them përmes një mendimi të Martin Camajt, që ma kishte nisur në një letër të tij, ku fliste për figurën dhe rëndësinë e prof. Arshi Pipës si shkrimtar: “*Besoj se Shqipnia do të jetë me të vërtetë e lirë, vetëm atëherë kur shqiptarët do të kenë mundsi t’i lexojnë, t’i studiojnë dhe vlerësojnë veprat e shkrimtarëve të tillë të mdhaj si Arshi Pipa*”.

Dy krijesat poetike të Arshi Pipës, që po i marr vështrim në këtë kumtesë: poezinë “Kosovës” dhe poemën “Kanali”, të botuara në veprën e tij *Libri i burgut* (Romë 1959)³² nuk janë vetëm ndër më tronditëset që janë shkruar në gjuhë tonë shqipe dhe shprehin fatin dhe tragjiken e njeriut tonë, po dhe më artistikët që kanë dalë nga pena e këtij autori. Edhe si sistem i të shprehurit gjuhësor poetik krejtësisht të lirë edhe si qenësi e shumësi kuptimi, ato përlligjin në mënyrë të mirëfilltë atë që thoshte vetë prof. Arshi Pipa: “*Unë mundem me heqë dorë nga gjithçka, por jo nga mendimi; kjo është e mira ime më e naltë, madje e mira ime absolute [...] Kanë prangosë trupin tim, por nuk kanë mundë me prangosë mendimin tim. Dhe – gjâ*

³² Shih Arshi Pipa, *Libri i burgut*. Roma 1959, 22- 23 dhe 63-79.

vërtetë e mrekullueshme – kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë”.

Krijesat poetike: “Kosovës” dhe “Kanali” dëshmojnë sa lirinë aq dhe pasurinë e të shprehurit, fryt i përkushtimit dhe i dijes, ku në të njëjtin rrafsh dhe me të njëjtën përmasë (dimension) autori i qaset dhe e shqipton fatin tragjik të njeriut tonë në një rrjedhë konkrete kohe – kohës së komunizmit, kur përjetoi zezonën e parëndomtë shpirtërore – një ferr shpirtëror dhe fizik që la pasoja të mëdha në jetën e brezit përkatës dhe të brezave që pasuan. Pra, këto krijesa poetike, për shumëçka të veçanta, ndërlidhen e njësohen me dramën dhe tragjiken e përmasës biblike që shqiptohet përmes teksteve poetike e të mesazheve të shumta që dalin prej tyre.³³ Në to Arshi Pipa përdori një varg metrik të përcaktuar – njëmbëdhjetërokëshin me rima llojesh të ndryshme. Poezia “Kosovës” është e përbërë nga 11 strofa katërshe me rimën ABAB, ndërsa poema “Kanali” nga 24 sonete, me rima ABBA (në dy strofat e parë) dhe AAB në strofat trevargjeshe).

Në rrafshin e objektit poetik ato shqiptojnë një realitet jetësor tronditës, të rëndë e të zhveshur nga çdo përbërës të mirësisë e të dinjitetit, që shprehet përmes artit, domethënë përmes tekstit, fryt i aftësisë dhe i dijes.

Këto krijesa ndryshojnë mes tyre nga fakti se në poezinë “Kosovës” dhunën ndaj shqiptarëve e shkakton pushteti serb përmes politikës shkombëtarizuese dhe shkatërruese, ndërsa në poemën “Kanali” gjithë tragjiken e shkaktojnë komunistët shqiptarë ndaj njerëzve të gjuhës e të gjakut të tyre. Pra, në të parën dhuna dhe tmerri

³³ Shih për figurën e Arshi Pipës dhe për disa nga veçantitë e veprimtarisë së tij në librin tim *Arshi Pipa krijues i mendimit të lirë*. Letra, bisedë, poezi, kritikë. Faik Konica, Prishtinë 2018.

shkaktohen nga i huaji, po si pasojë e tradhtisë së komunistëve shqiptarë, të cilët ua dhuruan Kosovën serbëve, të dytën nga vetë shqiptarët, gjë që përligj tragjiken më të madhe dhe të shumëfishtë.

Rrëfimi poetik i Arshi Pipës në këto krijesa përqendrohet në dy rrafshe kryesore: *a)* në shqiptimin e botës së dhunuesit dhe *b)* në shqiptimin e botës së të dhunuarit, pësimtarit.

Në rrafshin e parë shqiptohen format e ushtrimit të dhunës e të tmerrit nga dhunuesit; depërtohet në brendësinë e shpirtit të egër që e dëshmojnë ata në format të ndryshme; shqiptohet edhe kënaqësia e tyre që jo vetëm ua shtrojnë dhunën, po dhe i tallin, i përbuzin dhe i përdhosin në mënyrën më të ulët të mundshme.

Pra, përmes tekstit poetik të hartuar me përkushtim Pipa shpreh sidomos egërsinë, urrejtjen e dhunuesve, që shpesh merr përmasa të bishës, edhe pse ata mbajnë emrin njeri. Kjo dhunë dhe ky tmerr, shpesh çmendurak, përlijet nga pësimet e të burgosurve gjatë punës **në tharjen e Kënetës së Maliqit, në Vloçisht, ku** “*struken gjindja ndër mbuloje: / një lamsh ku qelben recka e mish njeriu*”, “*Shauretën janë qi nga vorrezat çohen*” dhe ku “*E dergjet lodhja*”.

Vargjet e natyrës së tillë tronditëse, vijëzime pamjesh thellësisht rrëqethëse, poezia shqipe nuk i njohu më parë, kur objekt vështrimi bëri realitetin e përditshëm.

Në poezinë “Kosovës” dhe në poemën “Kanali” shqiptohet realiteti sa i dhimbshëm aq dhe i trishtë dhe i tmerrshëm “*Ushunizat vijanoz / na thithshin edhe at gjak tuberkuloz*”, që e tejkalon dhe vetë botën e ferrit të *Komedisë hyjnore* të Dantes. Në krijesat e Pipës ferri nuk shprehet në rrathë, siç ngjet në veprën e poetit të shquar italian, po në vijën vertikale; kapen pjesët e fundit –

fundësia, shkulmat e frymëmarrjes së njerëzve, të cilët të dërrmuar nga mundimet dhe pësimet më shumë janë kufoma sesa njerëz.

Poeti Pipa e ka parë dhe e ka përjetuar vetë zezonën, katrahurën që shqiptari bëri ndaj shqiptarit, edhe pse ajo që shpreh poeti përmes tekstit poetik është vetëm një pjesë e tmerrit të ushtruar e të përjetuar, siç na bën të ditur vetë Pipa: *“Ndër kto tingëllime nuk ka veçse një pikturë të zbetë të gjendjes³⁴”*.

Pamjet në poemën “Kanali” e tejkalojnë dhe tmerrin e kampeve naziste të shfarimit: Buchenwald-it, Dachau-t ose Majdanek-ut, siç e përmend dhe poeti ynë:

*Se kamp pune ky kurr nuk qe vërtet
por kamp çfarimi ku ndryshojnë veç shtigjet.
O Majdanek ku trupi n'furra digjet!
Por pllambë e dhë , Vloçisht, ke ti skelet! (XXIII)*

ose

*A mund të quhen njerëz? Qe, shikoj.
Fëtyra dheu ku s'yt e shojtun ngrohen
kur shofin bukën; faqe qi gropohen
e nofulla qi dalin si patkoj. (III)*

Në 24 sonetet e poemës “Kanali”, përmes artit, e jo retorikës e fjalëve të mëdha, Pipa shqipton thellësisht dhunën dhe fatkeqësinë që pësonin kundërshtarët politikë dhe të burgosurit të regjimit komunist, të shpallur “tradhtarë”, midis të cilëve ishte dhe vetë Pipa, ku *“Na nisshin trok nën rythmin e kërbaçit”, “me mishin plagë qi dukej*

³⁴ Arshi Pipa, *Libri i burgut*. Roma 1959, 200.

mish i krymtë”, “Vdesin nën shtrat ku mshehen për me vdekë [...] Dhe si cofina i kallin ndër hendekë”.

Për ta shtrirë e forcuar sundimin, pushtetarët komunistë i kishin mbushur burgjet dhe i dërrmonin të burgosurit fizikisht dhe shpirtërisht dhe ku vrasjet i bënin në mënyrën më të tmerrshme e të shëmtuar:

*Sa tjerë me shqelma ose me hunj u-mbutën,
E ende për s'gjalli te ajo gropë u-zhytën
Qi hapën vetë e mbushën tjerë mandej!*

Pra, u përdorën mënyra dhune e pësimi nga më djallëzoret: “*Cilat tortura lanë ata pa çpikun*”, gjë që pati si pasojë që të burgosurit të shndërrohen në lugetër (shauretë) të ngritur nga varret:

*Kambët s'i mbajnë e krahët u rrëzohen.
Si dordoleca lkunden qi vendoi
mbi hunj kopshtari. Njerëz kta ksisoj?
Shauretën janë qi nga vorrezat çohen. (III)*

Gjithë dhunës e tmerrit që ushtruan komunistët ndaj të burgosurve, poeti Pipa ia kundërvë qëndresën e të burgosurve dhe njësimin dinjitar me dhimbjen; ata as nuk u përkulën, as nuk u dhanë edhe në rrethana të tilla; është natyra e njeriut që për ligj të thuash të pamundshmen: mbijetimin dhe qëndresën: “[...] *si burra e çuna / Vdesin torturash, pa kallzue, pa u-qá*”; nga se mbështeten “[...] *te besimi i ngultë te forca e shkakut*”, tek “*lirin e andrruem te nata e bame sterrë, / e zemrat tona atë për flamur rrokën*”; ndonjëherë pa e ditur mirëfilli as vetë ta shpjegojnë si ishte e mundur kjo gjë, ndoshta si ngadhënjim moral dhe shpirtëror përballë dhunuesit:

*Se qysh tepruem nuk din kush të përgjigjet.
Topitet shkenca n'pamundsín e vet.
Natyra msheka mbrenda një vullnet
Të cilit mendja ende s'ja mati ligjet. (XXII)*

Në poezinë “Kosovës” Pipa shpreh një shqetësim dhe pezëm të pazakonshëm për Kosovën, të cilën edhe pse “*O tokë e bukur ku fjala burrneshë / ilire ushton qysh me mjegull gojdhanel!*” dhe “*o vend martyr*” udhëheqja e komunistëve shqiptarë “*Prej bastardësh tradhtue qi i zhgulën zemrën*” ia “dhuroi” Serbisë sllave, ku “*me parzmën shkelë nën themrën / mizore sllave po jep shpirt Kosova*” dhe “*Sot tjetërkush ta gzon frytin e punës*”.

Përmes tekstit poetik ndriçohet veprimi i komunistëve shqiptarë ndaj Kosovës, që në qenësi ishte një tradhti e trishtë: Kosova lihet nën shtypjen e sllavit: “*Ta shof përgakun, heu, vulën e dhunës, / qi t'la mbi vetulla kamxhiku sllav!*”, përkundër faktit që ajo ishte “*vendi ku Shqipnija leu*” dhe se Shqipëria pa Kosovën do të jetë një vend xhuxh. Kjo tradhti – kob, sipas poetit Pipa, nuk do të harrohen kurrë:

*O kob qi s'do t'harrohet kurr tevona!
Kosova e ngratë dergjet e vdes n'robní!*

ose

*Nji gjak, nji gjuhë prej kombesh tjerë na ndau
qi e murmurojnë dy Drinat dhe Vjosa. (XXII)*

Përkundër kësaj fatkeqësie si dhe të tragjikes së shumëfishtë, poeti ishte i bindur se fati i Kosovës do të

ndryshojë dhe ata që e hodhën atë në humnerë, do të shkatërrohen:

Do t'humbin shqim ata qi sot na shtypen!

Kulshedra e ré me lakminat e vjetra.

Vështirë është të gjendet edhe një poet që në atë periudhë, po edhe më vonë, me aq guxim dhe art të këtë shprehur në poezitë e veta tragjiken dhe pësimet e shqiptarit nën sundimin komunist – stalinist të Enver Hoxhës si bëri Pipa me poemën “Kanali” dhe në poezinë “Kosovës”, ku shqiptoi vuajtjet e shqiptarëve në Kosovë nën regjimin e egër dhe shtypës serbosllav.

Në fund po them se me krijesat poetike “Kosovës” dhe “Kanali” Pipa e dëshmon mirëfilli mënyrën e vet sa burimore aq dhe të mëvetësishme të vëzhgimit dhe të të shprehurit poetik të realitetit konkret, duke e përjetësuar me art të lartësuar të keqen dhe rrënimin që i solli komunizmi shqiptarit dhe botës së tij.

Prishtinë, fillimdhjetor 2020

ARISTEA KOLA

GIORDANO BRUNO, MNEMOPOEZIA QË
ALUDON DIKTATURËN DHE REZISTENCËN
INTELEKTUALE

*Jo për të, dijetarin nalt mbi fronin,
ishte ajo fë, por për ata me llofin
e shqiseve, për turmat qi s e shofin
Zotin ndryshe veç t' endun me zakonin*

*e prrallave foshnjore e kurr s e njofin.
A. Pipa, GB.*

Giordano Bruno asht një poemë sonetike me 13 njisi, që gjendet e integrueme në *Librin e Burgut* të Arshi Pipës. Asht shkruar në vitin 1955, një vjetër para se Pipa me u lirue prej burgut.

G. Bruno, siç dihet, asht martir i shkencës dhe simbol i vetëflijimit. Inkuizicioni i tij dhe i të tjerëve nga institucionet kishtarë, përban qëndrimin e patundun ndaj të së vërtetës. Në këtë figurë, Pipa, gjen analogji me fatin e vet jetësor e intelektual. Soneti nis me një citim ndër thojëza, i cili asht i ngjashëm me mendsinë komuniste (ose çfarëdo lloj tjetër sistemi totalitar) në një formë a në një tjetër:

*«Për shenjten fë! për t'lumen kishën tonë!
Shpërblimi i qiellit pre n'amshim besnikët!
Por zjarrm ka për mohuesit, heretikët!
turra ktu poshtë e ferri andej gjithmonë!»*

Përgatitet në këtë mënyrë atmosfera e zymtë për vdekjen e G. Bruno-s: “*Shenjin dha bazilika e i prini korit; / ushtuen prej kodrash tinguj kumbanarësh / e u-mbush me jone qielli i rimtë i frorit.*” Bruno-ja në këtë rast nuk asht veçse i radhës, siç qenë Sokrati, Jezusi e të tjerë. Ai mbron

shkencën dhe të vërtetën, me fjalët postulat të Galileut: “*Eppur si muove?*”. Bruno-ja nuk asht kundër kishës dhe as kundër parimeve kristiane natyrisht, por ai me të njejtën përvujtni e don dhe e respekton Perëndinë (e *deshi Perendin*) – thotë Pipa.

Para se të digjej në turrën e druve, në vend që t’supozohej pendesa, Bruno-ja monologon për çështje filozofike. Përpiqet që me i dhanë zgjidhje dyshimeve mbi traditën filozofike: citoj (“*E ju-kujtuen dyshimet qi xhakonin / e ri munduen, qortimet pse Platonin / pëlqente e kishte n’iri Filosofin*”). Me vdekjen e tij, pra të Brunos, Pipa, jo vetëm se denoncon krimet njerëzore nga ana institucionale, por dëshmon për vijimsinë e mendimit të lirë. Mendim i cili u zhvillue ndër shekuj nga Bacon-i, Hipatia, Paracelsi, Descartes-i, Spinoza e me radhë.

Këta janë modelet e Pipës, të cilët i dhanë atij kurajë që me shpëtue nga ferri komunist shqiptar. Vetëm nëpërmjet mendimit dhe shujtimit shpirtnor e intelektual ai mbërriti me mbijetue. Nji gja të tillë, Pipa e shpreh edhe në dokumentarin e realizuem gjatë viteve ’90, ku ndër të tjera thotë: “*Poezia më ka mbajtë të gjallë [...] kam studiuar gjithmonë këta më të mëdhenjtë: Gëten, Danten, Spinozën [...] kam qenë që atëherë i armatosun [...] i armatosun me dije*”.³⁵

Me randësi na duket që përmes kësaj poezie të G. Bruno-s, me theksue edhe ngulitjen propaganduese institucionale që asht ba ndër breza: nga fëminia deri te të moshuemit. Pipa në sonetin XII (12) jep nji skenë të jashtëzakonshme, me tregues vizualë e semantikë! Asht nji skenë analoge, ciklike, që përsëritet në periudha të ndryshme historike. Kjo për shkak të padijes në tanësi dhe të mospranimimit të evolucionit të mendimit. Gjatë djegies së Bruno-s në turrën e druve, shohim nji plakë që kontribuon me do krande ma shumë, së bashku me nipin

³⁵ Arshi Pipa, Dokumentar nga TVSH i viteve 90, mbas minutës 22 e mbrapa, në:

<https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>.

që ka marrë për dore [Pipa në shënimet e tij thotë se ia atribuon këtë skenë martirit Jan Huss, klerikut që pati të njejtin fat si Bruno-ja]:

*E shajnë, e gjuejnë, pështyjnë veprat e tija.
Nji plakë përshpirtshëm bie nji dorë karthija,
dhe i nipi foshnje nji gem bajami.*

Por trupi i djegun i G. Bruno-s së bashku me shpirtin bashkohet në përjetësi me ajrin dhe diellin (*e shpirt e trup përzihen me ajr e diell*) – si dy burime kryesore të jetës. Por nga ky *hi* ka me lindë nji *bimë* e re; ringjallet si feniks dhe merr emna të ndryshëm: Bacon-i, Descartes-i etj. Në nji realitet analog, kështu ka ndodhë dhe me konceptin e totalitarizmit enverian. Sado që Shqipnia ka martirë (sa shumë për nji vend aq të vogël!), të burgosun, të pushkatuem – mendja kriminale e atij pushteti, nuk ka arritë me e shue evolucionin e natyrshëm të genit njerëzor, të lirisë së mendimit, e të fjalës.

Pipa, e simbolizon dhe e identifikon historinë e intelektualëve të pakompromisë gjatë regjimit të Hoxhës dhe Alisë, me epitomën e Giordano Brunos që asht nji *mnemopoezi* (neologjizëm imi ky, për me shenjue kujtesën përmes poezisë). Pra kjo poemë sonetike, asht historia e martirizimit të dijes, shkencës, mendimit të lirë në version të reduktuem. Në vështrimin tim, përmes kësaj poezie, Pipa, fton me kujtue dhe kuptue edhe aktualitetin shqiptar, e me aludue njikohësisht enverizmin.

Në nji depistim ma introspektiv të këtij cikli sonetesh, mundemi me ballafaqë disa pikëtakime që lidhen me zhvillimet aktuale në Shqipni, sa i takon produktit letrar dhe propagandës gjatë sistemit diktatorial dhe mbasdiktatorial.

Lexuesi shqiptar, e në veçanti komuniteti universitar dhe ai akademik, studiues e profesorë, asht e dobishme të distancohen prej produkteve të realizimit socialist

sidomos kur ky produkt shkrimor ka në thelb promovimin dhe nxitjen e krimit ndaj individit dhe ndaj komuniteteve të caktueme në Shqipëri. Nji rast i tillë, fatkeqësisht, asht edhe ai i poetit laureat të shpallun në 2020 nga nji institucion kulturor shqiptar, i cili ka gjetë mbështetje —për ironi nga hierarkia institucionale!—nga nji kategori profesorësh dhe studiuesish bashkëkohës sa i takon krijimtarisë, apo thanë ndryshe *krimtarisë* së tij në realizmin socialist, si dhe mbas '90-tës. Kjo kastë studiuesish, munden me u personifikue më *plakën* (në vargjet e masipërme) që hidhte krande në zjermin, që po digjte trupin e Giordano Bruno-s, dhe nipi i saj i vogël që ndjek këshillën e plakës, asht lexuesi që merret për dore prej këtyne intelektualëve për me mbështetë nji krim të tillë. Në analogji, çdo promovues e suportues i komunizmit, me të tillë akt, kontribuon me krande në zjermin që shuen veprën e Arshi Pipës dhe të bashkëvujejtsëve të tij, njëjtë si në rastin e Bruno-s. Pra, shuemjen e historisë dhe fshimjen e memories kolektive.

Realizmi socialist në universitete me demokraci të konsolidueme, nuk asht qenësisht objekt studimi e as leximi. Jo për shkak censure, por për arsyen e thjeshtë se ajo periudhë letrare e artistike nuk përfaqë cilësi estetike të nji niveli të studiueshëm apo lexueshëm (*Kush s asht i dliirë mbaron heret a vonë*). Pra, veprave të shkrueme simbas devizës së realizmit socialist u mungon kompleksiteti, thellësia konceptuale, cilësia e ekzekutimit poetik/estetik, universalizimi, ambiguiteti, etj., e mbi të gjitha u mungon **liria e mendimit** të artistit, që në këtë rast asht veç nji recetë që tenton me mësue lexuesin sesi duhet ta shohin botën, dhe jo sesi lexuesi e sheh në të vërtetë botën. Pra, leximi i kësaj letërsie na e kufizon mundësinë e nji rileximi, mbasi nuk ka asgja me thanë.

Nëse konstatiimi mbi distancimin e kësaj letërsie, ndokujt i ngjan normativ, më lejoni me e konfirmue që **po asht normativ**. Dhe as ma pak e as ma shumë normativ sesa udhëzimi “*we must not forget*”, që përban esencën e fushatës njerëzore kundër krimeve të nazizmit

ndaj popullsisë hebreje. Në të vërtetë, asnjë tragjedi njerëzore nuk ka të krahasuem, por thelbi i çdo totalitarizmit asht i njëjtë: ai i *antihumanizmit*! Derisa *frrota*, siç thotë Pipa diku, intelektuale shqiptare, e cila asht njëkohësisht edhe udhëzuesja e lexuesit, të mbërrijë me u distancue prej produktit komunist dhe krimnxitës, demokracia funksionale në Shqipni ka me mungue, për rrjedhojë edhe në fushën e letrave, dhe Arshi Pipa si poet ka me qenë i munguem në auditorët universitarë.

KUR DY MA TË MËDHAJT I BASHKON NJI
BRESHKË*

0. *Hymje*

Me folë apo dhanë një mendim kritik (qoftë edhe në mënyrë sintetike) mbi përfundimet kanonike të Prof. Arshi Pipës për korpusin madrigal *Dranja*, të kolegut dhe mikut të tij, Martin Camaj, nuk është një sipërmarrje e lehtë tue pasë parasysh kompetencën analizuese të Pipës. Në krahun tjetër, për kulturën shqipe paradigma tekstore e frymorit të papërsosun vijon me qenë kod i kriptuem, i cili është dorëdytësue prej traditës kritike shqipe; kjo mbase edhe me të drejtë kur ka pë kulminacionin interpretimor të A. Pipës. Jemi të mendimit se statusi kritik i Pipës mbi *Dranjën*, në studimet shqipe deri më tash ka përcaktue sinoret e *alfës* dhe të *omegës*. Ai ka krye një dekriptim shumëpërmasor tue depërtue shpesh edhe në nënvetëdijen autoriale, dhe mbi të gjitha ka përkapë atë çka sot askush nuk e artikulon (në Shqipni, Kosovë e troje shqipfolëse, shto edhe Diasporën shqipe): formatin European—sidomos europeanolindor—të shkrimtarit, që gëzon Martin Camaj. Në letërsinë shqipe të ekzilit, Camaj përfaqson shembullin e ekzilentëve të tjerë

* Ky shkrim është një version i zgjanuem dhe i ripunuem i kumtesës dhe i shkrimit tonë ('Mendimi kritik i Arshi Pipës mbi veprën *Dranja* të Martin Camajt') depozitue për botim në AIDSSH, me rastin e diskutimit në "95 vjet Martin Camaj – vepra dhe përndjekja", mbajtur në Pallatin Presidencial, Tiranë, më 28 gusht, 2020. Mbi botimin e përmbledhjeve të kumtesave nga ana e institucionit përkatës, deri në këtë moment, ne personalisht si pjesëmarrës të asaj tryeze të rrumbullakët, nuk kemi asnjë informacion zyrtar.

bashkëkohas si J. Brodsky, i cili mbeti esencialisht dhe gjuhësisht poet rus.³⁶ Asht e qartë se ajo që cilëson edhe Pipa si *poesis humi*, te rasti i Martin Camajt asht tejet shqiptare dhe metaforikisht si raporti i breshës me dheun.

Punimi kritik i Pipës, gjendet në veprën e tij *Contemporary Albanian Literature* (1991: 142-164), e njikohësisht në kolanën e veprës Camaj të botimeve Onufri (2010: 15-42), përkthye nga i ndjemi Myftar Gjana. Arshi Pipa, për shkaqe që dihen, asht kritiku i parë që orienton një sistem kërkues-kompleks mbi këtë vepër letrare. Natyrisht, mbas 90-s, kritika shqipe—që shpesh asht mbështetë në Pipën pa e citue aspak—ka dhanë kontributin e vet mbi *Dranjën*, edhe pse ende sot e kësaj dite vijon me mbetë një vepër ‘e parrokshme’ për kah niveli i dekodimit, siç u tha në krye. Në shkrimin tonë tonë, nuk asht në interesin përkatës me u ndalë në produktin kritik të disa studiuesve të Martin Camajt, por posaçërisht të A. Pipës.

1. *Metodat kërkimore të Arshi Pipës mbi Dranën*

Dranja u botue në 1981 (Roma: Tipografia Detti*),³⁷ dhe dhetë vjet mbrapa, Pipa mbërriti me kanonizue një

³⁶ Me përjashtim të 20 poemave në anglisht, botue mbas vdekjes së Brodsky-t, në *So Forth* (New York: Farrar, Straus and Giroux, 1996) krijimtaria poetike e tij asht në rusisht dhe shumë pak përkthime nga rusishtja në anglisht.

Shih edhe Albanian Panel (*Literature in Albania from Communism to the Present*) University of Michigan, March 31, 2021, ligjëratën dhe diskutimin e Lisandri Kolës: <https://www.youtube.com/watch?v=QNAq3I8hNgA&t=2865s>

³⁷ Citimet që do të shënohen me yllth (*), tregojnë se janë marrë nga ky botim [1981], ndërsa ato pa yllth nga botimi Onufri. Arsyeja në referimin e dy botimeve, nuk ka një shkas të veçantë përpos disponimit të veprës *Dranja* (rrjedhimisht të bott. 1981 dhe

studim introspektiv mbi madrigalin (e shprishun), që asht njëherësh shembulli unik i letërsisë shqipe, zhvillue në ekzil. Kandvështrimi i Pipës, në zbërthimin e kësaj vepre asht i lidhun fund-e-krye me dimensionin autobiografik të Camajt, dhe me statusin e tij si autor shqiptar në etapa të ndryshme jetësore dhe letrare. Çka asht me interes me theksue, në analizën e thukët të Pipës, asht interpretimi fizik dhe semantik i librit *Dranja*. Pipa, e analizon këtë vepër, prej këmishës së librit, treguesve të tjerë tipografikë dhe deri në semantikën e imtë të këtij madrigali kontrovers. Ngjanë se ky kritik, e strukturon vizionin e tij mbi librin si të kishte para breshkën Dranja: domethanë ndërton një hipotipozë mbi këtë ‘frymor të papërsosun’, tue u përpjekë me shenjue edhe sinorë alegorikë të heroinës së Camajt. Breshka (asht me vend me dallue se ky emën lidhet me breshkën femën, pra: nuk asht *breshk/-an* e as *breshkujzë/-ëse*) si heroinë, asht thyemja kanonike e shumë letërsive botënore, që kanë operue me alegorinë dhe ndërkaq antipodi i letërsisë socrealiste shqipe. Në një vështrim tjetër, Dranja asht e kundërta e ‘*Shqiponjat fluturojnë lart*’—paradigmës kadareane, ku asht konturue gjeneza etnokomuniste shqiptare.

Pipa, nëpërmjet interpretimit të tij, ngre tezën e një vepre *antropocentriste*, në të cilën breshka asht modifikue dhe personalizue në aspekte mitike, tue prû reminishenca të infantile (fëminisë së autorit),³⁸ por edhe tue stabilizue një poetikë, të cilën do ta cilësonim si *poetika e të ndërmjemes*. Pse Dranja mbështetet në një poetikë të ndërmjeme? Si fillim, kjo kafshëz asht e padefinueme si kategori dhe përkatësi (*ovipares* vs. *vivipares*). Krahës kësaj madrigali në vetvete asht nënlluj poetik mes këndimit dhe shkrimit (pra muzikës dhe letërsisë), dhe ndërkohë Camaj vetë asht autor me faza kalimtare-të ndërmjeme: një autor shqiptar (burimisht prej Dukagjinit) që urbanizohet dhe

2010), në kohë të ndryshme kur u përgatit ky material nga ana jonë.

³⁸ Khs. madrigalin ‘*Te kambët e kryezotit*’* [Camaj: 10].

edukohet në qytetnime të mëdhaja, ku jep edhe kontributin e tij intelektual si linguist dhe shkrimtar, e disi ma pak si kritik. Breshka në anën tjetër, asht një frymor që gjallon mes malit dhe fushës. Analogjia me autorin e saj asht e dukshme po aq sa asht e dukshme edhe simbolika e zhguellit (rrashtës së saj),³⁹ çka tregojnë një Martin Camaj me interes apolitik dhe asocial, në shumicën e rasteve. Dranja, nuk ka synim me pasë benefite pronash dhe tokash: *‘Për t’i ndejë larg përlëshjes rreth pushtimit të trollit, e ndërtoi pullazin mbi korpin e vet të brishtë’* [Camaj: 74] ose ajo nuk don: *‘me nda kufij me askend’* [Camaj: 76]. Njëjtë si Camaj, që nuk ka interes me gjetë a ba vend në letërsinë shqipe, por me ndëjtë nën ‘pullazin’ e letërsisë: një dimension i vetëmjaftueshëm. Në krahun tjetër, simbas dëshmisë së Genc Kortshës,⁴⁰

³⁹ Për me pasë korrelatë me debatin e ndodhun gjatë vitit të kaluem (debati Camaj-Koliqi), po shkëpusim një pasazh nga Dranja: *‘Shpinën e ka të rrëzullt dhe po qe se insekti i lodhun në vjeshtë mundohet me u kacavarë mbi atë, rrëshqet e bie përtokë’** [Camaj: 9]. Nisë prej premisë së leximit që Dranja asht *persona poetica*, e cila identifikohet me vetë autorin, ndjekë dhe prej finalitetit të debatit lançue nga z. Auron Tare, mbrojtë nga disa të tjerë, na rezulton se çdo tentativë e (pa)sinqertë për me folë për shkaqe (jashtë)letrare të veprës së Camajt, mund të metaforizohet me pasazhin e masipërm që përshkruen autori. Qëndrimet tona publike mbi debatin në fjalë, mund të gjenden të aksesueshme në: *‘Shqiptarja.com’*, 6 korrik 2020 [L.&A. Kola *‘Kur mitet përfliten’* (rimarrë nga media e portale të tjera); *‘Hylli i Dritës’*, XL-2020, nr. 1 (301), 72-86 [L.&A. Kola *‘Si po rrëhet me anë të miteve’*: huazue për publikim online nga revista *Këns*, shih http://kens.al/revista/materiale_te_tjera/si_po_rrfehhet_me_ane_t_e_miteve.pdf]

⁴⁰ Referenca jonë asht rezultat i mbamendjeve leximore prej veprës *Dom Prek Ndrevasaj* (përgatitë e mbledhë nga Ndrek D. Guri) Rozafat, 2011. Nëse identiteti i Genc Kortshës nuk përkon me perifraksin e masipërm, lypim mirëkuptimin e lexuesit të mendshëm. Sidoqoftë për orientime ma të thellueme këshillohet leximi i veprës që sapo përmendëm në këtë nënvijë.

breshka ishte kafshëza e parapëlqyeme e Camajt. Në studion e tij kishte disa breshka (produkte suvenir) të pozicionueme tana kah i njeiti drejtim. Kortsha e pat pyetë (po e perifrazojmë), ‘pse kaq shumë breshka?’ e Camaj u pat gjegjë ‘këto si bajnë kurrkujt dam e rrinë në punë të vet’. Nji tjetër element i duresës së zhguellit/rashtës asht edhe fakti që rrashta e breshkës nuk kalbet shpejt: ‘*E si të bajmë me rrashta, u pyet, që s’kalben shpejt?*’ [Camaj: 78]. Prej këtu del nji tjetër analogji me letërsinë e Camajt, e cila estetikisht vëhet përballë socrealizmit shqiptar. Për aq sa mund të cilësohet breshka si pjesë e familjes së reptilëve, në Camajn nuk besojmë të dallohet ndonji *hipotezë reptoide* e mbijetimit të kësaj gjallese: teori që asht gjenerue nga niçeizmi darvinist e sidomos nga lideri i *The Doors*, në muzikë, Jim Morrison. *Dranja* nuk përputhet me teorinë e superioritetit⁴¹ të gjallesave në mbijetesë—në këtë rast të reptilëve—çka ka edhe rrajë biblike (siç do të shihet ma poshtë), edhe pse kemi pasazhe tekstuale në madrigalin e Camajt, kur ai thotë: ‘*Këndej pari, me sa di unë, nuk ka gja të gjallë pos ndonjë breshke*’ [Camaj: 100]. Këtu, posaçërisht në madrigalin ‘*Murimi*’, autori e lidhë ekzistencën e breshkës në atë vend pa gjallesa, me fatin e flijimit të Rozafës, edhe pse në këtë rast miti sërish thyhet, sepse **breshkani** (i shoqi i Dranjes) bahet flî për themelet e shtëpisë së Culit: ‘*E vranë dhe e vunë mbi currin e madh në rreshtin e gurve të themelit, po në atë vend ku u ndreq ma vonë votra e zjarmit*’ [*ibid.*, *ibidem*]. Në këtë rrethanë flijimi asht rastsor, sepse burrat nuk gjejnë gja tjetër me ‘ba gjak për themele’ përpos breshkanit. Kurse *votra* (që ndreqet ma vonë) mbetet thelbsisht konotacion femnor: ajo lidhet me perëndeshën Hestia që

⁴¹ Nuk mund të përjashtojmë ndonji ide autoriale, e cila, si tek mad. ‘*Ku breshka e ku njeriu, por..*’* [Camaj: 28], tërthorazi paraqet ndonji premisë superioriteti të gjallesës së breshkës, por kjo nuk gjykojmë se vjen si sistem klasifikues-rendor po ma shumë vjen si thyeme konvencionale për me këndue për nji frymor të papërsosun. Khs. ma sipër, në tekst, përfundime të kësaj natyre.

asht simbol i familjes, sikurse edhe Rozafa me murimin e saj, simbol i familjes. Operimi i Camajt në përmbysjen mitike të gjinive [*Camaj: breshka* vs. *Rozafa: breshkani*], asht njëherësh tentativë unike në letrat shqipe për me teorizue një mit me rotacion seksual, tue sheshue kështu dasitë e një kulture shqipe që në thelb asht maskiliste.⁴²

2. Aberracione të qëllimshme gjuhësore dhe alegoria e shndërrimit

Nji tjetër syth i poetikës së ndërmjeme asht edhe ajo që dikton me vend Pipa, stadi gjuhësor i kësaj vepre. Siç dihet, Camaj e ka reformue gegënishten tradicionale dhe ka prodhue një fazë të ndërmjeme tue huazue rrafshe ‘fonomorfologjike prej toskënishtes’ [Pipa: 162]. Ndonjiherë, me vetëdije, kemi edhe aberracione gjuhësore, të pamendueshme profesionalisht për një linguist si Camaj. Por këto, simbas Pipës, janë të qëllimshme për me iu gjejë breshkës së papërsosun, dhe një krijese të neglizhueme në folkun shqiptar. Për të thuhet se ‘asht pula e dreqit’ [Camaj: 48], çka na lidhë me dyzimin e një krijese ovipares. Edhe Mark Tirta pohon se tjetërsimi i pulës në breshkë njihet në mitologjinë shqipe [Tirta: 327]. Mandej shumë burime, siç konstaton Pipa, lidhen me një mitologji parakristiane, e pagane, tue citue shpesh edhe antropologjen Edith Durham. Korrelatat, me shembujt e dhanë prej kësaj studiueseje nga ana e Pipës, shpesh janë të tërthorta, e jo aq të përputhshme me Dranjen, simbas perceptimit të Camajt. Po saktësimi i Pipës, që Camaj paraqet një figurë mitike të personalizue me sqaron

⁴² Khs. Lisandri Kola ‘Nji vdekje që shtegton nëpër tekste’ (në Monsinor Ernest Çoba, *Keze të hueja: poezina të përkëthyme prej italishtes*, Shkodër: Fiorentia, 2020, 108): “*Doemos letërsia shqipe vuen prej mungesës materne. Mungon Maria në letërsinë shqipe... por edhe ‘Betlehem’ artistik*”.

gjithçka. Vetë emni i Dranjes që buron prej *Drandofilles* asht fazë kalimtare e shndërrimit breshkë-grue a anasjelltas. E ma tej, vetë emni *drandofille* asht burim prej greqishtes i *trantafilos* (tridhetë-fletësh), gja e cila dëshmon edhe lidhjen e një evolucioni gjuhësor e kulturor (kujtojmë mbetjet dorike në vepër apo situata që lidhen me botën antike greke). Breshka, si frymor i shndërruem dhe qenie e ndërmjeme, mendojmë se asht një 'kalkim' poetik i '*Nji ditë e ka dhe korbi*'. Pra, Camaj si autor dhe në përkim me situatat e tij jetësore-letrare, e njëh kahmot alegorinë dhe poetikën e ndërmjeme, që finalizohet në një shndërrim.

3. Dranja dhe Bibla

Herë mbas here, teksti i *Dranjes* ka ndërlidhje biblike, që Pipa i citon dhe i ka zbërthye si shëja tesktuale mjaft mirë. Megjithatë momente të caktueme, dalin të paqarta për Pipën, siç asht madrigali '*Vend nën diell*', dhe konkretisht figura e *hardhucës*. Pipa pohon: '*kuptimi alegorik i hardhucës asht i paqartë*' [Pipa: 148]. Ndërkohë se, në këtë madrigal, vizioni i Camajt asht vizioni i *Eksodit* (atij personal dhe atij biblik), e njëkohësisht mënyra sesi e përshkruen Camaj hardhucën në një terren diktatorial '*fushë përqendrimi... vathë rrethue me gardh*' [Camaj: 102] asht në përputhje me *Fjalët e Urta* në *Bibël*. Camaj thotë: '*në një brimë me faqe të ndritun guri si qelq e me shtroje rrase si fildish, banonte hardhuca*' [*ibid.*, *ibidem*]. Kjo hardhje në *Bibël* paraqitet si qenie inteligjente, e që frymon deri në pallatet e mbretënve: '*hardhuca... që gjendet në pallatet e mbretërve*' [FjU: 30, 28]. Mënyra e përshkrueme në tekstin prozaiko-poetik, na lën me nënkuptue bllokun komunist shqiptar, hierarkinë e pushtetit dhe personat me funksione politike, që në dukje ishin dytësore: '*[hardhuca] merrej me rangët e shtëpisë*' [Camaj: 102], por të cilët përcaktonin fatin e një frymori tjetër. Mbyllja e këtij

madrigali, na lejon me hedhë hipotezën për aludimin e Camajt mbi fytyrën e diktaturës me pamje grueje: *‘E zoja e plangut të mbrojtun në katër anë e këqyri Dranjen, kokërr, dhe sytë i rrezatuen avull të ngrohtë me tharm sherrie’* [ibid., ibidem]. Se kush ishte numri dy që rezultoi numri një në diktaturën enveriste, publiku shqiptar besojmë se e ka të qartë. Në këtë formë e vështrohte diktatura Dranjen [i.e. Camajn], *‘që e dinte vendin e vet ndër frymorë dhe mprihte sytë për një vend të terun’*. Del ma se i qartë metaforizimi i arratisë së autorit⁴³ nga një Shqipni komuniste, e cila

⁴³ Vrei edhe mad. *‘Ndërdyzash si të huej mbi dhé’*: *‘Tash unë dhe Dranja këqyremi ballë për ballë kokërr ndër sy, të dy të ngrimë, por ndërdyzash si të huej mbi dhé nga se asnjëni nuk di kah me ia mbajtë përpara territ, në lindje apo në perëndim?’** [Camaj: 12]. Kurse mad. që e pason këtë, *‘Në shtratin e marimangës’*, mund të lexohet si një rrëfim autobiografik i M. Camajt, mbi momentin përpara se të arratiset e konkretisht mbi *‘bashkëpunimin vetëm me firmë, me Sigurimin e shtetit komunist-shqiptar’*, ku merimangat në këtë rast, me gjasë, janë aludime për pengesa (rrjetëza), por që Dranja [i.e. Camaj] mbërrin me i *‘marrë me krye fijet e shtratit të marimangës’** e ma vonë *‘me i endë poshtë e përjetë me gishta nëpër shkorre’**. Fundi? *‘Ndër sy sa grima në ballin e shemtuem të breshkës Dranje zhbërtheu hareja e një loje të fitueme’** [Camaj: 13]. Pra, M. Camaj mbërriti me e kapërcye pezhishkën e inteligjencës sigurimse-enveriane, tue thurë me *‘dijen e grues vektare’** arratisjen e tij së bashku me një grup personash, ndër ta edhe ata për të cilët kishte firmosë se do t’i *‘spiunonte’*. Mbërrimë sërish në gjykimin, se nënshkrimi i tij, nuk e implikon aspak figurën e tij, me gjithë *‘vullnetet e ndrydhuna’* të disa nisjuesve për me prû si pjesë të debatit si Camajn si Kolqin, që me shumë mundsí synohet me amnistue, në të ardhmen, ndonji figurë bashkëpunëtore gjatë komunizmit shqiptar, që kahmot shiten ndër të huej si autorë desidentë. Thanë ma saktë, vetë Ismail Kadarenë, që ka qenë *vox Kommunismus* në sistemin letrar e kulturor shqiptar qysh prej 1954 (me *Frymëzimet djaloshare*, NSHB, Tiranë: Mihal Duri) e deri në 1991 (me *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, Tiranë: SHB “8 Nëntori”). Që shumica e poezive të para të Kadaresë, i këndojnë *‘pranverës komuniste’* [khs. *‘Shënime mbi sonetin’*, në: Lisandri

jetonte me gjallesa të papastra: *kërmij, shtërpj, lakuriqë, mij* [khs. *Dranja dhe Levetiku*: 11, 29-30]. Pak ma heret, Camaj, në madrigalin '*Kthimi te toka e thatë si buka*' alegorizon totalitarizmin shqiptar, ku nëpërmjet *ushujëzave, bretkosave, mushkajave, kërmijve dhe rriqnave* sintetizon një vizion biblik [Eksodi, *Dija, Levetiku*]. Këto gjallesa prodhojnë 'kënetën' në tekstin e Camajt, domethanë diktaturën: një vizion edhe sot aktual. Figura e 'grues së majme', në këtë madrigal, që futë kofshën e trashë në baltë dhe e qet prej aty me tufa ushujëzash 'si flokë Meduze', për Pipën mund të jetë simptomë e

Kola, *Sonete*, 2016] kjo asht e dukshme sikur ideologjizimi kontinuitiv në *Ardhja e Migjenit*... vepër e polemizuese qysh në dalje, dhe e cilësuar si reminishencë e fortë e PPSH-së (khs. Robert Elsie, 'World Literature Today', 65/4, Autumn 1991). Krahës vokacionit të Kadaresë për sistemin politik komunist në Shqipëri dhe rolit propagandues të tij, tue e ba atë si ndërmjetës kryesor të epokës së socrealizmit në Shqipëri, por edhe në Europën Lindore, ai (Kadareja pra), nuk e ka pasë të mundshme me u shkëputë nga perceptimi borgjez, kapitalist e imperialist i kohës për shëmtinë e 'botës së huej', si p.sh në poezinë e tij '*Nju Jorku natën*', ku nuk ka as lule, as bar por vetëm reptilë që shndërrohen nëpër Avenues e Streets. [Khs. '*Por zhapijntë në gjarpërinj shndërrohen më tej/Tek rruga 42,/Tek Avenju e pestë*', në: *Motive me diell*, Rilindja, Prishtinë, 1978, 42.] Kaq i '*tmerrshëm*' asht '*Nju Jorku në bukurinë e tij*' sa që deri dje, e bija e Kadaresë, znj. Besiana Kadare, ushtronte rolin e Përfaqësueses së Përhershme në MPRSHOKB (ang.: Permanent Mission of the Republic of Albania to the United Nations). Shtypi shqiptar, në fillim të tetorit 2021, njoftoi se B. Kadare do të merrte postin e Ambasadores në UNESCO.

Po shtojmë këtu se, Camaj në mad. '*Parandjenjë largimi*'* [Camaj: 29] ndërlidhë sërish aspekte të arratisjes së tij; njikohësisht në '*Verë e thatë me kandrra*'* [Camaj: 27] jepet aludimi i përndjekjes së tij. Kurse në mad. '*Ngjarje dite*'* [Camaj: 35], flitet direkt për *deportim*, si kundërpunkt i një politike enveriane, e cila ishte e pashembullt me vendet e tjera totalitare, që së paku negocionin politikisht me anë të deportimit.

‘vuejtjes nga malaria, një sëmundje e zakonshme në fushat bregdetase’ [Pipa: 148]. Ndërsa në leximin tonë, mund të jetë ritual i një shoqnie që hamendson se gjen shërim nga parazitë të një sistemi (pushteti) që nuk ngihet kurrë. Në *Bibël* thuhet se *ushujëza ka dy bija që thonë vetëm ‘Më jep, më jep’*: [*Sanguisugae duae sunt filiae: “Affer, affer!”*; *Liber Proverbium*: 30, 15]. Le të na bien ndërmend tri dekadat e tranzicionit shqiptar, dhe anomalia psikike e kësaj shoqnie për me besue se ekzistenca e kënetës sjellë dobi, aq ma tepër që koncepti i bonifikimit nuk asht ma term i hasun në kulturën e mbas 90-s. Çdo eliptizëm alegorik i Camajt, të lidhë me gjendjen e një njeriu në një terren të degraduem, ku mbijetesa e një intelektualit për ma tepër ishte e pamundun, sepse rrethohej me qenie të gjithfarëshme, të cilat i ishin përshtatë një vendi dhe rrethane politike. Prandej, Dranja asht e papërposun në një shoqni ‘të përsosun’. **Këtë mundemi me e lexue edhe për së mbrapshti**. ‘Grueja e majme’, përndryshe një figurë obeze në Shqipninë e Hoxhës—domethanë një Shqipni e ûnshme që funksiononte prej etalonëve e triskave absurde—asht larg mendsh me u konsiderue. Këto përmasa fizike që sjellë Camaj, mund të jenë kontrastim me vetë breshkën (e vogël dhe rrafsh me tokën), që shikon e çmeritun atë krijesë femnore. Obeziteti ma fort ka qenë sindromë e anëtarëve të bllokut, sepse ushqeheshin ndryshe prej popullatës. Këtu, në këtë pasazh tekstori, *hirudoterapia* (pra lëshimi i ushujëzave) nuk asht shqetësim estetik, por ritualistikë sociale (që me sa parashtuem mund të lexohet edhe si hierarki politike), për me iu nënshtrur një sistemi gjakpimës, strukturue prej parazitëve të ujnave të ambël.

Komunizmi shqiptar, ndërkohë, perceptohet dhe paraqitet nga Camaj, në disa madrigale të tjera. Në mad. ‘*Selekcioni*’ autori ndërton një narrativë përmes ‘kopshtit zoologjik’, i cili nënkupton ironikisht komunizmin: ‘*Ashtë nder e fat i madh me qenë i ndrymë në kopsht, por Dranja nuk e kaloi provimin atëherë kur u banë zgjedhjet se kush duhej të pranohej atje*’* [Camaj: 46]. Përdorë edhe për analogji, kjo

fjali parakupton edhe mëvetësi totale të Camajt për me u konformizue, tue lanë me kuptue një autor krejt jopolitik (siç e cekëm), i cili jetonte mjaftueshëm vetëm për letërsinë. Asht me vend me shënue, se në një letër kah fundi i viteve të jetës së tij (22.08.1989), Martin Camaj, i shkruente poetit Idriz Lamaj në SHBA, ‘*prej letërsisë kam pasë gjithçka, edhe vullnetin për të jetue*’.⁴⁴

4. *Përfundime*

Tash le të vijmë në disa përfundime që përputhen me *persona-n poetica* apo alteregon e Camajt: me Dranjen. Simbas konstatimeve të A. Pipës, për nga cilësia dhe gjenetika e poetikës së veprës, e cila asht mes oralitetit dhe kultivimit, përkon vetëm me *Milosaon* e De Radës.⁴⁵ Kurse si kod komunikativ, tue marrë parasysh Dranjen-breshkë, përkon me dy kriterë estetikë të stilnovistëve italianë: *modestí* dhe *përrultí* (jo doemos vizion kristian). Me De Radën lidhet edhe nëpërmes *elipsës*, figurë e folklorit shqiptar. Referue breshkës mesdhetare—tipologji e përcaktim prej zoologëve, që e përdorë vetë Camaj (llojit *testudo graece*)—kjo asht vetëm një pjesë e *ekzoskeletit*, që figurativisht simbas Camajt përfaqëson globin. Kjo heroinë, mbas mendimit tonë një Atlas që vëhet në lëvizje prej autorit, shpalosë edhe ‘hipotezën e

⁴⁴ Shih *Albanica*, 3-4 (Winter 1992), 172.

⁴⁵ Konkluzione të tilla, Pipa i mbërrin edhe tue marrë shkas nga tregues implicitë tekstori, si paragrafi I në mad. ‘*Pa sythin e dritës së qartë*’: ‘*Udhës për fushë më doli përpara lisi ma i madh i jetës sime, rrafi i vetmuem. Poeti në gjuhën time ka shkruar për atë, kangë të gjata me vargje të shkurta sa gjethi i tij.*’* [Camaj: 24]. Asht e dukshme ndërkalja nëntekstuale për De Radën, dhe vargun I të poemës: ‘*Ljís jettà chishë ndërruar*’ në: *Canti di Milosao: figlio del despota di Scutari*, ed. terza, 1873, 14. Sa i takon aspektit (hetero)metrik të poemës në fjalë, khs. Arshi Pipa, *Hieronimus De Rada* [IV. *De Rada's Metrics*, 134-57], Trofenik, 1978.

originës shqiptare’ [Pipa: 156],⁴⁶ konsekuencë që vetë Camaj e kishte si mendimtar. Tue prodhë kështu, metaforën e Atlasit lëvizës, jo aq vigan sa e jep mitologjia, Camaj ka metaforizue shtegtimin vetjak nëpër botë, ku lidhja intime *breshkë-dhé* përthyer në binomin *autor-atdhe*, tue përçue një ‘*narrativë autobiografike*’ [Pipa: 161]. Ndërkaq, vetitë e metamorfozës së breshkës, burime edhe mitike, janë pasqyrë e procesit të shndërrimit autorial në etapën europiane moderniste. Me fjalë tjera, Camaj asht *de facto* ana e kundërt e një letërsie ideologjike, shpesh lobue—e përsërisim—ndër të huej si desidencë dhe ekzotizëm. Kurrsesi nuk mendojmë se *Dranja* mund të lexohet si një *fabul naive* (!?). Kjo vepër shprehë alegorinë e një diktature si ajo shqiptare, e cila përpos rrethanave të ekzekutimit apo burgimit, prodhoi një formacion (për fat) shkrimtarësh ekzilantë, që denoncuen krimet e përgjakshme komuniste dhe folën mbi fatin e rrugëtimit tyne jetësor, pa interes vendi e përkatësie. Vepra si kjo, kanë kanonizue historinë e totalitarizmit botënor. Shtojmë këtu—tue e lidhë edhe me postkomunizmin shqiptar, me mungesën e demokracisë funksionale, dhe njëkohësisht me vetë *Drandofillen* (tridhetë-fletëshin)—se *Dranja* vijon me dëshmue *tridhetë vitet* e ‘kënetës’ socio-politike shqiptare: 1991-2021.

Bibliografia

Albanica. Winter 1992/3-4 [a Quarterly Journal of Albanological Research and Criticism: editor Arshi Pipa, Washington DC].

Bibla: Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re. 1991-1994. Tiranë: Diodati i Ri.

⁴⁶ Pipa, në këtë konstatim, i referohet disa pasazheve si ai në mad. ‘Në tempullin e Afroditës’, ku Camaj shprehet qartë: ‘*skota e Dranjes atje nuk ishte ardhacake, por dhéase*’* [Camaj: 21].

Brotsky, Joseph. 1996. *So Forth* [poems]. New York: Farrar, Straus and Giroux.

Camaj, Martin. 1981. *Dranja*: madrigale (*mbi fatin e një frymori të papërsosun*). Roma: Tipografia Detti.

_____. 2010. *Dranja*. Tiranë: Onufri.

Çoba, Monsinor Ernest. 2020. *Keze të hueja*: poezina të përkëthyme prej italishtes. Shkodër: Fiorentia.

De Rada, Girolamo. 1873. *Canti di Milosao: figlio del despota di Scutari*. Tipografia Albanese, Corigliano Calabro.

Elsie, Robert. Autumn 1991, 65/4. 'World Literature Today'.

Liber Proverbium. Nova Vulgata. 1998. Bibliorum Sacrorum Editio [SACROSANCTI OECUMENICI CONCILII VATICANI II RATIONE HABITA IUSSU PAULI PP. VI RECOGNITA AUCTORITATE IOANNIS PAULI PP. II PROMULGATA]. Editio Typica Altera.

Kadare, Ismail. 1991. *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, Tiranë: SHB "8 Nëntori".

_____. 1954. *Frymëzimet djaloshare*. Tiranë: NSHB, Mihal Duri.

Kola, Lisandri. 2016. *Sonete*. Shkodër: Fiorentia.

Kola, Lisandri & Aristeia. 2020. 'Kur mitet përfliten'. Tiranë: 'Shqiptarja.com', 6 korrik.

_____. 2020. 'Si po rrëhet me anë të miteve'. Shkodër: 'Hylli i Dritës', XL-2020, nr. 1 (301), 72-86 [huazue për publikim online nga revista *Këns*, Michigan].

Pipa, Arshi. 1991. *Contemporary Albanian Literature*. New York: Boulder, East European Monographs (305): Distributed by Columbia University Press.

_____. 1978. *Hieronimus De Rada*. [Albanische Forschungen 18]. München: Dr. Dr. Rudolf Trofenik.

Tirta, Mark. 2004. *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Dega e Etnologjisë.

ME PËRKTHYE POEZINË E ARSHI PIPËS NË GJUHËN SHQIPE: SFIDA PËRVÛJTNIË

Sikurse e dëshmon edhe formulimi i titullit të këtij punimi, i cili prîhet nga paskajorja ‘e paligjshme’ simbas gjuhëtarëve enverianë të ’72, çështja e përkthimeve të poezive të Arshi Pipës prej gjuhëve të hueja në gjuhën shqipe, asht një proces i pakufishëm në mbërritjen absolute të estetikës dhe esencës origjinale. Në numrin III të *Këns* (2020), si përkushtim ndaj jubileut të Lindjes së A. Pipës, patëm përkthye disa poezi nga vepra katërgjuhëshe *Autobiography*. Finalizimi i *Simpoziumit*, lindi mbas publikimit të numrit të kësaj reviste dhe në kushte krejt të rastsishme, kur ne kishim heqë dorë nga ndonji organizim i mundshëm tue pà vobektësinë e institucioneve shqiptare (apo katedrave Albanologjike jashtë Shqipnie) në lidhje me këtë figurë. Ideja jonë si botues të *Këns*, dhe si përkthyes njiherësh të këtij korpusi poezish, ishte që me i mëshâ⁴⁷ edhe ma fort idesë (së

* Shifra 101, sikurse e pata shpjegue edhe në fjalën time të Simpoziumit Jubliar (12 dhjetor, 2020) nënkupton 100 vjetorin e lindjes së Arshi Pipës, dhe 1 vjetorin [tashma 2 vjetorin] e kalimit të Amshim të mikut, botuesit, poetit e përkthyesit Myftar Gjani, i cili përmes shtëpisë botuese Princ, i solli publikut shqiptar disa vepra fundamentale të Pipës. Pa kontributin e M. Gjanës, A. Pipa do të ishte ende (për paradoks) edhe ma i skajuem në kulturën shqipe.

⁴⁷ Ndër vite, si unë si Aristea Kola (e cila ka fitue gradën Master në Universitetin e Tiranës, 2015, me studimin mbi sonetet e Arshi Pipës, dhe po kështu këtë poet e ka sërish në fokus në

automatizuese gabimisht ndër akademikët shqiptarë) se Arshi Pipa asht edhe poet, krahas se studiues cerebral.

Para se me përkthye poezitë e Pipës, personalisht më ka takue me përkthye punimet e tij që janë publikue tashma në revistën *Këns* (“*Personazhe të Jetës së Re: Dante, Cavalcanti dhe Familja Portinari*”, III, 99-115; “*Rapsodë shqiptarë në serbokroatisht: cikli epik i kreshnikëve*, I, 25-79), e ndërkohë materiale të tjera në numrin e tashëm. Natyrisht procesi i përkthimit të artikujve shkencorë dhe i poezive, ndryshon thelbsisht.

Ky artikull dëshmon një përvojë modeste në përkthimin⁴⁸ e disa prej poezive të Arshi Pipës nga anglishtja dhe italishtja: këtu do të trajtohen vetëm dy prej tyre. Asht e tepërt me e përmendë njohjen e shkëlqyeshme të disa gjuhëve moderne dhe atyne klasike nga ana e Pipës, por e shoh me vend me konfirmue mjeshtrinë dhe kompetencën e jashtëzakonshme të A. Pipës në vargzimn italisht. Thellësia e njohjes së tij nuk shtrihet vetëm në aspektin gjuhësor por edhe në mekanizmin e imtë të strukturës së vargut në italisht. Shembull konkret janë sonetet (demonstrim që e ban edhe në frangisht ç’asht e vërteta) si edhe disa prej poezive në varg të lirë.

programin tjetër Master që po vijon në University of Michigan, Ann Arbor), kemi punue me e ridimensionue—siç mund të ketë pasë ndonji rast të izoluem prej të tjerëve—produktin poetik të AP në kritikën e ngurtë shqipe. Unë personalisht, ndër biseda me ish-kolegë e ish-profesorë të mi, jam gjendë i befasuem prej perceptimit që kanë për poezinë e këtij autori. Sikur kjo ‘buzëhollësi’ e tyre, të ishte kriter edhe për disa produkte banale poetike në poezinë e sotme shqipe, të cilat ata i superlativizojnë, jam i bindun se poetë magjistrallë si Pipa, do ta kishin pasë vendin e merituem në kritikën aktuale gjysë-enveriste.

⁴⁸ Prej *Autobiography* janë përkthye poezitë: *Aksioma*, *Shpresë*, *Andërr*, *Trini boshe*, *Arratisje*, *Autobiografi*

Sa i takon soneteve në gjuhën e huej, shkruar nga ky autor, duhet theksuar se ato janë të gjitha të *modelit petrarkian* qoftë edhe kur janë në anglisht. Nuk konstatohet ndonji sonet shekspirian në opusin poetik të Pipës. Ai i qëndron, me sa duket, shkollës së Sir Thomas Wyatt dhe Henry Howard (Earl of Surrey), shek. XVI, të cilët thadruen imitimin e sonetit petrarkian në gjuhën angleze. Kjo asht një tjetër dëshmi bazike për shtratin kulturor të Pipës, i njohun botënisht si italianist dhe frankolog.

Sonetet *Hope*, *Sogno* po t'i bajmë një identifikim formal, rezultojnë se skemën e oktavës nuk e kanë të realizueme simbas oktavës rrajë të sonetit të Pipës në gjuhën shqipe (*abba baab*: një skemë e përdorun pothuaj sporadikisht si te ndonji sonetist si rasti i K. Kokoshit,⁴⁹ Asdrenit⁵⁰ E. Koliqit).⁵¹ Kjo skemë oktavë, e cila do të bahet kanonike⁵² ma vonë për A. Pipën në *Librin e Burgut*, me sa duket asht përdorë qysh kah vitet 1936-40, kohë që përkon me fazën studimore të autorit, në Firenze. Ndoshta publikisht, soneti i parë me këtë lloj oktavë asht një sonet që Pipa nuk e përfshin kurrë mandej në vëllimet e veta poetika. Ai asht soneti me titull *Shkodra* (*Fryma*, Fruer 1944/2, 65-6): një cikël tresonetor, ku i dyti në radhë ka të aplikueme këtë skemë. Ma vonë, po në këtë vit, në *Lundërtarë* (Tiranë, 1944) dalin disa sonete me këtë

⁴⁹ Khs. Kudret Kokoshi në *Drithmë jete*, Tiranë: Naim Frahsëri, 1995, *sonn.*: Skënderbeu, Kujton? (1930), Neroni (Romë, 1932), Këngën më të bukur të këndo! (Vjenë 1944 – Në fushën e përqëndrimit në Gjermani), Nënës (1945), Nënës (1965), Të njoha, Dhe zjarrin që m'u ndez në gjoks e shova (Vlorë, 1960).

⁵⁰ Khs. son. *Kenga e udhëtarit* në *Psallme murgu*, Bukuresht, 1930, 116.

⁵¹ Khs. son. *Vangjos* (1969).

⁵² Shih Aristeia Kola, "Korpusi i soneteve të Arshi Pipës", *Gegnia*, 2016/2, 36-45; Lisandri Kola "Kur bëhet shpirti qorr, zemra bëhet e shurdhër" 'Standard', 9 korrik 2013, 14-15.

natyrë kompozicionale të oktavës. Çka asht e randësishme me u veçue në këtë trajtim, asht se oktava e kanonizuese në shqip prej Pipës në *LB*, mbetet testimoniale dhe fundamentale për rrëfimin poetik në burgjet e kalueme prej tij në Shqipni. Arshi Pipa, themeluesi i letërsisë shqipe të burgut, që ka iniciue modelin për autorët e mavonshëm, jo vetëm që e ka paraqitë me sukses (tue mos gjetë pajtim kësisoj me studiuesin Bajram Kosumi) poetikisht nocionin e burgut, por asht ba epitoma e një letërsie të tillë në Europën Lindore. Si duket ky i mbrami, e keqlexue këtë vepër aq sa e *skualifikon* në trajtim e tij. Ai thotë, tue iu referue emërtimit të veprës së tij “Letërsia nga burgu,⁵³ *shënjon fillimisht letërsinë dhe pastaj burimin e saj – ajo është shkruar në burg dhe vjen nga andej*” (27). Po vepra e Pipës nga vinte simbas këtij studiuesi? Paradoksalisht ma poshtë shton: “*Letërsia nga burgu është letërsi për lirinë, për individin e lirë dhe aspak letërsi e burgut.*” (*ibid.*) Nuk asht aspak e vërtetë që Pipa “e kuptonte burgun si sfond” por si përvojë e ngadhënjimit të lirisë. Vetë citimi i Kosumit (25-6) shkëputë nga *LB*, e vërteton që *thema e liris*, në përcaktimin e Pipës, asht kuintesa e atij libri që u nxuer tej hek’rash në fletë duhanit.

Kosumi madje e ka lexue dallash formulimin gramatikor të shqipes *Libri i burgut*, pa e ditë se si emërtim i tillë lidhet me modelin e Antonio Gramsci-t që i ka shërbye Pipës si paradigmë autoriale e burim emërtimi të veprës së vet. Vepra shumëvëllimshe *Quaderni di carcere* (*Fletoret e burgut*) i ka shërbye Pipës në lidhje me titullin siç i ka shërbye Dom Simon Jubanit vepra e Silvio Pellico-s, *Le mie prigion* (*Burgjet e mia*). Rasa përkatëse gjuhësore, nuk kallëxon se libri/letërsia domosdo asht *i/e* burgut, por *mbi* burgun, *mbi* fatin, *mbi* lirinë, në kushte privimi, *për* rezistencën intelektuale e njerëzore, *përtej* imagjinatës njerëzore (qoftë edhe të autorëve të Kosovës

⁵³ I referohem veprës së Bajram Kosumit, *Letërsia nga burgu: kapitull më vete në letërsinë shqipe*, Tiranë: Toena, 2006.


nëpër burgjet e kohës së ish-Federatës Jugosllave, ku të paktën zakonisht lejohej laps e letër, Kosumi: 16), *kundër* diktaturës dhe pastërtisht *përmes* ligjësive frymëzuese poetike. Me këtë logjikë të Kosumit, i bjen që edhe *Quaderni di carcere* janë shkrime për burgun (!?). Ndërkohë që dihet se ajo vepër përfshin refleksione të gjata filozofike, kritike letrare, sociologji, folklor, gazetari, religion etc. Ba me i hy ndërtimeve të titujve, siç kërkon me depistue Kosumi, dikush mund të hamendsojnë se emërtesa: *Letërsia nga burgu* ngjanë me librin e anëtarit të organizatës terroriste IRA, Bobby Sands (*Writings from prison*), i cili vdiq në burgun e *Her Majesty's Prison Maze* në Irlandën e Veriut shkak i grevës së urisë. Por, në dallim me Pipën e Jubanin, librin e Kosumit kam bindjen se nuk i lidhë asgja me atë të Sands.

Ky digresion u pà i nevojshëm që me konfirmue traditën kritike në mohim të veprës poetike të Arshi Pipës. Le të kthehemi te shqyrtimi në fjalë i soneteve, sa i përket rrafshit formal të soneteve, tashma sekstinës e cila në *Hope* asht *ccd eed* dhe *Sogno ccd ede*: ndërtime që i njeh gjanësisht modeli petrarkian. Metri, natyrisht asht i përpiktë, ai endekasilabik. Ajo çka i lidhë këto dy sonete, në dy gjuhë të ndryshme, asht i njejt i adresant poetik: *Annie*, tregues me mungesë biografike/referenciale, që dëfton njëherësh latencë erotike të poetit si edhe inspirim lirik. Der më tash jeta private e Pipës, asht e gjitha e mërtisun me 'mister'. Poezia e tij, qoftë edhe ajo erotike, të lën me aludue por kurrësi me kuptue saktësisht, ma në detaje, për jetën private, erotike të Pipës.

Nisë prej skemës së maposhtme (mbështetë në veprën e S. Bassnet), për me përkthye në shqip dy soneteve ma nalt, faza e parë ishte *analizimi*, *shqyrtimi* i dy teksteve në fjalë, si moshë tekstore (*H*, s.d. kurse *S*, 1980) gjithashtu edhe si përkatësi—sesion, kapitull. Natyrisht, janë zbërthye e respektue skema poetike, sistemi rimor e ai metrik. Statusit kulturor të tekstit i asht dhanë një randësi e madhe—simbas përcaktimeve të teoricienit A. Lefevere—me qëllim që me riejtë semantikën por edhe

mos me ra pré e traditës përkthimore shqipe, e cila shpesh e bjerre këtë kriter të randësishëm.

Procesi teorik e praktik i përkthimit



- *The cultural status of the text*, A. Lefevere, *Translating literature*, 92-passim

Mosha tektore, *H s.d.*, pjesë e kapitullit **IV. Exile** (*Autobiography*), 1957-65

S, 1980 -----//----- **VI. Transition**


Skema poetike

Rima

Metri

skema 1

Faza e dytë dhe e tretë, gjithnji simbas Bassinet, janë bartja (*transfer*) dhe rindërtimi (*restructuring*): procese që bajnë finalizimin në gjuhën mbërritëse, të përkthyme. Në këto dy faza për të dy poezitë, mes tekstit burimor (TB) dhe atij mbërritës (TM) kanë ndodhë këto procedime, paraqitë si në vijim:



- Tkurrja e njysisë minimale në strukturën poetike
- Minimizimi i rrokjeve
- Procedime teknike: bjerria e ë-së rrokjebase; sinkopë-apokopë
- Shartimi i dy dialekteve të shqipes *G e T*
- Ruajtja e leksemave si vlerë tektore, poetike dhe fjalë-çelës
- Shtesa strukturore në TM pa cenue TB
- Organizimi i përgjithshëm
- Theksoria, koha, ritmi

- Bartja kuptimore (semantike)
- Reduktiviteti gjuhësor
- Gramatikalizmi
- Sintaksa

skema 2


Problemi ma i madh kulturor e kuptimor asht me fjalën *lende* (acorn) në sonetin *H. Vrehet qartas një diskrepancë kulturore mes anglishtes dhe shqipes, dhe për*

ma tepër në shqip asht jashtë kontekstit kultural të tekstit në origjinal. Fjalori i gjuhës shqipe përkufizon kështu: “**LENDE** f. 1. Kokërr e vogël si lajthi me një kapuç nga njëra anë, që lidhin disa drurë si lisi etj. dhe që e hanë derrat e disa kafshë të egra; gogël. Lende lisi (dushku). E ushqente me lende; 2. Boçe. Lende bredhi (vgjeri, qiparisi)”. Lenda në kontekstin e TB, nënkupton një kondensim imazhi poetik: asht një frut drunor që ndërlidhet sidomos me ketrat në Amerikë (tue pasë parasysh vendndodhjen e Pipës në atë kohë kur asht kompozue poezia), e kjo kafshëz e bjen imazhin ma delikat, intim sesa derrat në përcaktimin e FGJSH.

Në sonetin *H* që asht përkthye në gegënisht, për arsye të minimizimit të vargut dhe të tkurrjes së rrokjeve asht futë fjala *vuv* për ‘deaf-mute’. Kjo fjalë gjendet në FGJSH si edhe në *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* të Kolec Topallit, i cili e shpjegon si ardhje nga greqishtja e re *βουβός* dhe ka kuptimin e shurdhmemecit. Nëse do të përdorej kjo fjalë në tekst për vargun “*From quicksand, a deaf-mute will speak and sing*” sigurisht masa metrike nuk do të ishte endekasilabike, por plus dy rrokje, prandëj asht ba një zgjidhje e tillë “*prej ran’s thithse, një vuv do t’flasë e kndojë*” tue rrejtë të gjithë përbâsit poetikë të sonetit.

Nësa për sonetin italisht *S*—një erotizëm oneirik—janë ba disa rindërtime, për me rrejtë skemën rimore, dhe që shënohen me shigjeta në figurën B ma poshtë. Në tanësi mendoj se kompromiset, negociatat e kushtëzue me në këtë rast nuk e cenojnë integralitetin dhe konceptimin origjinal të sonetit. Shtesat përkatëse, ndërkohë, tregojnë për vështirësinë e misionit së përkthyesit për me prû në trajtën ma të mirë të mundshme TB.

Për me gjykue këto dy shembuj përkthimi, përzgjedhë në poezitë e tjera të A. Pipës, përkthye pra në *Këns* III, puna ma e vlefshme asht që lexuesi i mendshëm dhe kritiku i urtë me e gjykue këtë rezultat pune.



SHPREË

Për Annie-n


Avitesh tue m'pyetë si tue lypë me çudi
'j kristal pshtjellë n' nji lende ende blerue,
tue andrue gëma dëgsh gati lulzue
dikah mbi tokë përtej tonit kufi.

M'i merr fjalët si grunë jo në fermë mbi,
po prej vorri 'i fmi t'pajetë me shujtue,
që ka m'u ngjallë e tritë 'j ditë tu' u përçmue
prej atyne që s'besojnë n'përtësi.

E nse jeta t'duket diqyah e ngritë
porsi e jetimeve, joshë dhe shitë,
dashnia mue do t'm'duket antidot.

Nji rrah ka me çilë, nji gurrë do t'burqë
prej ran's thithse, nji vuv do t'flasë e këndojë
kur t'bashkojmë duert për at' që s'prishet dot.

fig. A



ANDËR

Annie-t

Rritshe zbë bri meje, mendimesh thekë
në heshtjen e mbrazmjes, e cila terë
gëmin e vonë t'nji manjole n'për erë
bardh si petalja e saj. Kishe vdekë.

Grue e palumtun këso jete hekkë
në vorr etrusk, zdeshtë dëshirash ksaj herë,
shpërfillse ndaj vajit të burrit dërë,
korteut i cili n'zemër asht prekë.

Me të përqaftue për së fundmi thashë.
E thkita dorën n'gërrshetin e trashë,
e t'putha kapaktë e synit, qerpikët.

Lëvizën dhe u hapën pa u zgajtë,
Mandë më kyre pa habi t'perpikët
sikur ishe zgjue nga nji gjumë i gjatë.

fig. B

MATTEO MANDALÀ

ARSHI PIPA MIDIS ARBËRESHËVE SICILIANË

Të nderuar Zonja e Zotërinj,
mirëmëngjes, buongiorno, good morning,
së pari më lejoni të falënderoj për zemërsisht prof. Mithat Gashin që në emër të ekipit organizues më ftoi bujarisht të marr pjesë në këtë “Simpozium shkencor-përkujtimor”, kushtuar veprës së prof. Arshi Pipës.

Gjithashtu më lejoni të falënderoj mikun tim dhe kolegun e dashur arbëresh Michelangelo La Luna i cili ndërmjetësoi kontaktin me prof. Gashin: kur vjen fjala për promovimin e kulturës mbarëshqiptare arbëreshët gjithnjë kanë luajtur rolin e “shtyllës së katërt” dhe kurrë nuk mund ta braktisnin këtë rol në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Last but not least, një përqaftim virtual po aq të singjertë sa ai fizik, ua kushtoj pjesëmarrësve të bashkëbisedimit të sotëm duke i kërkuar ndjesë secilit që nuk do të jem as telematikisht i pranishëm: në këtë periudhë tragjedish, pandemia fatkeqe na i ka mpleksur aq keq punët sa që e kemi të vështirë t'i nderojmë siç e meritojnë aktivitetet tona kulturore.

Edhe për këtë arsye kënaqësia ime për pjesëmarrjen në këtë debat nuk është fare formale, sepse siç do ta them, ajo rrjedh nga një detyrim i kahershëm moral dhe intelektual.

Figura dhe vepra poliedrike studimore e të ndjerit Arshi Pipa e meritojnë patjetër një shqyrtim të thellë dhe takimi i sotëm shënon etapën e parë të kësaj kërkese tashmë të domosdoshme shkencore. Përpos shtrembërimeve dhe manipulimeve të shumta të kryera në dëm të mendimit politiko-kulturor të prof. Pipës, të cilat duhen zhbërë për t'i lënë vendin rindërtimit të së vërtetës nën dritën e dëshmimeve autentike edhe për ta

riaktualizuar në funksion të debatit që sot e kësaj dite paradoksalisht sheh në bankën e të pandehurve intelektualët më të shquar të diasporës së pas Luftës së Dytë botërore, si fjala vjen njerëz të kalibrit të Martin Camajt, vënia në pah e thesarit plot dije ndërkulturore dhe risi metodologjike që Arshi Pipa i siguroi albanologjisë mu në fazën më të vështirë të historisë së saj, mendoj që do të mbetet synimi kryesor i Simpoziumit tonë të sotëm.

Më lejoni ta filloj me një kujtim personal. Prof. Pipën pata fatin ta njihja në fillim të viteve '80 të shekullit të kaluar, qysh kur isha student në Universitetin e Palermos. Pas ligjëratës mbi eposin e kreshnikëve që prof. Pipa mbajti në kongresin vjetor që prof. Antonino Guzzetta organizonte nën kujdesin e Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Shqiptare pranë Katedrës Albanologjike të Palermos,⁵⁴ m'u dha rasti fatlum të shkëmbeja mendime, opinione, jo pa polemizuar, me një studiues që në mjediset tona studentore arbëreshe ishte tashmë prej vitesh emër shumë i njohur dhe i respektuar.

Interesi që Pipa shfaqte vazhdimisht për botën arbëreshe ishte çështja më e debatuar në rrethin tonë studentor sepse na mahniste shumë mënyra sesi ai e trajtonte atë. Qasja e profesorit mbetej larg banalizimeve didaskalike, mediokritetit kritik, paragjytimeve (pozitive ose negative, por mbeteshin gjithmonë të tilla, d.m.th. paragjytime); dhe, përkundrazi, na tregonte haptazi një vizion kulturalisht largpamës, metodologjikisht risor, shkencërisht ndërdisiplinor, me një fjalë modern, pa kutërbimin e mykut që fatkeqësisht na vinte rregullisht nga shumë studime të botuara në Itali dhe në Shqipëri.

⁵⁴ Shih Arshi Pipa, "Rapsodi albanesi in serbocroato: il ciclo epico di frontiera" në Antonino Guzzetta (a cura di), *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia. Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi*, Palermo, 25-28 novembre 1981, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese – Università di Palermo, Palermo, 1981, 371-408.

Të tilla, për shembull, ishin studimet e para që, qysh nga mesi i dytë i viteve '60 të shekullit të kaluar, Pipa i kushtoi letërsisë, historisë, antropologjisë dhe kulturës popullore arbëreshe dhe, në veçanti, veprës së Jeronim De Radës. Ishin po ato studime paraprake ku shkëlqenin rezultatet e larmishme të gjurmimeve të tij në mjediset arbëreshe dhe që do të derdheshin tek vëllimet e së famshmes trilogji *Albanica*, që vite më vonë do të shihte dritën e shtypit në Gjermani.⁵⁵

Si ishte e mundur, pyesnim të mahnitur, që një profesor shqiptar nga Universiteti i Minnesotës, të arrinte të analizonte aq thellë strukturën e vargut popullor të traditës gojore dhe letrare arbëreshe?

Si ishte e mundur që po ky profesor i arratisur nga burgjet e Shqipërisë ia doli më në fund ta çlironte poetikën e De Radës nga birucat pseudo-kritike ku në atë kohë shumëkush e kishte futur duke e cilësuar veprën e Poetit arbëresh të pakapshme, fragmentare dhe të errët? Ndryshe nga paraardhësit Pipa i hyri një rrugë kërkimore që atyre viteve, paralelisht me të, e kishte ndërmarrë edhe profesori ynë, i ndjeri papas Francesco Solano.⁵⁶ Të dy këta studiues bashkë arritën ta reduktonin ndjeshëm aspektin e parrokshëm të poetikës deradiane duke e

⁵⁵ Shih Arshi Pipa, *Albanian folk verse: Structure and Genre*, Albanische Forschungen 17, Rudolf Troefnik, München, 1978; Arshi Pipa, *Hieronymus De Rada*, Albanische Forschungen 18, Rudolf Troefnik, München, 1978; Arshi Pipa, *Albanian literature: social perspectives*, Albanische Forschungen 19, Rudolf Troefnik, München, 1978. *Trilogjia Albanica* e Pipës është botuar edhe në gjuhën shqipe, përkthyer mjeshtërisht nga Abdurrahim Muftiu, Primo Shllaku dhe nga i ndjeri Myftar Gjana.

⁵⁶ Në studimin tim mbi poetikën e poemave të De Radës, nuk jam nisur rastësisht nga pohimi largpamës i Arshi Pipës: "The crux...is the phrase *double lyrical narrative*", i cili shënon një kthim rrënjësor në historinë e kritikës letrare deradiane. Së bashku me Solanon, shih Matteo Mandalà, "Për një interpretim të poemave dhe të poetikës së De Radës" në *Studime Filologjike*, vol. 3-4, Tiranë, 2003, ff. 15-43.

ngritur nivelin e debatit shkencor nga ai i ulët dhe sipërfaqësor në atë hermeneutiko-filologjik të rindërtimit të teksteve dhe të interpretimit të tyre.

Shtegu i kërkimeve filologjiko-letrare në suazën e studimeve deradiane u çel aty nga mesi i viteve '60 të shekullit të kaluar nga Francesco Solano me botimin e një studimi⁵⁷ që u bë i famshëm, qoftë sepse vuri rregull në historinë e ngatërruar të dorëshkrimeve, qoftë edhe sepse përuroi këtë qasje të re kritike. Disa vjet më pas, studiues të tjerë, bazuar në rezultatet e Solanos dhe duke braktisur përfundimisht udhën e studimeve mbi De Radën të kryera mes gjysmës së dytë të shek. XIX dhe gjysmës së parë të shek. XX, patën meritën të fusnin në një kuadër shkencor më të rreptë studimin e veprës deradiane. Mes këtyre shquhet pikërisht Arshi Pipa, autor i disa studimeve që patën për objekt poemat e De Radës e në veçanti, ato të fazës rinore të krijimtarisë së tij.

Rezultatet e para Pipa i botoi në disa studime “paraprake”,⁵⁸ që më vonë i përfshiu në monografinë e gjerë *Hieronymus De Rada*. Në to studiuesi shqiptar jo vetëm që trajtoi me originalitet disa nga çështjet më të mprehta, duke filluar me atë të romanit lirik të dyfishtë të De Radës, por propozoi edhe një hipotezë analize në thelb të saktë dhe bindëse, si edhe një metodë hulumtimi që ia nënshtroi nivelin kritik të “interpretimit” niveleve të “përshkrimit” dhe të “rindërtimit”. Kështu, duke ecur në shtegun që çeli Solano, e duke u ballafaquar vazhdimisht

⁵⁷ Shih Francesco Solano, “Bellusci o De Rada? Osservazioni su un manoscritto di Canti albanesi”, nxjerrë nga *Shëjzat-Le Pleiadi*, n. 7-8, luglio-agosto, anno X, Roma, 1966, ff. 3-30.

⁵⁸ A. Pipa, “*Milosao* and Its Three Editions”, in *Südostforschungen*, Band XXVIII, R. Oldenbourg, München, 1969, 182-198; Idem, “The Odyssey of De Rada’s Manuscripts”, në *Përpyjekja e Jonë*, v. III, n. 4, s.l., 1972; Idem, “The Genesis of *Milosao*”, në *Revue des études sud-est européennes*, tome XI, 1973, n. 4, București, 1973, ff. 711-739.

me tekstin, Pipa arriti në përfundime të rëndësishme mbi disa dilema kritike:

Së pari, bëri disa sqarime të domosdoshme, edhe pse jo përfundimtare, mbi çështjen e ndërlikuar të gjenezës së poemave dhe rindërtimin e fazave të shkrimit. Së dyti, para studimit të tekstit, kreu një studim të hollësishëm të paratekstit, duke bërë një shqyrtim që i kaloi kufijtë e një repertori të thjeshtë dallimesh tekstore. Në këtë shqyrtim vuri në qendër të vëmendjes marrëdhëniet historiko-kritike mes tri botimeve, si edhe marrëdhëniet mes këtyre të fundit dhe varianteve në dorëshkrim. Së fundi, u përpoq të përshkruajë mekanizmat që rregullojnë funksionimin e strukturave formale e gjuhësore të veprës, si edhe analizoi impiantin narrativ të veprave rinore të De Radës, disa nga të cilat (si *Këngët e Milosaos* dhe *Këngët e Serafina Thopias*) mund të kuptohen vetëm përmes një vështrimi kritik sinoptik.

Këto rezultate të Pipës shënuan një kthesë rrënjësore në studimet mbi De Radën dhe një pikë moskthimi që i bëri këto studime të fitonin formalizimin e nevojshëm të bazuar mbi përshkrimin e tekstit, e në të njëjtën kohë e futi hipotezën interpretuese në një kuadër të ri, pikërisht në kuadrin e “përshkrimit”. Natyrisht, duke vënë në pah rëndësinë e këtyre rezultateve dhe karakterin risor të përpjekjes hermeneutike të Pipës, nuk dua të theksoj kundërvënien mes dy metodave, asaj ‘përshkruese’ dhe asaj ‘interpretuese’: përkundrazi, nëse i përmend si metoda me status të kundërt, e bëj sepse vetëm kombinimi i tyre i njëkohshëm do të mundësonte një lexim që të respektonte parimin bazë sipas të cilit ‘të përshkruash’ do të thotë ‘të interpretosh’ dhe anasjelltas. Por Pipa, siç thamë, e shtyu edhe më tej kufirin e metodës së tij të hulumtimit, pasi krahas ‘përshkrimit’ dhe ‘interpretimit’ zbatoi një metodë të re, atë të ‘rindërtimit’. Thënë ndryshe, iu përgjigj domosdoshmërisë për të studiuar përmasën e saktë ‘historike’ dhe ‘kronologjike’ të fazave të ndryshme të shkrimit të teksteve, duke i hapur rrugën një qasjeje më të ndërlikuar, qasjes filologjike, që

është e vetmja që do të mund të sillte prova dhe argumente të reja në debatin mbi çështjen deradiane. Jo rastësisht Pipa që i pari ndër kritikët bashkëkohorë që shtroi me ngulm problemin e gjenezës së poemave rinore të De Radës, duke pasur mprehtësinë të kuptojë se vetëm studimi sistematik dhe i vëmendshëm i dokumenteve të viteve 1833-1847 do të mund, nga njëra anë, të hidhte dritë mbi marrëdhëniet mes dy veprave të para në shqip të De Radës (*Këngët e Milosaos* dhe *Këngët e Serafina Thopias*), e nga ana tjetër të zgjidhte nyjen e mpleksur të përkufizimit *roman lirik i dyfishtë*, që De Rada i dha poemës së tij rinore.⁵⁹ Pipa megjithëse iu afrua shumë zgjidhjes së enigmës, për fat të keq nuk që në gjendje t'i shkonte deri në fund, duke u ndalur përballë “rindërtimit” të vështirë të sistemit të dokumenteve të ashtuquajtura të *paramilosaos*, të cilat me anë të një operacioni filologjik të shkëlqyer e paradigmatic kohët e fundit i studioi dhe i botoi Francesco Altimari.⁶⁰ Në fund,

⁵⁹ Përkufizimi *roman lirik i dyfishtë* shfaqet së pari në letrën drejtuar Raffaele Zagarese-s, më datë 20 tetor 1834, që De Rada e vuri si hyrje në botimin e parë të *Milosaos*. Po e sjellim këtu: «Ero stato incompenato d'unire le canzoni popolari Albanesi, ché se ne volea fare una raccolta, la quale or è compiuta e posta in versi italiani dal mio nobile amico Angelo Basile, e come ne trovai talune leggiadrissime le appresi a' giovani campagnuoli. Mi provai a comporre qualcuna della maniera di quelle, e non mi riuscii troppo male, mentre ad ognuna che nuova di sera si cantasse per le vie le donne si faceano ad udire alle finestre. Ne fui incoraggiato ed *ideai il mio doppio romanzo lirico*. Io ci misi molta soavità e melanconia, sopra tutto la verità, avendovi per la più parte le avventure mie proprie dipinto: né ho letto veruna cosa di quel genere»: Girolamo De Rada, *Lettera a Raffaele Zagarese*, në *Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao figlio del despota di Scutari*, Napoli, 1836, ff. VIII-IX.

⁶⁰ Shih Girolamo De Rada, *I canti premilosaici, 1833-1835 : le prime raccolte poetiche in albanese, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari*, vol. I, *Opera omnia di Girolamo De Rada*, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005;

është me vlerë të theksohet fakti që ndikimi i studimeve deradiane të Pipës arriti deri te përcaktimi i terminologjisë kritiko-filologjike sot në përdorim, siç janë – për shembull – emërtimet e veprave (Proto-Milosao, Proto-Serafina, Premilosao).

Si ishte e mundur, pra, që një profesor i italishtes nga Amerika e largët që aq pak kontakte kishte pasur me botën arbëreshe, të arrinte ta vlerësonte aq mirë rolin e kulturës arbëreshe dhe, siç vumë shkurtimisht në dukje, rëndësinë e “modernitetit” të veprës deradiane? Ishte vetëm një interes teoriko-epistemologjik vetjak apo Pipa me zhbirimet e tij në universin arbëresh, synonte edhe diçka tjetër?

Kjo e fundit ishte përshtypja jonë kryesore, por nuk ishim aq të sigurt. Përgjigjen përfundimtare e morëm vetëm në vitet '90, pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri, në një intervistë autobiografike, për shumëçka interesante, që Pipa i dha Televizionit Shtetëror Shqiptar dhe nga e cila kemi shkëputur pasazhin në të cilin Pipa rrëfen themelimin e Departamentit të Italishtes pranë Universitetit të Minnesotës, si edhe futjen me atë rast të mësimdhënies së letërsisë dhe të gjuhës shqipe:

«...pastaj kam vajtur në Minnesota. Në Minnesota më ofruan menjëherë *titullaritetin*. Atje kam vajtur si *Associate Professor*. Vajta për të organizuar degën italiane (italianistika). Departamenti i kishte degët e frëngjishtes dhe të italishtes, por një vit më pas ata (drejtuesit e Departamentit) donin një degë të italishtes më të frytshme. Dhe atë punë kam bërë pastaj. Vajta atje, pranova emërimin dhe filluam me organizimin e degës italiane, u vendos një *bachelor's degree*, i cili nuk ishte fort i qartë, dhe

Girolamo De Rada, *Canti di Milosao, edizione critica delle tre versioni a stampa (1836, 1847, 1873) e della quarta versione manoscritta (1896)*, a cura di Francesco Altimari, vol. II, *Opera omnia di Girolamo De Rada*, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2017.

vajta derisa propozova të ishte një Ph.D., një doktoratë në italisht, dhe në fund u bë edhe ajo. Unë isha natyrisht profesori që drejtonte degën italiane atje. Në kohët e fundit futa pastaj edhe shqipen. Atëherë kam filluar të botoj përmbi letërsinë shqipe, për gjuhën shqipe. Kam botuar më tepër artikuj në revista të ndryshme italiane, gjermane... Dhe kam filluar pastaj studimin e shkrimtarëve arbëreshë... se thashë se ajo puna e arbëreshëve vete mirë, se profesor i italishtes isha, arbëreshët natyrisht ishin italo-shqiptarë. Kështu që nëpërmjet këtij kaloi, si të thuash, të fusë edhe shqipen në kurrikulumin e italishten në këtë departament...»⁶¹

Në pamje të parë këndvështrimi i atëhershëm i Pipës duket sikur nuk shkonte përtej interesit rapsodik, instrumental, mbi kulturën e lashtë arbëreshe. Në fakt e ardhmja e punës së tij shkencore do të vërtetonte të kundërtën. Botën që pasardhësit e Skënderbeut rindërtuan në Itali, Pipa e konsideronte diçka më shumë se një dëshmi inerte, një mbeturinë të gjallë të historisë mesjetare, një relik të nuk frymëzonte dhe nuk ndikonte në botën aktuale. Pipa, ndoshta edhe më thellë se Ernest Koliqi, te historia kulturore arbëreshe jo vetëm që rroku origjinën e procesit të krijimit të identitetit kulturor dhe kombëtar mbarëshqiptar – përfundim ku arriti duke gjurmuar historinë arbëreshe në brendinë dhe në aspektet e saj ende të panjohura – por arriti, siç dëshmoi në intervistën e lartpërmendur, të riaktualizonte misionin e komunitetit më perëndimor shqipfolës duke vënë në dukje pikërisht ato merita reale që Jeronim De Rada dhe Zef Skiroi, Zef Serembe dhe Gavril Dara i Riu, i veshën atij komuniteti, si edhe rolin që luajti për çështjen

⁶¹ Intervista është publikuar në Youtube (<https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>) me titull: *Arshi Pipa - Dokumentar nga TVSH i viteve 90*. Pjesa e cituar është përafërsisht në minutat 35-37.

shqiptare në periudhën më të ndërlikuar të historisë kombëtare: atë të Rilindjes.

Etapat kryesore të këtij procesi Pipa i përshkroi në ligjëratën me titull “Gli italo-albanesi e la tradizione Greco-Bizantina” që mbajti në Palermo në vitet 1974-76 dhe që prof. Guzzetta botoi në vitin 1978⁶². Në studimin e tij profesori i italishtes radhiti njërën pas tjetrës faktet, personalitetet, veprat që pasuronin historikun gjithëpërfshirës të kulturës arbëreshe, duke propozuar dallime thelbësore midis dy komuniteteve më të spikatura arbëreshe, atij kalabrez dhe atij sicilian, duke vënë në dukje risitë që arbëreshët i sollën kulturës së përbashkët mbarëshqiptare, pa mënjeluar ndikimet mbi proceset shoqërore dhe politike dhe duke i kapur me mjeshtëri dhe dituri shembullore trajtat që kultura arbëreshe kishte thithur nga kultura letrare, sociale dhe politike italiane.

Nuk është rasti ta thellojmë më tej analizën e këtij studimi të Pipës, edhe pse do të na çonte shumë larg dhe koha në dispozicion është e pamjaftueshme. Mirëpo ia vlen të theksojmë rolin që Pipa i veshi kulturës letrare arbëreshe në momentin që e shfrytëzoi atë si një *Kalë të Trojës* për të futur në mënyrë të kamufluar mësimin e letërsisë shqipe në kurrikulumet universitare të Departamentit të italianistikës. Siç e shpjegoi Pipa, zgjidhja e tij nuk ishte rastësore, por mbështetej në një bindje shkencore shumë të përhapur edhe në qarqet kulturore dhe intelektuale shqiptare. Duke qenë arbëreshët “italo-shqiptarë” domethënë, duke ndërthurur dhe shkrirë në identitetin e tyre dy kultura aq të ndryshme si atë paleoshqiptare dhe atë italiane, sikur ato të ishin dy entitete ontologjike përbërëse, në këndvështrimin ideologjik të Pipës arbëreshët mishëronin urën ideale të

⁶² Shih Arshi Pipa, “Gli Italo Albanesi e la tradizione greco bizantina”, në 8° *Convegno internazionale di studi Albanesi / Mbledhje ndërkombëtare studimesh shqiptare*, Centro Internazionale di Studi Albanesi, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese – Università di Palermo, Palermo, 1978, ff. 57-75.

komunikimit që, historikisht dhe pa ndërprerje, kishte mundësuar lidhjet e botës shqipfolëse ballkanike me atë perëndimore. Qysh nga periudha shumëshekullore e pushtimit osman dhe deri në çastin kur shkruante Pipa, domethënë në fazën më të errët të izolimit dyzetvjeçar të diktaturës komuniste, komuniteti arbëresh vazhdonte të ishte hallka e gjallë e zinxhirit që e mbante Shqipërinë lidhur vendosmërisht me bregun perëndimor të Adriatikut. Nuk është rastësor pra fakti që me studimet, të cilat ai u kushtoi arbëreshëve, u përpoq të rigjeneronte po atë perspektivë që nga shekulli XVIII, arbëreshët e Sicilisë me at Gjergj Guzzettën në krye, kishin përshkruar për të rindërtuar një vizion largpamës, guximtar e modern të identitetit kulturor shqiptar. Me studimet e tij pikërisht këtë vizion Pipa u përpoq t’u kthente arbëreshëve, sidomos atyre që i lexonin me endje edhe kur, si më qëlloj mua, nuk pajtoheshin plotësisht me mendimet e tij. Karakteri liberal i këtij studiuesi ishte shembullor: çka thoshte, synonte të nxiste kureshtje tek auditori dhe të ngjallte debate. Dhe për këtë aspekt i jemi shumë mirënjohës.

Për t’iu shmangur rrezikut të një shkrimi panegjirik që Pipa nuk do ta pëlqente, e kam për detyrë morale e intelektuale ndaj studiuesit tonë shkodran të përmend edhe pikat ku mendimet tona shkencore nuk përputhen. Disa nga këto pika pati rastin t’i diskutoja personalisht me Arshiun, dhe në ato raste “liberaliteti” i tij u konfirmua plotësisht. E kam fjalën për diskutimet letrarokritike rreth veprës narrative të Ismail Kadaresë, sidomos ato që lindën pas botimit të pamfletit “Subversion vs. Conformism: The Kadare Phenomenon”.⁶³ Diskutime rigorozë, me qëndrime të mbështetura në interpretime tekstore, larg këndvështrimeve ideologjike, të cilat edhe për shkak të debateve “mediatike” hera-herës

⁶³ Shih Arshi Pipa, “Subversion vs. Conformism: The Kadare Phenomenon”, në *Telos*, September 21, 1987, vol. nr. 73, New York, 1987, ff. 47-77.

mbisundonin mbi perspektivën shkencore dhe hermeneutike. Një pikë tjetër ku largoheshin mendimet tona ishin vërejtjet historiko-kulturore me të cilat Pipa, duke u mbështetur besnikërisht në të dhënat e trashëguara nga historiografia (mitografike) arbëreshe, nuk ia doli – sipas mendimit tim – ta çonte më tej analizën e tij kritike, ashtu siç bëri në fushën e kritikës letrare.⁶⁴ Edhe në këtë rast qasja e Pipës ishte paradigmatisht sepse ngjante me modelin e një studiuesi me formim të lartë shkencor, por edhe të një humanisti të përsosur i cili mishëronte më së miri dy synimet kryesore që përbëjnë misionin e pedagogut ose, për ta thënë në mënyrë korrekte, misionin e “Mjeshtrit”: rreptësia metodologjike dhe kujdesi dashamirës ndaj të rinjve që i afrohen kërkimit shkencor. Pipa ishte vërtet Mjeshtër.

Më lejoni ta mbyll këtë bisedë me një kujtim tjetër personal.

Vite më vonë, kur fillova karrierën time akademike, pata nderin të përfshihesha si autor në numrin e veçantë që revista *Albanica* i kushtoi veprës së Martin Camajt.⁶⁵ Sapo dërgova tekstin për botim, mora një telefonatë nga Amerika. Ishte prof. Pipa. Donte të më përgëzonte. E ndërpreva menjëherë, duke i thënë se po të kishte ndonjë vlerë ai shkrim, merita i takonte ekskluzivisht një studiuesi shkodran, të arratisur në Amerikë, jo i krishterë, me mendime progresiste, i cili dikur, si Kostandini i baladës, na erdhi në arealin arbërishtfolës në rolin sugjestionues të një lajmëtari dhe na përçoi kumtin e vlerave të traditës sonë të lashtë dhe të larmishme. Edhe për këtë i jam shumë mirënjohës prof. Arshi Pipës.

⁶⁴ Për më tej shih Matteo Mandalà, *Mundus vult decipi: mitet e historiografisë arbëreshe*, Shtëpia botuese e studio Letrare Naimi, Tirana 2016, sidomos ff. 263-296.

⁶⁵ Matteo Mandalà, “Alcune osservazioni sulle poesie di Martin Camaj” në *Albanica - A Quarterly Journal of Albanological Research and Criticism*, no. 2 (Spring 1991), New York, 1991, ff. 50-59.

ARSHI PIPA AND GIROLAMO DE RADA

Thank you note:

First and foremost, I would like to thank the colleague Mithat Gashi for inviting me to participate to this important symposium to honor the memory of Arshi Pipa.

1. *Meeting Arshi Pipa*

I met Arshi Pipa in the early Fall 1991, a few weeks after starting my Master Program in Italian at University of Pittsburgh. For a person like me, who had just arrived in the US after completing my Classics Degree at University of Calabria, the opportunity to meet Professor Pipa was like a dream. In fact, in order to write my dissertation entitled *Il Milosao di Girolamo De Rada: genesi e struttura* (Girolamo De Rada's *Milosao*: Genesis and Structure), with the supervision of Professor Francesco Altimari, I got very inspired by Pipa's work, and in particular by his *Hieronymus de Rada* volume number 2 of the *Trilogia Albanica* (Trofenik, 1978). What struck me the most, besides the rich material on De Rada that Pipa discovered and collected,⁶⁶ was the methodology that he used in his publications, studying the poet from different angles, and placing his production in the middle of a larger European Romantic contest, far from the Albanian boundaries where many other scholars tried to confine it.

I remember the warm way in which Arshi Pipa and his sister greeted me in their apartment in Washington DC, offering me immediately coffee, tea and nuts. I was

⁶⁶ For more information on De Rada's manuscripts, see Arshi Pipa, "The Odyssey of De Rada's Manuscripts", *Përpkjekja e Jonë* (Our Effort), III, 4, 12 novembre 1972, pp. 1-18.

very surprised and touched by the simple, kind, and generous way in which such an important professor welcomed a 23 years-old unknown student like myself. After a great conversation on some aspects of De Rada's work, Professor Pipa generously gave me a copy of some reproductions of De Rada's manuscripts kept in Biblioteca Civica, in Cosenza.

I still remember that meeting with Pipa, followed by a few conversations that we had over the phone. I am happy to say that, in a way, I followed Pipa's steps in my career, teaching Italian language and literature at a US college, while continuing to study Girolamo De Rada and his relationship with Italian and other European literatures.

2. Pipa's interpretation of De Rada's production

2.1. I Canti di Milosao

Arshi Pipa has been one of the first scholars to underline the importance of the folkloristic components (themes, characters, topoi, rhythms, rhymes, etcetera), of Girolamo De Rada's *Canti di Milosao* (Songs of Milosao), a long poem published in Naples, in 1836:

Milosao has a folkloristic basis. The rhythm of its cantos is the same as that in the Arbëresh folk songs, and its ethical substratum reflects the Italo-Albanian way of life. The author may announce in the title that the songs are of Milosao, the prince of Scutari in the fifteenth century; but the toponymy in the text belies the title, for the names of most of the sites are Arbëresh, and Milosao is a hero in the tradition of the epic songs, akin to Nik Peta and Milo Shini (notice Milosao's resemblance to the latter). Likewise, in Cologrea's daughter every young woman in the village can recognize

herself. The religious rites, the beliefs and superstitions, the mores and customs, are those of the Albanian villages of Calabria: boys exercise in the meadows, girls dance in the village square, lovers meet at the fountain or at street corners, men till the soil or tend herds, mothers sing their children to sleep, women work in vineyards and olive groves and at home make bread, weave, and embroider.⁶⁷

Moreover, Pipa's research also focuses on the Italian and Classical authors who influenced the young poet from Macchia Albanese. Among the Italian Romantic poets, Pipa mentions Giacomo Leopardi, who spent the last years of his life in Naples and who called one of his main collections *I Canti* (The Canti). This may have inspired De Rada in calling his first compositions *Canti* (Songs), or *Odi* (Odes), and his long poems *Canti di Milosao* (Songs of Milosao) and *Canti di Serafina Topia* (Songs of Serafina Topia). Pipa notices that De Rada, in his *Autobiologia* (Autobiography),⁶⁸ doesn't mention Leopardi among the poets of the XIX century, but he speaks only about Ugo Foscolo and Vincenzo Monti. Among the Ancient Greek and Latin authors, Pipa remembers that De Rada was inspired by Sophocles, Pindar, Anacreon, and Lucretius.

Another important theme that Pipa covers is the fragmentary structure of *Milosao*: while many scholars, like Michele Marchianò in his monography *L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada* (Trani, V. Vecchi, Tipografo-Editore, 1902), criticized De Rada for the fragmentism of

⁶⁷ Arshi Pipa, "Milosao": A Popular and Classical "Lyrical Romance," in *Comparative Literature Studies*, Sep. 1970, Vol. 7, No. 3 (Sep., 1970), pp. 336-353 (339).

⁶⁸ For *Autobiologia*, see Girolamo De Rada. *Opera Omnia. Autobiografia* (*Opera Omnia. Autobiography*), Michelangelo La Luna, ed. Vol. VIII. Rende: University of Calabria; Soveria Mannelli: Rubbettino Editore, 2008.

his poetry, Pipa thinks that that is a result that only a true poet can achieve:

Those who have criticized *Milosao* for being fragmentary do not seem to be aware that the work is a “lyrical romance” (“romanzo lirico”) not a narrative poem. The work does not purport to be a chronologically ordered sequence of events linked together into a story, but only the record of some significant moments of that story. The moments are lyrical fragments in their own right; narrative is the framework into which they are collected. Like all true poets, de Rada knew by instinct that the genuine poetic voice may have little range but must have a unique tone, the verbal translation of a deep and all-pervading feeling.⁶⁹

⁶⁹ Arshi Pipa, “*Milosao*”: A Popular and Classical “Lyrical Romance,” p. 349. In his letter “Giudizio sul suo poema *Il Milosao*” (“Judgment on Your poem *The Milosao*,” written in Florence, on July 30, 1873), Niccolò Tommaseo also praised De Rada for the so-called *frammentismo deradiano* (Deradian fragmentism), arguing that instead of being a flaw, it makes *Milosao* one of the most innovative works of the Romantic poetry: “Altri dice un po’ troppo frastagliati i Suoi canti. Ma Ella che accenna all’immortale colomba d’Anacreonte, m’avverte che non è da condurre con spago rettorico i moti liberi de’ volanti. Altro spago ora veggo che nel 1839 strinse Lei; e veggo come di moderazione insieme e di risolutezza il cuore Le fosse maestro. Nel Suo cuore è l’umile ‘ambizione del bene’, perché ricco in ‘amore d’eterna vita’.” (“Others say that Your songs are a little too jagged. But You, who mentions the immortal dove of Anacreon, warns me that the free movements of the flyers are not to be conducted with rhetorical string. Now I see that in 1839 You held another string; and I see that Your heart was a master of moderation and resolution at the same time. In your heart is

As a conclusion of his important contribution on the study of Girolamo De Rada's *Milosao*, Arshi Pipa likes to point out the richness of De Rada's production, which incorporates together with the Albanian roots and tradition, the Ancient Greek and Italian literatures:

"In conclusion, the peculiar nature of *Milosao* is a composite one. It represents an Ionian Sea culture to which three civilizations have contributed: Greek, Italian, and Albanian. If Albania was de Rada's country of origin and Italy his adopted one, Greece was his ideal country, just as it was for Foscolo and Hölderlin. It is not an accident that *Milosao* bears as an epigraph these lines from Pindar's third Olympian ode:

Thus the Muse stood by me
who found the glorious way
to adjust the voice to the Dorian mode."⁷⁰

2.2. "A Strange name"

One other theme studied by Arshi Pipa is the origin of the "Strange name" of the Albanian hero *Milosao*. Pipa pointed out that "the source may be literary" since it doesn't belong to the Arbëresh tradition: "No record

the humble 'ambition of goodness', because it is rich in 'love of eternal life.'". Girolamo De Rada, *Opera Omnia, Epistolario con N. Tommaseo. La corrispondenza inedita tra Girolamo De Rada e Niccolò Tommaseo (1860-1874)*, (*Opera Omnia. Correspondence with N. Tommaseo. The Unpublished Correspondence between Girolamo De Rada and Niccolò Tommaseo [1860-1874]*). Michelangelo La Luna, ed. Vol. XII, 1. Rende: University of Calabria; Soveria Mannelli: Rubbettino Editore, 2006, Letter n. 94, pp. 201-210 (209-210).

⁷⁰ Arshi Pipa, "*Milosao*": A Popular and Classical "Lyrical Romance," p. 350.

exists of a Milosao, son of the despot of Scutari. Did De Rada invent the persona, or only change the name? And where did he pick up the strange name which is not Albanian, Italian, or Greek?"⁷¹ It is possible that the name derives from the Serbian "Milloshini", and it is formed by the suffiss -šin connected with the root "Milŭ", such as in "Milosclavo" or "Miloslav", with the loss of the morpheme -l, such as in many Serbian-Croatian names ending in -slav, like "Milosav," character of an epic poem published in 1870 by P. Miklosich.⁷² Milloshini is the name of a character that appears already in De Rada's *Canti Premilosaici* (1833-1835), and *Rapsodie d'un poema albanese* (1866).

Another hypothesis, supported by Francesco Altimari, is that Milosao comes from Milošav, a name that may have adapted to Italian, replacing the original Slavic final morpheme -v, with the morpheme -o of Italian nouns in the masculine singular.⁷³

Another important contribution given by Arshi Pipa is the attempt to construct a *stemma codicum* of *I canti di Milosao*. Pipa, in fact, was among the first scholars who identify and dated the two original manuscripts of the

⁷¹ ID., *Hieronymus de Rada*, vol. 2 of *Trilogia Albanica*, München, Trofenik, 1978, p. 51.

⁷² ID., *Hieronymus de Rada*, p. 56.

⁷³ Francesco Altimari, *I Canti di Milosao di Girolamo De Rada: storia e struttura del poema*, pp. 80-81. "LEA - Lingue e letterature d'Oriente e d'Occidente," n. 6 (2017), pp. 79-98 (about Milosao's name, see section 1. *Perché Milosao? Why Milosao?*, on pp. 80-83). On the same topic, also see Matteo Mandalà, *Hieronymus: Portret artisti në rini (1832-1837) (Artist Portrait in Youth, [1832-1837])*, Tirana, Naimi, 2018, pp. 31-33; ID., "Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës" (1822-1837) (On the youthful education of Girolamo De Rada), in Floresha Dado, *Jeronim De Rada. Konferenca shkencore ndërkombëtare kushtuar 200-vjetorit të lindjes (1814-1903) (Girolamo De Rada. Conferenza scientifica internazionale dedicata al 200° anniversario della nascita)*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 153-194.

long poem published by De Rada in 1836: “These considerations would lead to dating the Tirana Manuscript not later than the first half of 1835, while the Copenhagen Manuscript, which is an enlarged version, must have been written during the second half of that year or the beginning of the next”.⁷⁴ Pipa’s research and conclusions are quite relevant for the critical edition and analysis of De Rada’s masterpiece, although the date of the Tirana manuscript has been pushed back by Altimari to 1834:

Non figurando nel “Manoscritto di Tirana” il canto *Praçëdielli ira te shtrati* che il Poeta ci attesta nella sua Autobiografia di aver composto in carrozza, per le vie di Napoli, il 24 novembre del 1834, non regge assolutamente l’ipotesi del Pipa di datare alla prima metà del 1835 questo manoscritto, mentre non si può escludere che il “Manoscritto di Copenaghen”, ad esso sicuramente posteriore, possa risalire alla seconda metà del 1835 o agli inizi dell’anno successivo.⁷⁵

“Since the song *Praçëdielli ira te shtrati* does not appear in the “Tirana Manuscript”, which the Poet attests in his *Autobiography* that he composed in a carriage, in the streets of Naples, on November 24, 1834, Pipa’s hypothesis of dating this manuscript to the first half of 1835 is absolutely untenable, while it cannot be excluded that the “Copenhagen Manuscript”, which is certainly later, could date back to the second half of 1835 or to the beginning of the following year.”

⁷⁴ ID., *Hieronimus de Rada*, p. 41.

⁷⁵ F. Altimari, Francesco Altimari, *I Canti di Milosao di Girolamo De Rada*, p. 92, n. 14.

3. *L'Odisse*

Girolamo De Rada is well known for his compositions in Arbërisht, but we must consider that he also wrote several works in Italian that are equally important, and that are essential for a full knowledge of his literary production. The most interesting one is *L'Odisse* (Odysseus), a poem that remained for about a century and a half untraceable, even for the most important scholars of De Rada, such as Michele Marchianò, Vittorio Gualtieri, Dhimitër S. Shuteriqi, and Arshi Pipa who stated: "This poem, which was published in 1845 [1847 Ed] by Saverio Prato, has apparently been lost, since no copy has been located for generations".⁷⁶ Thanks to De Rada's *Autobiography*, we know that in the years 1845-1846 he gave the manuscript of the first draft of *L'Odisse* to the "son of a deceased judge," who was recommended to him by his brother Camillo, *papàs* of the Greek Church of Lecce:

Vuò ricordare come in quel tempo
vennemi da Camillo raccomandato il figlio
d'un Giudice defunto, e come non avendo
di che sovvenirgli gli regalai il manoscritto
dell'Odisse, poemetto in terza rima
d'argomento nazionale da me composto
nel Collegio di Sant'Adriano. A Lui riuscì
di promuovere la stampa dedicandolo alla
moglie del Ministro degl'Interni
Sant'Angelo, la quale discendeva, diceano,
da Principi Albanesi e n'era vana. La
dedica era firmata Saverio de' Marchesi

⁷⁶ A. Pipa, *Hieronymus De Rada* (volume II of *Trilogia Albanica*), 1978, p. 30.

Prato, a cui la Gentildonna regalò ducati
250. Ho un esemplare dell'opera edita.⁷⁷

"I would like to remind you that at that time Camillo recommended me the son of a deceased judge, and since I had nothing to give him, I gave him the manuscript of the *Odysseus*, a poem in *terza rima* of national subject composed by me in the Collegio of Sant'Adriano. He succeeded in promoting the printing, dedicating it to the wife of the Minister of the Interior Sant'Angelo, which descended, they say, from Albanian Princes and she was vain about it. The dedication was signed by Saverio de' Marchesi Prato, to whom the Gentlewoman gave 250 ducats. I have a copy of the published work."

The poem was published in Naples in 1847, at the Typography of the newspaper *Il Salvator Rosa*, under the name of Francesco Saverio De' Marchesi Prato, who later claimed to be a descendent of Giorgio Castriota Scanderbeg and was sentenced for using false identity, and in March 1871 was condemned to pay Mr. Emanuele Civasco, honor of an hotel in Genoa, for the room and board he got together with two women (who he declared to be his wife and his mother in law).⁷⁸ In his introduction to *L'Odisse*, De' Marchesi Prato thanks Camillo De Rada for his help in illustrating the customs and traditions of the Albanian populations, but he doesn't mention Girolamo as the person who gave him the manuscript.

⁷⁷ Girolamo De Rada, *Autobiografia*, III, p. 20; for which see the following edition: *Opera Omnia. Autobiografia*. [*Opera Omnia. Autobiography*.] Michelangelo La Luna, ed. Vol. VIII. Rende: University of Calabria; Soveria Mannelli: Rubbettino Editore, 2008.

⁷⁸ *La Legge: Monitore Giudiziario e Amministrativo del Regno d'Italia*; Parte Prima: *Legislazione e Giurisprudenza Giudiziaria*, anno XI, 1871, VI della Legislazione Unificata, Firenze, Civelli, 1871, pp. 321-323

However, he recognizes the latter as the Dante of Albanian literature, and as the author of the Albanian verses contained in the footnotes of *L'Odisse* (Canto Primo, note 4).

We are unable to establish with certainty which were the interventions on the text carried out by De' Marchesi Prato, because we do not have the original manuscript of the work. In fact, the only document we have on the subject is the one contained in Carte Deradiane (Deradian Papers) 1-3β (2294-2299) discovered by the Arshi Pipa at Biblioteca Civica of Cosenza. It is a poem, transcribed on 17 sheets, entitled *Ode Albanese* (Albanian Ode), which consists of a preface in prose and two songs in free verse. According to Pipa, it was composed by De Rada in the first period of his Neapolitan sojourn, that is around 1835-1836. Moreover, Pipa argues that the *Ode Albanese* and the *L'Esule di Croja* (The Exile of Croja) are the first and second drafts of *L'Odisse*. This seems to be a rush conclusion since De Rada recalls in his *Autobiography* that *L'Odisse* was written at the Collegio of Sant'Adriano, in San Demetrio Corone, in 1832, and not in Naples (as Pipa proposed). However, it is possible that the manuscript kept at Biblioteca Civica of Cosenza is the version in verses of *L'Odisse* written between the end of 1835 and the first months of 1836, of which the poet talks in his *Autobiography*. What we can conclude is that *Ode Albanese* belongs to the family of *L'Odisse*, since the two long poems deal with the same topics, and the only difference between the two is the different names used to indicate some of the characters. In fact, in the manuscript of Biblioteca Civica of Cosenza the main hero is called Nevralge, son of Astonome and Odisseo. As in *L'Odisse*, after the fall of Croja (Krujë), the protagonist flees to Calabria and marries Eugloè, daughter of the noble Albanian Perlato. He had escaped from his city of origin Sfettigrado (Svetigrad), where all his children had died fighting against the Ottoman invaders. Like the homonymous hero of *L'Odisse*, in the first canto Nevralge

(whose name according to Pipa, comes from the Greek νευραλγία and indicates a chronic nostalgia for the homeland) narrates in detail the events of the fall of Croia (1468): the vain attempt to save his rival in love Morvan, who falls in battle, his victory over the Turkish army led by General Alican who was killed, the death of his father Odysseus, and the escape to Italy of the Albanian refugees. One last note to make about the manuscript of the Biblioteca Civica di Cosenza, which also applies to *L'Odisse*, is that De Rada uses Greek names for his Albanian characters. According to Pipa, this happens because in the years in which he composed his work, De Rada was not yet able to distinguish the difference between Greek culture and Albanian culture.⁷⁹

To what Pipa said, we must add that by using Greek names, the young De Rada wants, in a certain sense, to be a continuator of the classical epic authors (in particular of Homer), as a singer of the epic of the Albanian people. We can conclude, together with Pipa, that De Rada's literary education in the high school and university years has nothing to do with Albania, but is based on the study of the authors of the Greek, Latin and Italian literature. This is a big lesson given by Pipa in years in which Albanian scholars, influenced by the communist regime of Enver Hoxha, tried to interpret and use De Rada almost exclusively as a national bard. In fact one of the Cantos mostly studied was the fifth Canto of *Milosao*, which speaks about Albania.

References

Altamari, Francesco. I Canti di Milosao di Girolamo De Rada: storia e struttura del poema, "LEA - Lingue e letterature d'Oriente e d'Occidente," n. 6 (2017).

⁷⁹ A. Pipa, *Hieronymus De Rada*, p. 30.

Dado, Floresha. Jeronim De Rada. Konferenca shkencore ndërkombëtare kushtuar 200-vjetorit të lindjes (1814-1903) (Girolamo De Rada. Conferenza scientifica internazionale dedicata al 200° anniversario della nascita), Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

De Rada, Girolamo. Opera Omnia. Autobiografia (Opera Omnia. Autobiography), Michelangelo La Luna, ed. Vol. VIII. Rende: University of Calabria; Soveria Mannelli: Rubbettino Editore, 2008.

Mandalà, Matteo. Hieronymus: Portret artisti në rini (1832-1837) (Artist Portrait in Youth, [1832-1837]), Tirana, Naimi, 2018.

Pipa, Arshi. "The Odyssey of De Rada's Manuscripts", Përpjekja e Jonë (Our Effort), III, 4, 12 November 1972.

_____. "Milosao": A Popular and Classical "Lyrical Romance," in Comparative Literature Studies, Sep. 1970, Vol. 7, No. 3 (Sep., 1970).

_____, Hieronymus de Rada, vol. 2 of Trilogia Albanica, München, Trofenik, 1978. La Legge: Monitore Giudiziario e Amministrativo del Regno d'Italia; Parte Prima: Legislazione e Giurisprudenza Giudiziaria, anno XI, 1871, VI della Legislazione Unificata, Firenze, Civelli, 1871

ARSHI PIPA: NOLI VS KONICA

Hyrje

Njohja ime me veprën e Arshi Pipës nis në vitin 2005, kur po qëmtoja t'i njihja format dhe metodat e kritikës letrare shqipe. Në atë kohë qeshë zhvendosur në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, për ta kërkuar atë që unë e quaja *fije e këputur* e kritikës letrare shqipe, përfaqësuesi më i denjë i së cilës qe Arshi Pipa. Kritika e tij, sikur edhe ajo e Qemal Draçinit e ndonjë tjetri, ishte pothuajse e panjohur. Studimet letrare shqiptare, përfshirë edhe ato në Kosovë, i përmendnin shkarazi, por vepra e tyre nuk njihje ende. Mua më ra fati që tekstet e tyre t'i nxirrja nga pluhuri i bibliotekës dhe t'i mbroja nga pluhuri i harresës. Kjo është arsyeja pse unë zgjodha për metodë atë që Eco-ja e bënte për “Silvinë” e Nerval-it, t’ia paraqitja lexuesit tekstin e Pipës dhe tekstin tim interpretues për të.⁸⁰

Kumtesa ime trajton tekstet kritike të Arshi Pipës, kryesisht kritikën publicistike të tij, më saktësisht tekstet e tij kritike për dy autorë të letërsisë shqipe, të cilët kanë vepruar e krijuar në vendin e “Vatrës”, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rikontekstualizimi i teorie

Në vitet '40 të shekullit të kaluar, Pipa shkruante kryesisht *kritikë akademike* dhe *kritikë të shkrimtarit*, sipas përcaktimit të Tībodesë (Thibaudet), të cilat i botoi

⁸⁰ Shih librin: *Kritika e tekstit – Arshi Pipa* (“Buzuku”, Prishtinë, 2007).

kryesisht në revistën e themeluar nga ai vetë: *Kritika*. Gjithë krijimtarinë e tij të asaj kohe unë do ta përmbledhja në dy dimensione shumë të fuqishme:

Arshi Pipa është rikontekstualizuesi i parë i madh i teorive kritike. Nëse Konica shkruante të parin artikull me premisa të mirëfillta të teorike në gjuhën shqipe, *Kohëtoren e letrave shqipe* (1906), Pipa qe dialogues i madh me tekstin teorik të Konicës. Në tekstin e tij, *Shpirti kritik*, dialogon me premisat kryesore teorike të Konicës dhe e rikontekstualizon teorinë e tij mbi kritikën letrare shqipe. Teksti i Pipës mbetet sot e kësaj dite njëri ndër tekstet e para, i cili, duke e rikontekstulizuar teorinë letrare të Konicës, u shndërrua në bartës e kodifikues të tyre në kritikën letrare shqipe.

Dimensioni i dytë është ai i kritikës. Në tekstet e tij kritike, sidomos në tekstet e tij për Nolin e Migjenin, ai e ktheu kritikën drejt shenjave të tekstit, duke hapur mundësi të re interpretimi në letrat shqipe. Për argumentim: kritika e kohës, ajo e mëhershme, mbështetet kryesisht mbi premisa sociale në interpretimin e tekstit letrar. Pipa, në anën tjetër, e ktheu kritikën nga teksti, nga shenjat tekstore dhe dialogimi me to. Interpretimi që ai u bën teksteve letrare ndërtohet kryesisht si raport i dyfishtë: në njërin anë dialogon me tekstin letrar (të Nolit, Migjenit e të tjerëve), ndërsa në anën tjetër me tekstet kritike mbi këto tekste, sikur është, ta zëmë, teksti i Kutelit për Nolin. Pra, Pipa e zhvillon njëkohshëm tekstin kritik dhe metakritik.

Noli e Konica: Rikrijuesi e krijuesi

Tekstet e tij për Nolin, Konicën e Migjenin, janë esencialisht tekste kritike, duke ndikuar në krijimin e “një të mirëfillte kritike letrare”, të atillë çfarë e synonte më herët Konica. Për audiencën e “Vatrës” ne jemi përqendruar kryesisht në tekstet e tij për Nolin dhe Konicën. Po për këtë audiencë, ne do të shqyrtojmë

njëkohshëm dy dimensione të kritikës së tij për këta dy autorë: qëndrimet e Pipës mbi personalitetin, karakterin krijues të Nolit dhe Konicës, në njërën anë, si dhe interpretimin e teksteve të këtyre dy autorëve, në anën tjetër.

Sa i përket çfarësimit që ai ia bënte karakterit të Nolit, ai mbërrinte në përfundimin se “Noli ishte një apostull nacional”, i cili merrej më shumë me edukimin kombëtar sesa me krijimin. Në të vërtetë, Noli për Pipën nuk ishte krijues i mirëfilltë:

Poezia e tij nuk e ka ondulacionin e valëve në mezin e detit, por përplasjen e tyre anës, me zhurmë, gjithmonë të përsëritur.

Më tepër se krijues, Noli që rikrijues (Pipa thotë: riprodhues), para së gjithash po ta marri parasysh vlerën e madhe të veprave të përkthyer nga Noli. Aty Noli qe gjenial. Porse, ky gjenialitet ishte shpërthyes vetëm herë pas here, ngase Nolit i mungonte përqendrimi në gjëra. Duke analizuar karakterin e Nolit, Pipa nënvizonte se sikur në jetë edhe në poezi, Noli qe “nji shtegtar, nji dilektant, por gjenial”. Ai u sprovua në të gjitha gjinitë letrare, por pa e vënë zhigun e vet të plotë në asnjërën syresh, ngase ai “e kqyri artin jo në vështrim të permanencës, por të kontigjencave historike”. Këto kontigjenca e kthyen Nolin, shqiptarin evropian e revolucionar”, në fitues të madh në jetë e në humbës në letra, njësoj sikur e kishin shndërruar “apostullin e idesë nacionale”, Naimin, në edukator nacional, ose “tradicionalistin konservator”, at Fishtë, në ideolog nacional. Ngjashëm me ta, Noli kishte përfituar shumë në jetë, “duke e edukue ndjenjën politike të popullit”, por kishte humbur po kaq shumë në letra, duke u shpërqendruar vazhdimisht nga studimet dhe duke mos e arritur asnjëherë kulmin e krijimtarisë letrare. Kësisoj, veprat e tij mbesin të papërmbyllura ose pa nivel të lartë letrar. Ta zëmë: dramën *Israleitë e filistinë*, Pipa e quante “foshnjë-dramë”, në të cilën autori i saj, Noli, nuk arriti

të ndërtonte karaktere të mirëfillta letrare, por e cila bartte ide të fuqishme.

Sipas Pipës, Noli ka pasur ide të mëdha dhe shije të përkryer për artin, por i dhënë pas ideve për kombin, ai nuk e gjeti dot përqendrimin e mjaftueshëm për t'i përfunduar veprat e veta.

Pse nuk muji me krijue në një mënyrë të përsosun, -thotë Pipa, Noli u asht shmangë krijimeve.

I vetëdijshëm për mungesë origjinaliteti, Noli na dha margaritarë të tjerë: përkthimet e shkëlqyera të kryeveprave të letërsisë së përbotshme. Përkthimet, sipas Pipës, i shërbyen atij edhe për një qëllim politik: që t'u rrinte më afër ideve që i përqafonte, të cilat e përfruan atë me një tip të veçantë letërsie, të cilin ai e gjente në veprat e autorëve të cilët i përkthente. Duke përkthyer vepra klasike e duke e pasuruar letërsinë me një tip letërsie të veçantë, ai megjithatë mundi të krahasohej me “prelatët e përlindjes italiane”, sikur e quante më herët Konica. Sipas së njëjtës pikëpamje, Pipa e quante Nolin një lloj “trashëgimtari të idealit t'grekvet”, duke e lidhur qëndrimin e tij karshi nacionit me kodin e madh të idealitetit kombëtar.

Pipa shkroi edhe një tekst të veçantë për Nolin, në të cilin ia njeh këto merita, në tekstin e diskursit kulturor, *Bariu i popullit*. Aty ai e karakterizon edhe tipin e letërsisë së Nolit. Sipas tij, Noli kishte shkruar kryesisht letërsi me qëllime praktike dhe jo letërsi me shenja artistike. Kjo e ridëshmonte atë humbës në letra e përfitues në rrafsh të ideve.

Ndryshe nga Noli, Konicën e trajtonte kryesisht në rrafsh të analizës psikologjike. Qoftë kur diskutonte për karakterin e veprave të tij, qoftë të personës së tij, Pipa rrekej ta studionte psikologjinë e tij letrare, para se veprat e tij, si dhe karakterin psikologjik të autorit Konica. Mbështetur mbi këto premise, ai e cilëson Konicën konsolidues të “prozës toskë”, sikur e cilësonte ai prozën

letrare të krijuar në jug të Shqipërisë, *ma i madhi stilist shqiptar dhe një aristokrat deri n'art*. Për ndryshim nga Noli, Konica ishte krijues. Ai e shpërfaqte imagjinatën krijuese në veprat e tij, por edhe ky “i pasistemuar në letra”. Kjo, mbase, e shtyu që ai të bëhej sistemues i madh i vetëdijes për to.

Përfundime

Qoftë kur flet për Konicën, qoftë për Nolin, Pipa dëshiron të shqyrtojë një lloj raporti psikologjik që këta dy autorë kanë pasur me krijimtarinë e tyre letrare. Pipa përgjithësisht i mbetet besnik idesë se shkrimtari nuk mund të shihet i shkëputur nga jeta. Karakteri, personaliteti i tyre letrar nuk mund të trajtohet veçan karakterit ose personalitetit të tij jetësor. *Autorët e sjellin artin e tyre në jetë duke tue e ba jetën e tyre poezi, tue artistizue*. Shembuj tipikë janë Baudelaire-i, D'Annunzio etj. Konica u përngjet këtyre autorëve, por prej s'largu. Ai nuk arrin që të çohet mirëfilli në nivel të autorit, i cili i përkushtohet letërsisë, artit të tij. Ai mbetet i pasistemuar, pa u realizuar plotësisht si krijues, njeri ekstremesh e pasionesh të mëdha, i cili këndej nuk begeniste, por andej nuk falte, njeri që nuk shkroi vepra të plota, njeri që nuk arriti të realizohej asnjëherë plotësisht, por “i tani stil”, stilist i përkryer. Nga tekstet që merr në shqyrtim, Pipa nxjerr përfundimin se duke qenë kaq lart estetikisht, letërsia e Konicës nuk arriti të kishte bashkëbisedim të duhur me lexuesin në kohën e tij dhe kjo mund ta ketë shtyrë atë që stilin e tij ta shtynte drejt një diskursi satirik, i cili, në gjykimin e Pipës, ishte i tepruar, ngase e rriti hendekun mes tij e lexuesit. Ai e mbisundoi Konicën, duke e rritur padurueshmërinë e lexuesit ndaj veprës së tij në kohën kur ai i shkruante dhe i botonte tekstet e tij, gjë që, sigurisht, nuk mund të thuhet për komunikimin e lexuesit të mëvonshëm.

Përgjithësisht, kritika akademike dhe ajo e shkrimtarit, sikur edhe teoria e rikontekstualizuar prej Pipës janë të rëndësishme për letrat shqipe. Tashmë krijimtaria e tij kritike dhe niveli i dijeve, i njohurive teorike që ai i bart në tekstet e tij, është pjesë e rëndësishme e korpusit kritik në letrat shqipe.

KEN'S

VERON DOBROSHI

TOPIKA SIMBOLISTE NË FANTAZINAT E ARSHI PIPËS

Hyrje

Arshi Pipa është një nga intelektualët e rëndësishëm që ka njohur kultura shqiptare deri më sot. Me një dije të gjerë në fusha të ndryshme dhe me angazhimin e palodhshëm në sfera të ndryshme, ai zë një vend të veçantë në kulturën shqipe të shekullit XX. Arshi Pipa dha një kontribut të çmuar me studimet e tij të shumta mbi fenomene të ndryshme të lidhura ngushtë me historinë, politikën, letërsinë dhe kulturën shqiptare në përgjithësi. Në kritikën letrare të viteve '40 e gjer në studimet e viteve të fundit, Pipa u njoh dhe u vlerësua më tepër si kritik letrar, ndërkaq poezia e tij mbeti nën hijen e shkrimeve të tij kritike. Kjo padyshim nuk e zbeh vlerën e tij edhe si poet, veçmas me poezitë në përmbledhjen *Autobiography* (1988) dhe *Libri i Burgut* (1959), pavarësisht që ky i fundit nuk e njohu integralisht fatin e botimit në gjuhën angleze. Objekt i këtij studimi do të jetë një cikël me disa poezi të titulluara “Fantazina” që janë shkruar në mes të viteve 1937-1939 dhe janë të trupëzuara në vëllimin me poezi “Lundërtarë”, një prej botimeve të para të autorit. Poezitë e ciklit “Fantazina” janë të shkruara në rininë e autorit dhe janë vargje që reflektojnë mbi fazat e para të shkrimit poetik dhe që manifestohen me disa lirika të fuqishme në aspektin stilistik, metrik dhe të koncepteve të ndryshme, përmes të cilave ndërtohen simbolika të shumta. “Fantazina” përbëhet nga nëntë poezi, të cilat i bashkon një frymë e përbashkët, ajo e fantazisë së thellë krijuese dhe imazhi impresionist. Vargjet e Pipës janë një lloj lundrimi rreth botës, në përpjekje për ta kuptuar vetë botën në të cilën jetojmë.

*“Me një fjalë, dituria e vërtetë të jep fuqi, e mua më duket gjithnjë se letërsia e ka këtë funksion, se e derdh njeriun, njerëzimin në përgjithësi, me të mirat dhe me të metat, kështu që njeriu kur i derdhet letërsisë, fillon dhe kupton nga bota”.*⁸¹

Simbolizmi

Simbolizmi si lëvizje letrare lindi dhe u zhvillua kryesisht në dekadat e fundit të shek. XIX dhe si epitom i tij ishte Charles Baudelaire me veprën e njohur *Lulet e së keqes* (Les Fleurs du mal). Përfaqësues të tjerë të rëndësishëm ishin edhe Stéphane Mallarmé dhe Paul Verlaine. Simbolistët në shkrimet e tyre kishin në plan të parë anën metaforike, përmes së cilës krijonin kuptime simbolike dhe kishin lidhje të ngushta me elemente romantike dhe impresioniste. Jehona të kësaj rryme dhe këtij tipi shkrimi ndeshim edhe në poezinë e autorit shqiptar Arshi Pipa. Në ciklin me poezi “Fantazina” vërehet fryma entuziaste dhe kreative e një shpirti të ri artistik që është në fazat e hershme të shkrimit, ku veçohet artikulimi i vargjeve përmes rimës, ritmit, muzikalitetit dhe figuracionit të dendur. Brenda ciklit të poezive “Fantazina” hasen shumë figura konceptuale që shndërrohen në simbole përmes artit krijues të autorit dhe që arrijnë të ngacmojnë thellë ndjenjat dhe imagjinatën e lexuesit. “Fantazinat” e Pipës përbëhen nga poezi të cilat kanë natyrë impresioniste meqë pasqyrojnë kryesisht imazhe të natyrës, stinëve, koncepteve kohore, objekteve natyrore dhe të ngjashme.

Simbolika e natës

Në poezitë e ciklit “Fantazina” nata ka një rol shumë

⁸¹ Arshi Pipa, *Dokumentar* nga TVSH i viteve 90, min. 22:47-23:05.

të rëndësishëm brenda vargut të Pipës. Nata si koncept ka konotacionet e të zezës, por jo gjithmonë në kuptimin negativ të fjalës. Ajo mund të jetë një koncept ambig që pasqyron edhe kuptime tjera si gjumin, errësirën, qetësinë etj. Në rastin e poezive të Pipës nata përçon kuptime dhe simbolika të shumta, por të lidhura gjithnjë me aspektin pozitiv, të qetësisë që rregullon natyrën, i jep asaj bukurinë, ngjall qetësinë dhe sjell freskinë. Nata del edhe në titullin e dy prej poezive të këtij cikli, “Natë vere” dhe “Idil nate Maji”, dy poezi që në qelizat e tyre krijuese përçojnë impresione të theksuara të një natyre të qetë e të bukur. Tek “Natë vere” sintagma tregon qartë, bëhet fjalë për një natë në stinën e verës, stinë kur gjallërohet natyra dhe është burim i bukurive të shumta. Kjo poezi ndërtohet mbi një sistem të larmishëm figuracioni dhe përdorimi të mbiemrave. Mbiemrat paraqiten si epitete që kanë një nëntekst të qartë, se nata është burimi i qetësisë.

*Natë vere e ambël, natë verore e shqetë!
Ndiheh nën qiell sa murmuritje e zana...
Natë! Hyjet xhixhillojnë mes gjethesh e hana
Te ftyra e jote asht e zbetë e zbetë.⁸²*

Nata në këtë poezi merr edhe rolin sipëror ndaj ditës në kontekstin e stinës së verës, ku netët janë më të gjata dhe përplot freski e harmoni. Përmes dikotomisë ditë-natë, poeti mbithekson rëndësinë dhe rolin e natës në stinën e verës. Nata në këtë poezi fiton kuptime simbolike edhe përmes metaforave kur poeti ia jep natës edhe sytë, por të cilat ia ka vjedhur hëna, një simbol tjetër që manifestohet në këto lirika të Pipës. Elementi i mbitheksimit të natës si simbolikë e kësaj poezie dëshmohej edhe me përdorimin e fjalës “natë” në të tri strofat e poezisë, ku në të parën përmendet dy herë. Ajo çka bie në sy është edhe toni thirrës që manifestohet me

⁸² Arshi Pipa, Vepra 1 (Lundërtarë, Libri i dashunis dhe i fatit), Plejad, Tiranë, 2010, 49.

thirrjen e unit lirik në trajtën “O natë!” Në poezinë tjetër “Idil nate Maji” është gjithashtu prezent ky lloj toni, por në këtë rast drejtuar hënës dhe në një rast tjetër, natës së majit, duke e specifikuar edhe periudhën kohore, gjegjësisht muajin.

*Me mija p'rralla enden valë-e-valë
O nata e majit magji-plote!
...rrugavet t'ngushta sonte kemi dalë
me njoftë ku struket kjo magjia e jote...*⁸³

Pjesa e parë e vargut të cituar të kujton poezinë ilustrative me titull “Ah! Sun flower” të poetit e piktorit të njohur anglez William Blake. Këto jehona intertekstuale dëshmojnë për ndikimet që ka pasur autori nga poetët e ndryshëm simbolistë, romantikë e impresionistë dhe gjithashtu kreativitetin për të pikturuar përmes fjalëve, gjë të cilën e realizon mjaft mirë në “Idil nate Maji”, por në trajta tjera edhe në poezitë “Male të shkreta”, “Dimën”, “Sonatë fusharake” etj. Te “Idil nate Maji” janë burbuqet që shprehin ardhjen e diçkaje të re, freskinë, ëmbëlsinë e gëzimin që sjell nata në këtë muaj pranvere. Titulli i kësaj poezie jo vetëm që paraqet kohën, por specifikon edhe tipin e shkrimit, atë të idilit. Meqë idili shquhet për paraqitjet deskriptive me pamje piktoreske të një ambienti rural, në rastin e Pipës, ambienti manifestohet si vend rural, që në disa poezi vetë poeti i referohet si katund. Te poezia “Sonatë fusharake” është përsëri nata si simbolikë e qetësisë.

*E gjithkush asht i gzueshëm
pse lodhja e punës iku e nata erdhi,
nata qi prehje e gjumë t'ambël do t'derdhi.*⁸⁴

⁸³ Arshi Pipa, *ibid.*, 51.

⁸⁴ Arshi Pipa, *ibid.*, 47.

Në këtë poezi dominojnë pasazhet deskriptive me një ton çlirimi dhe gëzimi për ardhjen e natës bashkë me elementet e tjera që e shoqërojnë përreth, ndër të cilat veçohen aroma e luleve, këngët e nënave që i këndojnë foshnjave të tyre, flladi, hëna, ngjyra e reve etj. Te “Kanga e bylbylit” uni lirik flet nga perspektiva e bylbylit që karakterizohet nga zëri i bukur dhe kënga e veçantë të cilat arrijnë të bëjnë mrekullira, duke ia ndalur ritmin edhe natës.

*Dhe atje n’kopshtijet, ndër skutat e mshehta,
shenjonte zani im për dashunorët
çasin e prekjës plot dëshira t’nxeha...
Habitej nata e i ndalonte orët.⁸⁵*

Poezia tjetër “Dimën” paraqet pamjen e stinës së dimrit, por dhe ndikimin e dimrit në shpirtin njerëzor. Dimri simbolizon ftohtësinë dhe rrjedhimisht në këtë poezi, uni lirik përqendrohet edhe në ndikimin psikologjik që ka tek njeriu. Në rastin e kësaj poezie, është një plak dhe një fëmijë që shihen nga perspektiva mendore në raportin që kanë me borën e parë, trishtimin dhe atmosferën e zymtë. Kjo poezi mbyll ciklin “Fantazina” ashtu siç mbyllet jeta e njeriut në pleqëri, këtë konotacion ka edhe stina e dimrit në qoftë se vështrohet nga aspekti i moshës njerëzore. Poezia “Dimën” e Pipës spikat me simbolikën universale të dimrit si një stinë e ftohtë jo vetëm në planin e paraqitjes së një stine, por edhe asaj njerëzore. Paraqitja e dimrit dhe bota individuale unifikohen duke dhënë vetë simbolikën e poezisë, fundin e shpresës dhe trishtimin.

Lirika e përkushtimit

Në këtë cikël të Pipës gjendet edhe një poezi e titulluar

⁸⁵ Arshi Pipa, *ibid.*, 44.

“Mbas kafazash” që pavarësisht frymës simbolike objektin të cilit i këndon poeti e ka më të diferencuar. Poezia ka tipare përkushtuese meqë poeti poshtë titullit shkruan “Shokut R.R.” Pra, poezia i dedikohet një miku të autorit. Poezia shpreh mallin dhe dashurinë në trajtën e simbolikës së kafazit, që shtrihet mbi nëntekstin e mallit për mikun.

*Te ju flut’ron shpesh hera malli i em!
‘Nji zani t’hollë valon n’për qiell jehona,
merret prej flladësh t’kopshtijevet tona,
ku zogjt pa reshtë cicrojnë prej gëmi n’gem.⁸⁶*

Edhe në këtë poezi subjekti lirik përmes simbolikave arrin të pasqyrojë mallin duke i dhënë ngjyrimë vargjeve përmes koncepteve të ndryshme natyrore.

Shtresimet popullore në trajta simbolike

Elementet popullore e folklorike kanë një traditë të gjatë dhe manifestohen dendur në letërsinë shqipe. Këto shtresime nuk mungojnë as në poezitë e Arshi Pipës. Këto shtresime janë mjaft të pranishme në ciklin “Fantazina” duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me imazhe baritore. “Motive baritore” titullohet njëra nga poezitë e këtij cikli, e cila ka motive të qarta popullore siç përcaktohet që në titull. Kjo poezi t’i kujton takimet e të rinjve tek kroi dhe dashurinë që lind si rrjedhojë e saj. Në këtë lirikë kemi edhe elemente nga mitologjia shqiptare meqë vasha krahasohet me orët e bjeshkëve, por nuk mungon as figura e shtojzovallës. “*Shtojzovollat janë figura mitologjike shumë të pranishme në letërsinë popullore shqiptare. Figura të njohura të përrallave të Shqipërisë së veriut, që përfytyrohen si vajza shumë të bukura e me fuqi të mbinatyrshme që duan këngë e valle. Vendbanimi i tyre i*

⁸⁶Arshi Pipa, *ibid.*, 45.

parapëlqyer ishin bjeshkët dhe pyjet e dendura, ku ato e kalonin kohën duke kënduar e vallëzuar. Quhen edhe Shtozorreshta, Shtozote”⁸⁷.

*Natën pranë kronit, qi dikon si i mekun
ngadalë pikat sa mundesh me i njehun,
lot t’akullt t’ndonji shtojzovallje s’mshahun
qi qan kush’di çfarë dashunije t’vdekun...⁸⁸*

Ndërkohë vetë Pipa pohonte: “Pritet që mitologjia shqiptare të jetë mjaft sinkretike. Mund të flitet për shtresa alogjene përgjatë bushtit të një konstanteje lehtësisht të identifikueshme që është: kulti i karakterit (genit) të racës. Hyjnitë e kësaj mitologjie janë thuajse të gjithë paganë. Aty janë nusët e malit dhe këshetat, por edhe shtojzovallët dhe zanat”⁸⁹.

Në këtë poezi, simbol bëhet edhe koncepti i dashurisë. Këtu dashuria bëhet motiv për realizimin e dëshirave dhe ëndrrave të unit lirik. Dashuria që tret zemra nën shtresimet popullore të motiveve baritore siç paralajmëron poeti në titull, përcakton qartë edhe tipin e motivit, atë baritor dhe rrjedhimisht edhe poezia fiton elemente impresioniste. Dashuria si simbol kyç në këtë poezi përfaqëson ecurinë dhe fatin e dy të dashuruarve, gëzimin, të vërtetën, kuptimin dhe vetë lumturinë. Tek “Male të shkreta” malet dhe pyjet shndërrohen në simbole të thatësisë, zbehjes ku natyra paraqitet si e përhumur dhe e vdekur. Kjo është një lirikë tjetër ku poeti jep një tablo të një natyre që po shkon drejt shuarjes. Vasha si personazh shumë i pranishëm në folklorin shqiptar është figurë kyçe në poezinë “Balada e vashës”. Këtu pasqyrohet reflektimi i një vashë që del si trajtë

⁸⁷ Azem Qazimi, *Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare*, Plejad, Tiranë, 2008, 121.

⁸⁸ Arshi Pipa, *Vepra 1 (Lundërtarë, Libri i dashunis dhe i fatit)*, Plejad, Tiranë, 2010, 58.

⁸⁹ Arshi Pipa, “Mitologjia shqiptare”, *Revista Symbol*, Prishtinë, Nr. 17, 2019, 20-21.

bashkëbisedimi. Vasha e cila ka humbur një person të dashur dhe vuajtjet e shpirtit të saj paraqitet përmes situatave dramatike nën petkun e një mjeshtërie artistike dhe një imagjinatë të lartë krijuese të autorit.

*Toka mbarë një vorr ish ba,
gjeth e pemvet kishin vdekë,
shpirti i vashës ishte mekë...
Frynte veri e u-ndinte 'i za:
S-ka me ardhun kurr, kurrma!⁹⁰*

Vargu i fundit nga pjesa e cituar me tonin thirrës na kujton vargun e famshëm nga letërsia botërore, atë të “Korbit” të Edgar Allan Poes. Në rastin e Pipës, vargu shpreh ngjyrimet emocionale dhe ngushëllimin e vashës, që pranon realitetin jetësor, atë të vdekjes.

Veçori stilistike dhe metrike

Po të vështrohen lirket e Pipës në aspektin stilistik, duket që ato janë shumë të pasura për nga përdorimi i figurave stilistike dhe funksioneve artistike që kanë brenda vargut të këtij poeti. Në ciklin e poezive “Fantazina” përveç simbolit, hasen metafora të shumta, por dhe krahasime, epitete, antiteza etj. Te “Balada e vashës” zemra e vashës krahasohet me lulet e vjeshtës, duke funksionuar gjithnjë mbi simbolin, zemra që tashmë po vyshket nga lëndimi, nga humbja e një personi të dashur. Ndërsa tek “Idil nate Maji” është një natyrë tjetër krahasimi meqë nata ka simbolikën e një fryme tjetër, atë të majit pranveror që paraqitet me një pamje nate të bukur. Këtu netët e ëmbla të majit krahasohen me netët e përrallave.

⁹⁰ Arshi Pipa, *ibid.*, 55.

*Netët e ambra t'majit magji-plote,
si nete prrallash t'moçme qi m'habisin!
Kur si një gojë e madhe asht ftyra e jote
mes hyjzavet, o hanë, qi t'pëshpërisin!*⁹¹

Epitetet janë të pranishme në shumicën e poezive, por shquhen tek “Natë vere” ngaqë përdoren në funksion të karakterizimit të natës si koncept simbolik në këtë lirikë. Antiteza është figurë tjetër prezente që në këto lirika manifestohet disa herë si në rastin e “Idil nate Maji”

*Çilen burbuqet...mbyllen buz't e njoma...*⁹²

Raste të tilla të përdorimit të antitezave paraqiten disa herë për t'i pasqyruar pamjet që ndryshojnë, më tepër në funksion simbolik, për t'i paraqitur në një formë artistike fenomenet që ndryshojnë, bëhen të kundërta meqë lidhen ngushtë me përjetimet, ndjenjat dhe veprimet njerëzore, që kanë në thelb fantazitë e vetë poetit të ri, që lundron në botën e imagjinatës artistike.

Në aspektin metrik, vargjet e Pipës janë të larmishme për nga strofat, rrokjet, por edhe për nga rima. Vargu i tij del shumë i veçantë dhe estetik për nga ky aspekt ngaqë nuk është monoton, është tejet ritmik, ka muzikalitet dhe rimë të pasur. Pjesa më e madhe e poezive të këtij cikli është shkruar në strofë katërshe, përveç poezisë “Balada e vashës” që është shkruar në strofë pesëvargëshe dhe “Male të shkreta” në strofë gjashtëvargëshe. Për nga përdorimi i rimave, vargjet janë të pasura ngaqë poeti përdor të tri llojet e rimave, por më dominuese janë rima e kryqëzuar dhe rima e alternuar.

⁹¹ Arshi Pipa, *ibid.*, 50.

⁹² Arshi Pipa, *ibid.*, 50.

Bibliografia

Pipa, Arshi. Vepra 1 (*Lundërtarë, Libri i dashunis dhe i fatit*), Plejad, Tiranë, 2010.

_____. “*Mitologjia shqiptare*”, Revista *Symbol*, Prishtinë, Nr.17, 2019.

_____. *Dokumentar nga TVSH i viteve 90*: <https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>

Qazimi, Azem. *Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare*, Plejad, Tiranë, 2008.

KEN'S

KENS



ANTON LOGORECI

GJYMTIMI I GJUHËS

Arshi Pipa, *The Politics of Language in Socialist Albanian* (1989), East European Monographs, No. 271. Boulder: Distributed by Columbia University Press. New York, XVI+282 ff.

Nji publikim i fundit amerikan, *Human Rights in the Socialist Republic of Albania*, një raport i Minnesota Lawyers International Human Rights Committee (1990), mundson të dhana gjithëpërfshisë, të përditësuese të politikës së çuditshme, kushteve sociale dhe ekonomike nën të cilat njerëzit kanë kënë tue jetue për ma shumë se katër dekada.

Libri i Arshi Pipës asht një vepër e një natyre tjetër, e cila shqyrton tiparet shqetësuese kulturore të historisë së Shqipnisë, imponimin e një idiome artificiale standardizuese mbi gjuhën shqipe, e cila ka dy dialekte: verior (gegënishtja) dhe jugor (toskërishtja).

Përgjatë dy periudhave të luftave të mëdhaja europiane të dy dialektet, ndryshimet e të cilëve janë ma shumë strukturore sesa leksikore, kanë gjallue krejt mirë krahpërkrah përmes një shpirti me tolerancë të jashtëzakonshme dhe kuptim të ndërsjellët. Kjo u pat temelue mbi vendimin e mbërritun në konferencën e studiuesve në 1917-18, kur u ra dakord me miratue idiomën e gegënishtes jugore të Elbasanit (një qytet në Shqipninë qendrore), me synimin që të dy dialektet kishin me u përpajtue nëpërmjet një zhvillimi të natyrshëm. Ndonëse asnjë njisim në kuptimin e vërtetë të termit nuk u ba, gjithsesi një marrëveshje e mirë u ba për me afrue të dy dialektet mes vedit: një akt i mbërritun me tolerancë

dhe me takt të madh. Disa prej prozatorëve, poetëve, studiuesve dhe fletorarve ndihmuen në këtë proces tue ba një studim të plotë të dy dialekteve, tue marrë ûha prej njeni tjetrit, dhe tue lëmue butas përmbi dallimet e panevojshme.

Kjo marrëveshje u zhbâ kur partia komuniste muer pushtetin. Meqë shumica e drejtuesve të saj vinin prej jugut, dialekti toskë u ba gjuha zyrtare e partisë dhe e shtetit. Kjo kadalë u përhap ndër libra, të përkohshme dhe ndër botime të tjera; autorët veriorë pushuen së shkruemi në gjuhën e tyne letrare. Ethja për me sjellë një “njisim” artificial të gjuhës u kundërshtue pre Aleksandër Xhuvanit dhe Eqrem Çabejt, dy gjuhtarët ma kryesorë të vendit. Por ata u vûnë përfund. Ethja kaloi përmes disa stadeve tue përfshî ndryshimet në orthografi. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980 mishnon trajtën e fundit e gjuhës së re zyrtare, “gjuha e njësuar letrare”. Kryeredaktori i tij Androkli Kostallari asht një gjuhëtar komunist, i cili e ka drejtue procesin e punës qysh në fillim krejt.

Pipa paraqet të dhana të gjana dokumentare të cilat tregojnë se kjo nisjativë e përçudtë ishte një veprim i kulturës politike, përcaktue prej nënshtrimit të Shqipnisë veriore prej komunistave fundamentalistë prej zonës jugore të vendit. Prej një kahshikimi tjetër, Shqipnia veriore ka pasë do cilësi të papranueshme. Ajo pat shfaqë kundërshti të fortë kundër qeverisjes së stabilishtetit komunist mbas Luftës së Dytë Botënore. Ajo pat pasë një popullatë të madhe katolike, e cila u ba shënjestra kryesore e kulmimit të persekutimit fetar gjatë ndalimit të tana praktikave fetare në 1967. Ipeshkvijtë katolikë dhe priftat ishin auktorët e librave të parë shqip, botue ndërmjet shekujve gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë.

Disa prej poetëve the shkrimtarëve ma të mirë përdorën dialektin gegë ose një trajtë të modifikueme të tij. Një prej humbjeve ma të randa në letërsinë dhe kulturën shqipe ka kënë ndalimi dhe zhdukja e veprës së Atit Franciskan Gjergj Fishta (1871-1940), poet epik,

satirik, religioz dhe lirik me fuqi të madhe, përpos se mësues dhe botues. Kjo asht pothuajse njëjloj si me zhdukë veprat e John Milton-it dhe të Jonatahn Swift-it prej historisë së letërsisë angleze. Nji tjetër shkrimtar verior që pat fatin e njëjtë asht Ernest Koliqi (1903-1975), nji tregimtar i shkëlqyeshëm dhe poet, përkthyes i poezisë italiane dhe botues.

Po ta krahasojmë Shqipninë me vendet e tjera të Europës Lindore e Qendrore, i bjen që ajo pësue dy herash goditje në fushën e gjuhës dhe të letërsisë. Përveç sajimit të idiomës stramastike, ka ndodhë po ashtu edhe përdhosja ideologjike, buhatja dhe rrëna e tejkalimit të zhargonit të cilat i kanë mundue tana gjuhët e Europës Lindore giatë katërdhetë vjetëve të maparshme. Rezultati përfundimtar kje nji vorfnim i madh letrar e kulturor. Askëkund tjetër ky vorfnim nuk ka kënë ma i madh sesa në Shqipni. Václav Havel-i, dramaturgu çek dhe tash Presidenti i Çekosllovakisë, e ka zbirilue këtë send të përbindshëm të shekullit njëzetë në dramën e tij *The Memorandum* (1966). Nji gjuhë e re artificiale e quejtun *Ptydepe* u paraqit në nji organizatë të madhe pa dijeninë e drejtorit të saj, i cili asht nji mbështetës i ethshëm i gjuhës së natyrshme të vendit. Njeriu mbas skemës së çuditshme asht nëndrejtori i cili pohon se i ka masat mbas vedit. Nji mbështetës prijatar i *Ptydepe*-s thotë se ajo asht “nji gjuhë synthetike e ndërtueme mbi baza shkencore”. Drejtori, në anën tjetër, beson se nëse ti hjekë prej njeriut “gjuhën e tij njerëzore, krijue prej traditës së vjetër shekullore të kulturës kombtare, ne kemi me e parandalue atë me kënë tanësisht njerëzor dhe me zhytë direkt në rrezikun e vetëtjetërsimit”.

Gjithsesi, shefi tevona i nënshtrohet presionit të madh zyrtar dhe e mbështetë idiomën e re, me rezultate shkatërruese. Nji vërshim i pakuptueshëm shushurimash shpërhapet shpejtas në mbarë organizatën, tue e ba të pamujtun komunikimin e anëtarëve të saj me njeni tjetrin në asì tymnaje semantike. Në fund, fushata e gjuhës së re deklarohet si dështim “i nji përpjekje” thellësisht të

damshme, për me vendue komunikimin e punës mbi temele të pështjellueme, joreale dhe jonjerëzore”.

Kur tirania komuniste ma në fund u përmbys, një ndër problemet e shumta të jashtëzakonshme që Shqipnia e librueme ka me ndeshë, ka me kënë gjetja e rrugëve dhe e kuptimeve në rikthimin te toleranca e vjetër dhe evolucioni i natyrshëm i dy dialekteve drejt një giuhe të përbashkët, të mirëfilltë letrare.

Për një nisjativë aq të vështirë kurrfarë udhëzuesit ma i mirë sesa vepra studimore e Pipës s’mundet me kënë. Kualifikimet e tij janë krejt të veçanta. Ai kje për dhetë vjet i burgosun politik nëpër burgje të ndryshme shqiptare dhe kampe pune. Mbas lirimit të tij ai emigroi në Shtetet e Bashkueme ku botoi një vëllim me poezi, *Libri i burgut* (1959),⁹³ i cili asht një dishmë ngashëruese dhe përcëlluese e vuetjes së madhe njerëzore dhe e degradimit. Pipa ka botue edhe dy libra të tjerë me poezi, gjithashtu ndër vepra të tjera edhe studimin trevëllimësh të letërsisë shqipe dhe të folklorit (*Trilogia Albanica*, 1978).

Ai asht po ashtu një shkollor i shkëlqyem i italishtes, dhe ka kënë profesor i letërsisë italiane në disa universitete amerikane. Vepra kryesore e tij në këtë fushë asht *Montale and Dante* (1968); ai njëkohësisht ka kontribue me punime mbi poezinë italiane nëpër revistat e njohuna amerikane, italiane dhe franceze.

Unë besoj se Shqipnia ka me kënë njëmend e lirë kur popullsia e saj ka me kënë e aftë me lexue, studiue e vlerësue veprat e shkrimtarëve me cilësi të naltë si Arshi Pipa.

Përktheu nga anglishtja: Lisandri Kola
Marrë nga: Albanica 1, 129-31

⁹³ Ndeshet edhe në punime të tjera të A. Logorecit, që vendndodhja e Pipës (Amerikë, 1959) merret si referencë për botimin e poezive të A.P., *Libri i burgut*, ndërkohë që dihet se ky libër asht botue në Romë [editio princeps], me kontributin financiar të diasporës shqiptare në Amerikë. Shën. im. L.K.

Arshi Pipa. *Rusha*. München. Logos, 1968, 75 ff.

Arshi Pipa, asht një autor shqiptar i cili i kaloi dhjetë vjet në burgje e kampe të ndryshme pune në vendlindjen e tij mbas Luftës II Botërore. Kur ai u lirue para do vjetëve, ai emigroi në Shtetet e Bashkueme ku botoi një vëllim të çmueshëm me poezi, shumica sosh konceptue, sikurse edhe shkruar, në kushte të tmerrshme. Përpos cilësisë së tij të naltë letrare, vëllimi kje po ashtu dëshmi përcëlluese e aftësisë së mrekullueshme të artistit për me kapërcye bjerren dhe vuetjen njerëzore në format e tyne ma të skajshme.

Jashta të njëjtit ferr, Pipa tash vjen me një vepër disi befasuese: një rrëfje dashnie të zjerrtë dhe hakmarrjet mes shqiptarëve dhe serbëve përgjatë gjysës së sytë të shekullit katërmëdhjetë. *Rusha* asht emni i Zhuljetës shqiptare që bjen në dashni, dhe fejohe në msheftësi, me një Romeo serb quejtë Melisdrav. Në poemën e tij epike, Pipa shpalosë historinë tejet të ndërlikue të dashnisë së tyne dhe të shumë intrigave fisnore, si edhe të rivaliteteve që burojnë sosh, e mandej kulmojnë në dekën e dy dashnorëve të rij. Ai ka ndërthurë në mbrendi, mjeshterisht dhe pashmangtas, një informacion të pasun mbi doket shoqërore dhe mënyrën e të sjellunit të asaj periudhe. Poezia, e cila asht dukshëm e thjeshtë dhe e kthjelltë në tonalitet, zëritet me një ndiesi kontrolli pothuajse rasiniane. Gjuha e kësaj rrëfje të çuditshme, asht arkaike me vetëdije dhe për pasojë diqysh e vjetrueme prej përdorimit modern shqip. Në tanësi, *Rusha* asht një mbërritje e pazakontë e krijimit letrar sikurse edhe e përfytyrimit historik.

Marrë nga: Books Abroad, Vol. 43, No. 4 (Autumn, 1969), 641.

Arshi Pipa. *Meridiana*. München. Logos, 1969, 69 ff.

Arshi Pipa, një autor shqiptar që tash jeton në Shtetet e Bashkueme, asht ma së shumti i njohun për *Librin e burgut* të tij, një përmbledhje poezish që u përbluen, dhe në do raste u shkruen, giatë një periudhe të madhe të burgosjes politike në vendin e tij të lindjes mbas Luftës së Dytë Botënore.

Kjo përmbledhje e shkurtë përfshin disa prej punimeve të tij të mahershme: poezi të kohës së studimeve të tij, shkruar ndërmjet mesit të tridhetës deri në fillimin e katërdhetës. Shumë prej tyre janë pandamas romantike, si në ndiesi si në gjuhë, të cilat shemblesht me poezinë italiane të shekullit nandëmbëdhjetë, sidomos me atë të Leopardi-t. Ndërkohë ata bartin do prej gjurmëve të zhvillimit të tij të mavonshëm: një aftësi e shqueme e një gjuhe të vështirë dhe të rrjedhshme; familjarizim si me poezinë klasike si me atë moderne të Europës, sikurse edhe me traditën e lashtë gojore të vendit të vet—edhe pse e butë nuk shfaqë farë melankolie.

Vëllimi i ri i Pipës, gjithashtu përfshin disi ndamje të çuditshme: një varg poezish rë rishikueme prej librit të tij *Libri i burgut*, i cili kje botue ma shumë se para dhetë vjetësh. Piknisht në këtë vepër ai gjeti zanin e tij të njëmendtë si poet, kur shkroi rreth shtypjes dhe bjerres njerëzore me pamësi, veçim, dhe qindresë të léme në rajonet e mistershme që shtrihen përtej të mirës dhe të keqes. Do prej këtyne poezive të randësishme janë ndryshue sall përkitazi, vetëm se tkurrë dhe ba ma të thukëta. Të tjera, në krahun tjetër, kanë pësue ndryshime ma rrajësore. Pak janë shkurtue ose përndryshe ndryshue aq me temel sa me u krijue poezi të reja në tanësi. Në disa raste ai ka përzgjedhë njado strofa prej poezive të hershme, i ka modifikue ato stilistikisht, dhe botue në nën një titull të ri.

Në do raste kur poetët rreken me rishikue punimet e veta ndodhë që rezultati nuk asht aq i kënaqshëm, por në rastin e Pipës ky proces hedhë një dritë interesante në

krijimin dhe zejen letrare. Çfarë fatëkeqsie asht kjo, që për shkak të mostolerimit politik të kohëve tona, një za artisti me asnjë cilësi nuk mund të ndigjohet prej shumicës së bashkëkombasve të vet.

Marrë nga: Books Abroad, Vol. 45, No. 3 (Summer, 1971), 556.

I përkthyer nga anglishtja: Lisandri Kola

KEN'S

PIKËPAMJET E PROF. ARSHI PIPËS PËR
SHQIPEN STANDARD⁹⁴

Pikëpamjet e veta për gjuhën letrare shqipe të njësuar (përkat. shqipen standard) prof. Pipa i ka shpalosur së pari në artikullin me titull “*Mbi t’ashtuqejtunën ‘gjuhë të njësuar’*”, botuar në revistën “Koha jonë”, që dilte në atë kohë jashtë Shqipërie.⁹⁵ Tre vjet më vonë, më 1989, këto pikëpamje ai do t’i shtjellojë gjerësisht në monografinë që mban titullin *Politika gjuhësore në Shqipërinë Socialiste*,⁹⁶ shkruar në anglisht dhe botuar në SHBA.

Në nëntor të vitit 1992, prof. Pipa do të botojë në revistën *Albanica* një letër drejtuar z. Luan Omari në përgjigje të një ftese të bërë prej këtij të fundit, për pjesëmarrjen në konferencën përkujtimore të 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit.⁹⁷ Në këtë letër ndërmjet të tjerash shkruhet: “*Në pamundësinë e pranisë sime në konferencën tuej, ju dorëzohet kumtesa ime shkruar frëngjisht dhe përkthye shqip. Kjo letër shkoqitë ca gjâna që çekën në kumtesën si edhe nxjerr disa përfundime*”.⁹⁸

⁹⁴ *Kumtesë*, mbajtur në Konferencën Shkencore me temë “*Arshi Pipa dhe vepra e tij*”, organizuar nga Bashkia Shkodër, Muzeu Historik dhe Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër, më 30 shtator 2005.

⁹⁵ *Koha jonë*, 15, 11-12-13, 19-34 (viti 1986). Ky shkrim ngjan të jetë ribotuar me të njëjtin titull në revistën shkodrane *Phoenix*, nr. 5-6, 1999, 354 v.

⁹⁶ *The politics of Language in Socialist Albania*, East European Monographs no. 271, Boulder, Colorado. Distributed by Columbia University Press, 1989.

⁹⁷ *Albanica*, nr. 3-4, 1992, 123 v.

⁹⁸ Po aty, 123-124.

Po në këtë numër të kësaj reviste, prof. Pipa do të botojë një artikull me titull “*Gjeopolitika e gjuhës shqipe: Dheli i “gjuhës së njësuar”*”,⁹⁹ shkruar në frëngjisht, në të cilin zgjeron dhe thellon më tej pikëpamjet e veta për *shqipen standard*.

Në vazhdim, në përgjigjen që i jep artikullit kritik të Petër Priftit (ribotuar po në këtë revistë¹⁰⁰), prof. Pipa do t’u përmbahet pikë për pikë, pa luajtur vendit aspak, pikëpamjeve të veta të shprehura në shkrimet e mëparme.¹⁰¹

Në tetor të vitit 1993 prof. Pipa i shkruan një letër prof. Bahri Becit në përgjigje të ftesës së këtij të fundit për të marrë pjesë në konsultën shkencore të 8 tetorit për “Drejtimet kryesore të studimeve në fushën e gjuhës shqipe”. Edhe në këtë letër,¹⁰² prof. Pipa ripërsërit shkurt e qartë pikëpamjet e veta për gjuhën standard.

Mendimet e veta për shqipen standard prof. Pipa i ka shpalosur edhe ndër shkrime të tjera të karakterit divulgativ, ndër intervista të botuara në gazetatat e asaj kohe, ndër tubime shkencore etj., të cilat ne nuk i kemi rreshtuar këtu, sepse nuk sjellin ndonjë gjë të re.

Pikëpamjet për shqipen standard vetë prof. Pipa i ka përmbledhur mirë e bukur në artikullin *Gjeopolitika e gjuhës shqipe: Dheli i “gjuhës së njësuar”*. Aty ai shkruan:

E ashtuqejtuna ‘gjuhë e njësuar’ është një fenomen kolonizimi gjuhësor krahinor i bëmë me dhunë e me dhel. Dhuna dhe dheli kanë vulën staliniane.

⁹⁹ *Géopolitique de la langue albanaise: la fraude de l’ULLA*, po aty, 129 v.

¹⁰⁰ Peter P. Prifti, *A commentary on prof. Pipa’s critique of unified literary Albanian*, “*Albanica*”, nr. 3-4, 1992, 153 v.

¹⁰¹ *Koment nga Prifti mbi kritikën e prof. Pipës ndaj shqipes letrare të njësueme dhe përgjigje nga Pipa*, “*Albanica*”, nr. 3-4, 1992, 163 v.

¹⁰² Letra është botuar në revistën “*Hylli i dritës*”, nr. 4, Tiranë, 1993, 128 v.

Gjuha shqipe është folë dhe shkruar në dy dialekte kryesore, në gegënishten në Veri dhe në toskërishten në Jugë. Gegënishtja ka traditë shkrimi më të vjetër dhe është lavruar prej shqiptarësh dheas (autokthonë), kurse toskërishtja është lavruar më vonë, dhe prej shqiptarësh të diasporës në Italinë e Jugut dhe në Greqi. Grindje për çështjen e gjuhës nuk ka pasë; secili, gegë ose toskë, ka shkruar në letrarishten e vet. Me pushtimin e Shqipërisë nga komunizmi, toskërishtja u shpall gjuhë zyrtare. Por çka e ngrejti toskërishten në nivelin e gjuhës kombëtare që një librec i Stalinit, *Marksizmi dhe linguistika* (1956), në të cilin Stalini hodhi poshtë një teori të linguistit gjeorgjian N. Marr, simbas së cilës, kur dy gjuhë përzihen, gjuha humbëse çvlerësohet në dialekt. Simbas Stalinit, kur dy gjuhë përzihen, njëna fiton dhe tjetra humbet. Gjuha fituese ruan strukturën gramatikore dhe stokun themelor të fjalorit të vet, por pasunohet me fjalorin e gjuhës humbëse, e cila zvetënohet pak nga pak dhe shuhet. Këtë teori të Stalinit udhëheqësit toskë ia zbatuan gjuhës shqipe, si t'ishte kjo jo një gjuhë bidialektore, por si një përzierje dy gjuhësh të ndryshme, me toskërishten si gjuha fituese dhe me gegënishten si gjuha humbëse. U veprue kështu me gegënishten si t'ishte kjo një gjuhë e huej, gjuha e një populli të mundun në luftë - në fakt Gegënia u pushtue nga ushtëri partizane të përbërë dhe të komandueme në shumicën dërmuese nga toskë. Imponimi i toskërishtes si gjuhë kombëtare që pjesë e terrorit komunist mbi popullsinë gege nëpërmjet burgimesh, internimesh, pushkatimesh - mjaft me përmendë si shembull asgjatimin e klerit katolik shkodran.

Në vitin 1972 një kongres gjuhëtarësh mbledhun në Tiranë shpalli krijimin e “gjuhës së njësuar”, mbas një fushate së gjatë të bërë nën parullën “një komb, një gjuhë”. Parulla

tingëllon bukur dhe, në dukje, sjellë bashkim kombëtar. Por në të vërtetë ajo përçan kombin mbasi detyron gegën e shtypun me folë e me shkruar në gjuhën e shtypësit. Shtetasit kështu ndahen në dy kategori: n'ata që janë n'anën e ngadhnjyesit dhe n'ata që përbëjnë kategorinë e humbësve, diskriminimi i klasës kthehet në diskriminim gjuhësor. Nën maskën e drejtshkrimit të shqipes, Kongresi i 1972-së skenizoi funeralin e gegënishtes letrare tue ligjorue në të njëjtën kohë plaçkitjen e leksikut të gegënishtes, pikërisht si “theorizue” nga Stalini. Dheli satanik në këtë mes që me quejtë njësim çka në fakt është nënshtrim; ky njësim i ngjet atij kalorësi kúr nget kalin. Që fjala njësim të kishte kuptim, duhej që një pjesë e mirë e strukturës së gegënishtes të trupëzohej në “gjuhën e njësuar”. Disa struktura të gegënishtes u futën në të, por edhe kjo u bë aty kú mungojshin strukturat e toskërishtes dhe jo më shumë se 5 për qind. Simbas recetës së Stalinit, toskërishtja rrejti strukturën e vet gramatikore 95 për qind. Roli i gegënishtes u kufizue në të majmit e toskërishtes me fjalorin e toskizuem të gegënishtes dhe në zbukurimin e fëtyrës së toskërishtes me dhambët e zhgulun prej kufomës së gegënishtes.

E frymëzueme prej Stalinit, e imponueme prej besnikut të tij, Enver Hoxhës, dhe e fabrikueme në një* periudhë tre pësëvjeçarësh nga një klikë marriste e kryesueme prej Androkli Kostallarit, për të cilën shqipja e vërtetë, dmth. toskërishtja rrjedhë nga thrakishtja (në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të Kostallarit as që përmendet teoria e vazhdimësisë iliro-shqiptare), “gjuha e njësuar” është një dështim kolosal. Ajo mund

* Inkonsekuencë (autoriale) e tekstit fillestar në *Albanica*, 3-4, 152. Shën. red.

të përdoret si mjet komunikimi, por vlera e sáj
shkencore është më se e dyshimtë.¹⁰³

Këto janë pikëpamjet e prof. Pipës për shqipen
standard. Dhe pikëpamjet zakonisht i vlerëson ose i
zhvlerëson koha.

*

* *

Dihet tashmë që *veprimin* gjithnjë e shoqëron
kundërveprimi. Kështu ndodhi edhe me pikëpamjet e prof.
Pipës për shqipen standard. Kundërveprimi që i
dyanshëm: së pari politik e më pastaj shkencor. Kjo ishte
e pritshme. Arshi Pipa i përkiste atij brezi të artë
intelektualësh të rinj me një përgatitje të gjithanshme
shkencore dhe me një drejtim të qartë perëndimor. Si i
tillë do të rreshtohet në ballë të lëvizjes antikomuniste. Ai
u formua dhe mbeti tërë jetën antikomunist i vendosur.
Krejt brezi i tij, duke paraqitur rrezik kryesor për
komunizmin, u shkallmua në mënyrë mizore; një pjesë u
pushkatuan me gjyq e pa gjyq, pjesa tjetër u burgos. Prof.
Pipa, pasi bëri vitet e burgut, u arratis dhe përfundoi në
SHBA.

Shkëndijat për të ndezur zjarrin e polemikave nuk
vonuan. Prof. Pipa sapo erdhi në Shqipëri në vitet e para
të demokracisë, deklaroi që ishte për dënimin e
udhëheqësve të komunizmit në Shqipëri. Në letrën që i
dërgonte B. Becit, ai shkruante: “*Enver Hoxha dhe Androkli
Kostallari kanë vdeke dhe nuk mund të qiten para gjyqit. Por
Ramiz Alia është gjallë dhe (tekembramja!) në burg. Alia nuk
është vetëm pasardhësi i Enver Hoxhës në krye të shtetit-Parti. Aj
ka qenë Ministër i Arsimit në 1957, kur zu të botohej “Nëndori”.
Si i tillë ai ka përgjegjësinë edhe për veprimet e Institutit të
Gjuhësisë, kthye në një agjenturë të diktaturës enveriane. Si
drejtor i sotëm i këtij instituti është mbrenda kompetencës suaj që*

¹⁰³ *Géopolitique ...*, po aty, 151 v.

të ndërhyjni pranë prokurorisë së shtetit që Alia të merret në pyetje për sa më sipër.”¹⁰⁴

Polemikën me A. Pipën e nisi së pari Xh. Lloshi. Ai botoi në revistën socialiste “Sot” artikullin me titull *Kultura shqiptare përpara shqetësimeve të reja*.¹⁰⁵ Artikulli kishte diçka të vërtetë, prof. Pipa po i sillte *shqetësime* socialistëve.

Në Konferencën “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, që u mbajt në Tiranë në nëntor të vitit 1992, u lexua edhe kumtesa e prof. Pipës. Reagimet qenë të menjëhershme. Kryesonin gjuhëtarët kosovarë, të cilëve nuk u pritej që të dilnin kundër tij.

Në referatin e mbajtur në Konferencën shkencore jubilarë me rastin e 25-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, organizuar në Tiranë më 12 dhjetor 1997, shkruhej: *“Edhe pohimi se gjuha e sotme letrare qenka 95 për qind toskërisht dhe vetëm 5 për qind gegërisht është i pathemeltë, se kështu toskërishtja dhe gegërishtja dalin si gjuhë të veçanta e jo si dy dialekte të së njëjtës gjuhë ...”*¹⁰⁶ Pipa paraqitej si përçarës i kombit. Shfrytëzohet këtu mungesa e njësimit të termave. Pipa me *dy gjuhë* zakonisht shënon *dy dialektet* kryesore të shqipes, gegërishten dhe toskërishten.

Në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, që u mbajt në Tiranë në nëntor 2002 me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, dëshira e A. Pipës për gjallimin edhe në të ardhmen të dy dialekteve të shqipes, do të paraqitej tejet regresive dhe kundër rrymës së përgjithshme të kohës.¹⁰⁷ A. Pipa shprehej kështu: *“Nuk mund ta dij a mund të ketë një evolucion të dy dialekteve kah një synkrazë e*

¹⁰⁴ *Hylli i dritës*, nr. 4, Tiranë, 1993, 135 v.

¹⁰⁵ *Sot*, nr. 5-6, 1991, 21 v.

¹⁰⁶ Idriz Ajeti, Emil Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrime në të ardhmen)*, “Studime filologjike”, nr. 1-2, 1998, 10 v.

¹⁰⁷ Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, “Studime filologjike”, nr. 3-4, 2002, 10.

ardhëshme. Po kjo perspektivë e mundëshme nuk do të më gëzonte fort. Unë kundroj me sympathy një gjendje, si kjo e sotmja, kur një Shqipni e vogël – shembull fort i rrallë n'Europë – është e zonja me u shprehë në dy gjuhë letrare. Ky është një shenjë pasunie kulture që na shquen, cilido qoftë shkaku i tij".¹⁰⁸

Polemikat ndërmjet prof. Pipës dhe ithtarëve të Kongresit të Drejtshkrimit ishin të pritshme dhe krejt normale. E keqja ishte politizimi i tejskajshëm i tyre. U harrua krejtësisht një thënie e grekëve të vjetër që *e vërteta del nëpërmjet diskutimit*. Polemizuesit sikur nuk kishin durim të dëgjonin deri në fund njëri-tjetrit, të njiheshin mirë me pikëpamjet e njëri-tjetrit duke i shoshitur ato, e pastaj të nisin diskutimin. Kryesisht ithtarët e Kongresit të Drejtshkrimit nuk e pranonin debatin shkencor.¹⁰⁹

Në revistën "Studime filologjike" (nr. 1-2, 2003) lexuam me kënaqësi një shkrim të prof. Rexhep Ismajlit me titull *Rreth shqipes standarde, kodeve të tjera dhe kontestimeve*. Mirëpo, mbetem tejet të habitur kur lexuam sa më poshtë: "*Jehona e vërejtjeve të Pipës në Kosovë ka arritur drejtpërsëdrejti, në fillim përmes kritikave, më vonë përmes përkrahësve të ideve të tij në Tiranë, por me shpesh e përthyer përmes kontestimeve të grupit të Shkodrës, ose të tjerëve më vonë. Sa kam parë libri në terësi është lexuar shumë pak, ndërsa diskutimet janë bërë kryesisht në bazë të komentimeve të të tjerëve, kështu që jo gjithëherë janë hetuar të gjitha pasojat e idesë së tij për dy gjuhë letrare*".

Për fat të keq prof. Ismajli ishte krejtësisht i painformuar. Ai nuk njohte as zhvillimin e ngjarjeve këtu në Shqipëri e as literaturën e plotë, shkruar gjatë këtyre

¹⁰⁸ A. Pipa, *Mbi t'ashtuqejtunën "gjuhë të njësuar", "Phoenix"*, nr. 5-6, Shkodër, 1999, 372.

¹⁰⁹ D. Luka, *Përse ithtarët e Kongresit të Drejtshkrimit nuk e pranojnë debatin shkencor?*, Referat i mbajtur në Simpoziumin "Martin Camaj. Tradita dhe bashkohësia" (mbajtur në Shkodër më 24 qershor, 1993) dhe botuar në vëllimin me të njëjtin titull, Shkodër, 1994, 28 v.

viteve. Mbështetëj vetëm në literaturën zyrtare, e cila paraqiste vetëm pikëpamjet e njërës palë.

Duke qenë pjesëmarrës në të tëra tubimet e kryera për këtë qëllim, duke qenë njëkohësisht nismëtari i tubimit të gjuhëtarëve shkodranë të vitit 1992 si edhe hartuesi i *Deklaratës* së gjuhëtarëve të Shkodrës, mund t'i them prof. Ismajlit se nuk ka pasur asnjë *grup të Shkodrës*. Prof. Pipa ka qenë vetëm i ftuar në këtë tubim si të gjithë të tjerët; ndërmjet tyre edhe tre gjuhëtarë të Institutit të Gjuhësisë, si edhe pedagogët e Universitetit të Shkodrës (me përkatësi të ndryshme partiake). Tubimin e kam drejtuar unë vetë dhe prof. Pipa ka folur vetëm si pjesëmarrës, duke respektuar kohën që kishte në dispozicion. Gjithashtu ai ka nënshkruar *Deklaratën* e dalë prej këtij tubimi njëloj si të tjerët.

Prof. Ismajli do të bënte mirë t'i risillej edhe një herë këtij problemi, për të mos e akuzuar në të ardhmen si anakronik. Ndërkaq, duke ndjekur një këshillë të vlefshme të tij,¹¹⁰ unë do t'i rekomandoj literaturën e nevojshme, të cilën ai nuk e përmend gjëkund. Nuk bëhet fjalë këtu për interpretime, po për historinë e zhvillimit të ngjarjeve.¹¹¹ Historia ndërtohet me fakte e dokumente, aq më tepër kur këto ngjarje i përkasin dhjetë-pesëmbëdhjetë viteve të fundit.

Praktikat e sotme të përjashtimit të mendimit alternativ do të sjellin në të ardhmen vetëm pështjellim. E kjo do të jetë në dëm të kulturës kombëtare shqiptare.

Marrë nga: David Luka, *Studime gjuhësore IX* (Përmbledhje shkrimesh), [Shkodër] 2006.

¹¹⁰ Unë mendoj se gjëja e parë që do bërë me qëllim të pasurimit të shqipes është së pari të dëgjojmë mirë njëri-tjetrin ...", gazeta "Java", Prishtinë, 1 kallnor, 2002, 26.

¹¹¹ D. Luka, *Studime gjuhësore VII*, Shkodër, 2001, 11-43. *Studime gjuhësore VIII*, Shkodër, 2003, 7-59.

ARSHI PIPA

HUMANISTË ARBËRESHË

Jo pa arsye shqiptarët e përлавdojnë epokën e heroit të tyre kombtar, Skanderbegut. Ajo epokë nuk pau veç lulëzimin e një vetëdije' embrionale, kombtare që përshënjonte figurën e heroit—një soj mbreti i konoruem prej mbretnisë ende të pabashkueme të Shqipnisë—por dëshmoi edhe lindjen e një kulture shqipe, të përfaqsueme prej një grup intelektualësh shqiptarë. Mund të flitet për një humanizëm shqiptar, lulue në shekullin e pesëmbëdhjetë dhe vijue në gjysën e parë të shek. gjashtëmbëdhjetë, e që ndërton pararendjen historike të letërsisë shqipe të shekujve të mavonë.

Që me e saktësue, humanizmi shqiptar asht i markës italiane, venete. Serenissima¹¹² asht, në periudhën rilindase, fuqia italiane që sundon dy detnat, Adriatikun dhe Jonin, brigjet e të cilëve shtrijnë sundimin e tyre prej Dalmacisë deri në portet e Egjeut. Ajo¹¹³ kërkon me e ndalë ekspansionin otoman në Mesdhë dhe mbas pushtimit turk të gadishullit ballkanik, vazhdon me ia kontestue pushtuesve. Kur në 1396, nën presionin turk, princi i Shkodrës, Gjergj Balsha, ua dorëzoi qytetin

^{112*} Republika Venete [apo e Venedikut], e njohun tradicionalisht me këtë apellativ. Numrat rëndorë në nënvijë, të cilët pasohen nga një yllth (*), ose kllapat gjarpnueshe janë të përkthyesit. Emnat e latinizuem të humanistëve shqiptarë që gjenden në tekst, dhe janë lanë prej Pipës të tillë, këtu janë paraqitë në versionin e shqipnuem mbas herës së parë të përshëjnimit të latinizuem.

^{113*} Pra Serenissima.

republikës adriatikase {venedikasve}, Shqipnia veriore ban pjesë në rrethin venedikas tue qëndrue deri në ramjen e Shkodrës në 1497. Tetëdhjetë vjet nën sundimin venedikas nuk kishin si mos me lanë gjurmë ndër shkodranë apo zonat përreth. Eksodi i shkodranëve prej qytetit mbas pushtimit turk, krijoi kushtet për botimet e para nga ana e intelektualëve shkodranë, Marinus Barletius {Marin Barleti} dhe Marinus Becichemus¹¹⁴ {Marin Beçikemi}.

Humanisti i parë shqiptar Joannes Gazulius (Gjon Gazulli), u vendue në rrethin e kësaj kulture shqiptaro-venedikase. I mbiquejtun Ragusius ngaqë kishte lé në Raguzë (sot Dubrovniku) dhe ishte qytetar i këtij qyteti dalmat i cili qe, në bregdetin adriatik, ai që pësoi ma së forti ndikime të rilindjes italiane, Gazulli duhet të ketë lé kah fillimet e shek. pesëmbëdhjetë; bir i një familje tregtarësh, me prejardhje prej Mirdite,¹¹⁵ rajon malor në juglindje të Shkodrës. Duket se familja ma heret asht vendue në Durrës, porti ma i madh shqiptar, atëherë nën sundimin e venedikasve. Lidhjet tregtare mes Raguzës dhe Durrësit ishin zhvillue me kohë dhe shumë shqiptarë prej Shkodre jetonin në Raguzë.

¹¹⁴ Beçikemi flet për ma shumë se dymijë vetë: "*Scodrenses sic facti extorres Venetias venimus septigenti viri milie; et trecenti pueri, trecintique mulieres*". Marinus Becichemus, *Panegyricus Serenissimo Principi Leonardo Lauretano et illustrissimi Senatui Veneto*. Brescia: Stampe di Angelo Brittanico, kund 1504, 21.

¹¹⁵ Shih Florio Banfi, "*Mâ i moçmi humanist shqiptâr: Joannes Gazulius*" {*Mâ i moçmi humanist shqiptâr: Joannes Gazulus*, sh. XV.}, LEKA (Shkodër), 11.1-2 (1939), shënim i redaktorit [Zef (Giuseppe) Valentini], 19. {N. e R. (*Notë e Redaksís*) e këtij numri të LEKËS, Pipa e referon si shënim, sqarim të G.V. Në 1939, 11/1-2 simbas frontespicit të revistës, Drejtuer përgjegjës asht Dr. Zef Pashko Saraçi dhe drejtimi nga bordi i LEKËS, ndërsa Valentini asht kryeredaktor i saj në vj. 1943. Teksti i Banfi-t, përkthye në shqip, pa identifikim të kujt, ka dy ylltha redaksionalë-sqarues [17, 19] ndër 41 fusnota mes 17-30.}

Gjoni i kreu mësimet e para në qytetin e lindjes, tue u drejtue kah karriera ekleziastike. Si u shugurue prift shkoi në Padovë, ku u regjistruet në fakultetin e matematikës. U diplomue në 1430.¹¹⁶ Dy vjet ma vonë e gjejmë nunc të Raguzës pranë mbretit të Hungarisë, perandorit Sigismund, për me i vû taksën qytetit nën protektoratin hungarez dhe për me e nxitë perandorin që me shtruet kërkesën e raguzanve pranë papës Eugenio IV, në lidhje me privilegjin për me lundruet nëpër ujrat e “të pafeve”. Prej 1439 deri në 1451, Gazulli asht përsëri në Padovë ku jep mësim matematikë dhe astrologji. Asht gjatë kësaj periudhe që ai merr famë si astrolog, tue ia njohë këtë, ndër të tjerë, edhe prej një astrologu të shquem të kohës, Joannis Müller, i thirrur Regiomontanus.¹¹⁷ Në 1451 asht ambasador i Raguzës pranë papës Nicola V në lidhje me miratimin e një privilegji.¹¹⁸ Prej letrës kredenciale rezulton se Gazulli i kishte kërkuet senatit raguzan për me ndërhyt edhe në favor të Skanderbegut, aleati i Raguzës kundër turqve.¹¹⁹ Dokumenti dëshmon se Gazulli, qytetar raguzan, ishte edhe patriot shqiptar. Vëllaznit e tij, Ndreu dhe Pali, rezultojnë si ambasadorë të Skanderbegut në Raguzë; i pari prej 1452 deri në 1459, dhe i dyti në

¹¹⁶ Banfi citon tekstin e kohës së provimit, ruejtë në Arkivin e Ipeshkvisë së Padovës; tekst i botuem nga Giovanni Brotto dhe Gaspare Zonta, *Acta gradum Academicorum Gymnasii Patavini*. Padova, 1922, 167: “31 Kallnduer 1430: *Examen et publica in art. mag. presbiteri Johannis q[uondam] Gini Gaxuli de Albania: ... Presentato coram nobis presbitero Johanne ad subeundum privatum examen... fecimus doctorem*”.

¹¹⁷ Banfi, 24.

¹¹⁸ Ibid.

¹¹⁹ “Ma non ottognendo essa bolle non possate parlar per el fatto di esso Schanderbeg”. Faksimile (me zor me u lexue) e pjesshme e letrës kredenciale, fotokopjue në Mikel Prenushi, *Kontribut shqiptar në Rilindjen europiane*. Tiranë: 8 Nëntori, 1981, 48. Bahet fjalë për vulën e miratimit papal. Letra kredenciale i lejonte Gazullit për me ndërhyt në favor të Skanderbegut vetëm nëse kishte me mbërritë me e përfitue privilegjin.

1462.¹²⁰ Suksesi i ambasadës ia shtoi reputacionin e shkencëtarit diplomat. Në 1459, Mattia Corvino, mbret i Hungarisë e ftoi në oborrin e tij për me i mundsue vijimin e kërkimeve të tij. Shkencëtari e shtyu dhe përfundoi tue mos shkue, ndoshta edhe për arsye shndetsore. Nuk dihet data e vdekjes së tij, ashtu siç nuk dihet as fati i veprës së tij, konsiderue e humbun. Ajo asht quejtë e papërfundueme në letrën, tejet për lavduese, të Janus Pannonius, humanistit të njohun hungarez, të cilit Gazulli i kishte dërgue një kopje.¹²¹ Regiomontanus, në të vërtetë e kritikon për “mangësitë e argumenteve që sjellin pështjellim”.¹²² “Ndoshta Gazulli ishte një prej atyne novatorëve të astronomisë që fillonin mandej me ecë përpara, prandaj tradicionalistit Regiomontanus i dukej e turbullt.”¹²³

Ai që e përuron rreshtin e veprave mbi jetën e Skanderbegut asht, simbas thanies së Giammaria Biemmi-t¹²⁴ (prift breshan i shek. tetëmbëdhjetë), një anonim shqiptar të cilin ai e quen Tivarasë, pra prej qytetit të Tivarit (sot Bar) prej ku vinte. Historiani italian e përshkruen dorëshkrimin si të vjetruem dhe të cinguem, mbi të cilin u mbështet për me shkruë veprën e tij mbi Skanderbegun: *Explicit Historia Scanderbegi, edita per quendam Albanensem, Venetiis, impresa industria atque impensa Erardi Radolt de Augusta anno domini 1480, die 2 mensis Aprilis ducante Joanne Macenygo inclyto Duce.*¹²⁵

¹²⁰ Banfi, 20.

¹²¹ “Conceptam dudum de vobis expectationem nostras rei ipsius experientia non modo facile implevit, verum etiam superavit”. Jani Pannoni, *Opusculorum Pars altera* (traiecti ad Rhenum, 1784, 101), cit. nga Banfi, 28.

¹²² Joannis de Montereio [Regiomontanus], *Tabulae Directionum*, 1475, citue nga Banfi.

¹²³ Shënim i redaktorit, Z. Valentini. {Përkthimi im, referue versionit italisht të Pipës.}

¹²⁴ Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioti detto Scander-Begh*. Brescia, 1742.

¹²⁵ Fan Noli, *George Castrioti Scanderbeg*. Neë York: International University Press, 1946, 77.

Vërtetësia e thames së Biemmi-t asht vû në dyshim prej historianëve autoritarë, të cilën mendojnë se bahet fjalë për një sajësë. Pall e quën “*un faussaire, pourrait-on dire, de profession*”.¹²⁶ Babinger nuk muji me gjetë gjurmë të botuesit të librit.¹²⁷ E meqë Biemmi thotë se Tivarasi e shkroi historinë tu u mbështetë mbi dëshmitë e të vëllait, zyrtar i Skanderbegut, Noli përbluen se Tivarasi mundet me qenë Pal Ejlli, me prejardhje prej Tivarit dhe kryepeshkëv i Durrësit, vëllai i të cilit kishte qenë zyrtar i Skanderbegut. Për me e konfirmue ai citon Pietro Luccari-n, i cili në të tijën *Annali di Ragusa* (Venezia, 1605) i ka vyejtë një *Storia di Scanderbeg*, shkruar prej kryepeshkëvit të Durrësit.¹²⁸

Ka munds i që Noli asht shty për me e pranue authenticitetin e Tivarasit, mbi të cilin paramendohet se mbështetet pjesërisht vepra e tij *George Castrioti Scanderbeg* (1947),¹²⁹ edhe për një arsye tjetër. Dihet se Pal Ejlli, mik e këshilltar i Skanderbegut, asht ai që ka shkruar me dorë të tij Formulën e pagëzimit, deri më tash i konsideruem si shkrimi ma i mëçëm shqip. Në letrën e tij baritore dërgue famullive të dioqezës së tij si shkak i një vizite të tij baritore, gjatë së cilës kishte konstatue praktika pagane ndër shqiptarët katolikë (martesa të dyta, konkubinazh etc.), kryepeshkëvi shkruen: “*Tum ob Turcarum olim tiranide, tum ob alia regionis incomoda quae eam dietius afficerunt et propterea corruptos mores inoculisse, decrevimus eam per nos visitandam, et maxime tempestate qua sub illustri domini Scanderbegh Albanie domino ecclesiastica dignitas*

¹²⁶ François Pall, “Une nouvelle histoire de Scanderbeg”, *Revue historique du Sud-Est européen*, 10-12 (1937), 6.

¹²⁷ Noli, 78.

¹²⁸ Ibid.

^{129*} Pipa, siç mund të vrehet, ka një lapsus në lidhje me vitin e veprës së Nolit (e cila asht njëherësh teza e tij doktrinale në Boston University, 1945) herë tue e shënue 1946 e herë 1947, ndërkohë që ky i fundit asht viti i saktë i botimit në NY.

libertate tuitque plurium gaudet".¹³⁰ Mbas kësaj, i shkruen priftave që me u mësue famullitarëve formulën e pagëzimit: "*Unte' pagheson premenit Atit et birit et spertit senit*", me të cilën ata duheshin me pagëzue të posalindunit para se me i çue në kishë, prej friket se mos vdesnin pa u pagëzue.

Humanisti shqiptar i cili e përhapi lavdinë e Skanderbegut nëpër botën e krishtenë (rreth dyqind përkthime, rimarrje e vepra letrare në pothuajse të gjitha gjuhët europiane, të rëndueme prej Petroviqit në studimin e tij bibliografik të 1881)¹³¹ asht Marin Barleti. Prej tij kemi tri vepra: *De obsidione Scodrensi* (Venezia, 1504), *Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis* (Roma, kund 1508), dhe *Compendium vitarum summorum pontificum... imperatorumque Romanorum* (Roma, 1555).¹³² Barleti, prift katolik, ishte shkodran, gja të cilën e ban të qartë ma shumë se një herë në veprat e tij: "Marin Barletii Sacerdotis Scodrensis" (përkushtia e *De obsidione*), "...ut de Scodra mea taceam" (*Historia*, 1.2, 35). Emni i ka ba do me mendue se ndoshta ishte pinjuell nga Barletta. Por emni tingëllon shqiptar, Barletius tue pasë trajtë latine të Bardheci (Bardhësi, Barlletsi). Nuk e dimë as kur leu e

¹³⁰ "Ma së parit sa i takon tiranisë së mahershme, e mandej fatkobeve të tjera prej të cilave ka vuejtë kahmot rajoni, tue shpalue kësodore zakone të bjerruna, vendosëm me e vizitue në një kohë tjetër, kur ma së forti ajo ka me fitue ma shumë liri dhe përkujdes ekleziastik nën sundimit e zotit të ndritshëm, Skanderbegut, zot i Shqipnisë". Ashburnham, 1167, 1. Firenze, Biblioteca Laurenziana.

¹³¹ Georges T. Pétrovitch, *Scanderbeg (Georges Castrioti). Essai de bibliographie raisonné*. Paris, 1881 {Ernest Leroux éditeur, 28, Rue Bonaparte, 28. M.D.CCC.LXXXI}. Studimi nuk përmban veprat mbi Skanderbegun në gjuhët sllave, që duhet të jenë të shumta, nëmose auktori ka nënkuptue për me u ba atyne një botim në vete.

¹³² Apostolo Zeno, që e i përmbyllë *Dissertationi Vossiane* të tij (Venezia, 1753, tomo 2) me një kapitull mbi Marin Barletin, flet krejt pak për jetën e tij.

as kur vdiq. Në librin VI të *Historia* kallëxon se muer pjesë në luftimet gjatë rrethimit të Shkodrës ndërmjet 1478-79. Mbas pushtimit turk të qytetit, emigroi në Venedik ku me gjasë ka jetue.

De obsidione Scodrensi pat shumë botime, përfshî përkthimet në gjuhë të ndryshme europiane. Por Barleti asht i njohun mbi të gjitha për historinë e tij të Skanderbegut. Vepra, posaçërisht e përkthyme, pat lexues të vazhdueshëm në shek. gjashtëmbëdhjetë e në shekujt pasues nëpër të gjitha vendet e Europës. Suksesi i veprës shpjegohet parasëgjithash prej famës së heroit të saj. I quejtun prej Nicola V “*athleta Christi*”, Skanderbegu qe, ndër princat e krishtenë të shek. pesëmbëdhjetë, i vetmi që i duel ballë turqve të cilët kërcënonin Europën e krishtenë, dhe Italinë në vend të parë. Dhunimi i Otrantos (1480) nga ana e turqve që vinin prej Shqipnie, pasoi marrjen e Shkodrës mbas dy vjetsh. Frika e mësymjes otomane në Itali vijoi me qenë e pranishme edhe në shek. gjashtëmbëdhjetë. Le të kujtohet pyetja e grave ba Fra Timotheut në *Mandragola*¹³³ (III, 3): “*A jua merr mendja ju se turku ka me kalue këtë vjetë nëpër Itali?... Unë ia kam frikën shumë kësaj pune*”. Nji tjetër arsye për mirëpritjen e veprës, asht se ajo asht shkrueme mirë dhe lexohet si nji roman. Sikurse historianët e tjerë humanistë, Baleti shkroi jo aq sa me kallxue faktet sesa me për lavdue heroit e saj, tue shtî në punë tana mjetet retorike të kohës. Skanderbegu i fitoi betejat e tij ma pak me shpatën e tij të tmerrshme sesa me ligjëratat e tij madhshtore drejt ushtarëve, të cilat nuk janë “*orazion picciol*” si ajo e Odisesë, por xanë faqe të plota.

Nji tjetër histori e Skanderbegut asht vepër e kushrinit të kryepeshkvit Pal Êjllit, priftit Dhimitër Frangu, arkëtari i Skanderbegut, që e shoqnoi heroin në udhëtimin e tij për në Romë, për me marrë nji ndihmë monetare prej papës Paolo II. Shkrue në latinisht, u pat përkthye me titullin *Commentario de le Cose de' Turchi et del S. Georgoi Scanderbeg. Principe d'Epyrro* (Venezia, 1539).

^{133*} Komedi e N. Machiavelli-t, botue së pari në 1524.

Vepra e Frangut asht një rimarrje e asaj të Barletit, por e ndryshme në disa rrafshe dhe ma shumë kritike.

Bashkëqytetar i Barletit asht edhe Marin Beçikemi, jetën e të cilit e njohim ma mirë.¹³⁴ I lëmë në 1468, mbas ramjes së Shkodrës, emigroi në Raguzë, mandej në Bresha ku kreu studimet. Në riní ishte rektor i shkollave të Raguzës (1494-96).¹³⁵ Mbrapa kaloi në shërbim të Venedikut si diplomat. Meqë kishte marrë nënshtetësinë venedikase në 1500,¹³⁶ hapi një shkollë për letra humane në Venedik, kur ishte si nxanës Ludovico Navagero. Në vijim pati një katedër Studimesh në Bresha ku përgatiti botimin e disa prej shkrimeve të tij. Vepra mbi Plinin u pat botue në Ferrarë (1504); në të njejtin vit del në Bresha panegjiriku për Leonardo Loredano-n, rishtypë edhe në Bresha, së bashku me shkrime të tjera, prej Angelo Brittanico-s. Gjatë dy vjetshit 1508-10, drejtoi sërish shkolla raguzane. Reputacioni i tij si burrë i ditun e mbi të gjitha gojëtar, duhej të ishte stabilizue ndërkohë tue marrë parasysh se Pilade Buccardo ia ngarkoi atij botimin e tij të Plautit. Prej 1520 ishte profesor retorike në universitetin e Padovës. Vdiq atje në 1526.

Xheloz për shkrimet e tij, e pezamtoi, me të drejtë,¹³⁷ Angelo Brittanico-n se kishte “*guxue me botue pa lejen tonë Panegjirikon tonë dhe Çështje letërkëmbimesh të shekullit të parë, vepra të shtypuna me cungime dhe të tjetërsueme...*” Prandej lexohet në një oroe të botimit të veprës përkujdesë prej vetë auktorit (1506), e cila përmban tekstin e një

¹³⁴ Zeno mbështetet kryesisht mbi njoftimet bibliografike të nxjerra prej shkrimeve të Beçikemit.

¹³⁵ S. Gliubich {compilato dall’ Ab. Simone Gliubich di Città Vecchia}, *Dizionario biografico di {degli} uomini illustri della Dalmazia*. Zara: Vienna {Vienna, Zara}, 1856, 25, citue nga C. H. Clough, *Dizionario biografico degli italiani*. Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana, 1965.

¹³⁶ *Dizionario biografico degli italiani*.

¹³⁷ Tekstet e citueme janë të mbushuna me gabime drejtshkrimore saqë më asht dashtë me i ndreqë.

dëshmie, në sajë të së cilës dozha Leonardo Loredano i lejon Beçikemit, simbas dëshirës së tij të shprehun, që askush nuk kishte me mujtë me shitë apo qoftë me përdorë pjesën e pabotueme të veprave të tij për njizetepesë vjet mbas datës së dëshmisë (1505). Dëshmia liston veprat e botueme: *Collectanea in Plinium, Artificium orationum Ciceronis, Castigationes in Apuleium, Centurias tres variorum observationum, Annotationes virgilianas, Observationes in Livium et Fabium, Commentarios in Persium*, dhe *In libros de oratore, et rhetoricos Ciceronis*, përpos vetë veprës e cila përmban *Panegyricum Serenissimo Principi Leonardo Lauretano et illustrissimi Senatui Venetu dictus* dhe *Prima epistolicarum quaestiounum centuriam*.

Panegyricum i botuem në të njejtin vit 1504 kur duel *De obsidione Scodrensi* i Barletit, trajton sikurse kjo, dy rrethimet e Shkodrës, atë të 1474 dhe atë të 1478-9. I pari, që përfundoi me disfatën e turqve asht kremtue me një katranzë madhshtore të Paolo Veronese-s¹³⁸ në Pallatin e Dozhëve. I dyti, përfundue me marrjen e qytetit prej ushtrisë turke, i ka dhanë shkas besimeve popullore simbas së cilave fugura e Zojës së Këshillit të Mirë, e vendue me në kishën katolike me të njejtin emën rrazë kështjellës së Shkodrës, shkoj përmes një mrekullie në Bazilikën e Shejtë të Etënve Augustinianë në Gjenacan afër Romës, aty edhe ku gjendet tash. Bashkë me të edhe katranza e Prospero Piatti-t,¹³⁹ që paraqet fugurën nëpër ajrë tue u shoqnue prej dy shkodranëve të mërguem, tue ecë nëpër ujnën e liqenit të Shkodrës.

Panegjiriku nisë me elozhe përlavduese ndaj familjes Loredano, quejtë “pajtore e shkodranëve”, dhe vijon tue nënvizue besnikninë e tyre ndaj Serenissima-s, tue e përmbyllë me rolin e familjes Beçikemi. Pat qenë një gjysh

^{138*} Pipa i referohet telajos së Veronese-s, *Rrethimi i Shkodrës (Assedio di Scutari)*, realizue në 1585 e cila gjendet në tavanin e Pallatit Dukal (të Dozhëve) në Venecie (Venedik).

^{139*} Bahet fjalë për ciklin me piktura në Gjenacan, realizue nga Piatti në shek. XIX.

i auktorit që e lulëzoi, së bashku me një kolegj të tijin, qytetin e Venedikut në emën të senatit shkodran. E pat qenë një axhë i auktorit që e suell lajmin e mirë në senatin venedikas, mbas humbjes së turqve në rrethimin e parë të qytetit, nën drejtimin e Antonio Loredano-s, veprimet e të cilit përllavden. Gjatë rrethimit të dytë prej tridhjetë familjarëve të auktorit shpëtuen vetëm shtatë. Venediku që tejet bujar në mikpritjen e të mërguemve (“*non est qui aliquem liberatorum domi non habeat et nutriet*”).¹⁴⁰ Qyteti asht, veç tjerash, pajtor i të dijshtëmve; në shkollat venete studiojnë njerëz prej katër anëve të dheut. Elozhi përfshin pjesën në vijim: “*Quas nomine mea dicam? Patriam non habemus antiquam, non fortunas; non caetera, quae aut in amissione patriae perdidimus. Quidquid sumus, vobis, antequam geniti essemus, dicatum est. Ad hoc enim nati sumus: ut non nobis, sed veneto imperio Scodrenses vivamus: vobis, fata nostra sanguine consecrata sunt*”.¹⁴¹

Patriotizmi dhe përulëria i japin dorë kësaj pjese me zotsi retorike. Bembo-ja, të cilin kemi me e pá ma poshtë, pat vlerësim për profesorin tjetër venedikas të kohës pinjuell shqiptar, Thomaeus, e nësa për Beçikemin nuk pat ndonji sympathí. Një letër e 1503 e Paolo Suardo-s, student i Beçikemit, drejtue Francesco Rigionio-s të Crotone-s, denuncon padijen e Raffaele Regio-s, njeri i diskutueshëm që xhuni kathedrën padovane të retorikës, dheskë prej Beçikemit mbas vdekjes së mjeshtrit të vet, Joannes Calphurnius: “*Docuit Becichemus Regirum tuum*

¹⁴⁰ “Nuk ka asnjë që nuk ka në shtëpi dhe nuk mban me bukë dikënd prej të larguemve”. *Panegyricum* (shtypë nga A. Brittanico, kund 1504), fl. 28 recto {mbrapa}.

¹⁴¹ “Çka kam me thanë për emnin tim? Nuk e kemi ma atdheun e moçëm, as trashëgimi, as sende të tjera që i humbëm qoftë kur po mbroheshim, qoftë kur e lëshuem atdheun. Çdo gjë e jona, gjithçka që na përket, asht e jueja, prej jush vjen. Këta që jemi u truhet, para se me lé, ju. Në fakt, kemi lé shkodranë për me jetue për perandorinë venedikase, jo për ne; fati ynë asht shëjtue me gjak për ju”. *Panegyricum* (1504?), fl. 28, verso {para}.

Scodra patriam suam ex Plinii et Ptolemei testimonio in Dalmatia esse, non in Epiro: et Epirotas graecos esse ac graece loqui. Male igitur de Illyricos et Albanorum lingua dixisti epirotico sermone".¹⁴²

Beçikemi dallonte jo vetëm grekët dhe shqiptarët, por edhe epirotët e ilirët, tue i indentifikue epirotët me grekët dhe shqiptarët me ilirët. Barleti në të kundërt, e quen Skanderbegun "princeps Epirotarum". Shënjimi antigrek sjellë theksime etnike. Diku tjetër, Beçikemi vetë thotë: "*Sunt enim italograeci quindam qui ubi literas didicerunt,*

¹⁴² "Beçikemi i mësoi Regio-s tand se atdheu i tij, Shkodra, simbas dëshmime të Plinit dhe Ptolemeut, gjendet në Dalamatí, jo në Epir: e se epirotët janë grekë dhe flasin greqisht. Kështu që u gabove, kur fole për epirotishten e ilirëve dhe të shqiptarëve." *Varia* (1504?), fl. 338, recto. Simbas Zeno-s, anmiqesia mes Beçikemit dhe Regio-s u shkaktue prej akuzës së konkubinazhit që pat lëshue Regio ndaj Beçikemit, në atë kohë kur të dy jepnin mësim në Venedik, në 1501. Regio kishte dashtë me iu shpifë kundërshtarit tue shpërhapë do t' shpifme se grueja e tij Caterina Dabro {Katrinë Dabri} prej Ulqinit, nuk ishte grueja e ligjshme. Që teksti i Zeno-s: "Mbas fillimit të studimeve të tij [në Bresha] ktheu në Ulqin, e atje muer për grue Katrinën, vashën këtëmbëdhete vjeçe të Pasquale Dabro {Pashk Dabrit}, një prej Zotnuesve kryesorë të atij Qyteti: '*quae mihi christianis ceremoniis Olchinii in aede divae Mariae publice desponsata est, quam virginem puram nondum XIV annos in manum dedit Pasckalis Dabrus, in ea urbe longe princeps, qui et ipsius uxoriam pater, et matris meae, quae illam ad infantia, perinde atque filiam, sanctissimis moribus instituit, vir est...*'" Bahet fjalë pra për një martesë mbrendapërmbranda familjes: pra e ama e Beçikemit (që Zeno thotë se ishte e bija e milanezit Guglielmo Pagnano) ishte e shoqja – në martesën e dytë, natyrisht – e të atit të vajzës. Le të vëhet re gjymtimi i emnit të Regio-s që duhej të ishte *Reginus* jo *Regirus*, ba prej nxanësit të Beçikemit, Paolo Soardo-s {në tekst ma heret Suardo}, për me diftue se Regio ishte njeri pa karakter (khs. 'gira e rigira' dhe 'girandola').

existimant se Homeros et Demosthenes; Italiam omnem cum suis literis contemnunt. Stultissimum hominum genus".¹⁴³

Nikolaus Leonicus Thomaeus {Nikolla Leonik Thomeu}, i mbrami humanist arbëresh, leu në Venedik prej një babe me prejardhje me gjasë prej Durrësi. Studioi greqisht në shkollën e Demtrios Kalkokondiles në Firence dhe ishte profesor filozofie në Atheneumin padovan prej 1497 deri në vdekje (1531). Ithtar i Aristotelit, ishte "i pari që i shpjegoi në greqisht"¹⁴⁴ veprat e stagiritit,¹⁴⁵ tue u mbështetë në tekstin original e tue përrurue në këtë mënyrë një methodë të re të t'filozofuemit, e cila qitë mb'anë mbetjet sterile të dialektikës skolastike dhe kapërcente komentet e averroistëve¹⁴⁶ jo gjithherë të mbështetun në leximin tekstor.¹⁴⁷ Ekleziasit me profesion, jetoj njimend si filozof, i kënaqun me pak dhe i përmbajtun prej ngasjeve.¹⁴⁸ Pat si miq personazhe si Bembo, Koperniku dhe Erazmi¹⁴⁹ ("çmues i madh i Leonikut").¹⁵⁰ Bembo-ja që kompozoi epitafin, thotë ndër të tjera: "...*Aristotelicos libros Graeco sermone Patavii primus omnium docuit, scolamque illam a*

¹⁴³ "Janë disa italo-grekë që kanë mësue tri fjalë, kujtojnë se janë Homeri dhe Demostheni, tue përçmue Italinë dhe letrat {letërsinë} e saj." *Varia* (1504?), fl. 310.

¹⁴⁴ Pierre Bayle, *Dictionnaire historique et critique*, vol. XIV. Pairs: Librairie Desoer, 1820, 129.

^{145*} E Aristotelit pra, i cili leu në Stagira të Khalkidhikisë.

^{146*} Doktrinë filozofike e trashëgueme prej komentuesit andaluzian Abū l-Walīd Muḥammad Ibn Rushd [i njohun si Averroë në Europën e Mesjetës], të Aristotelit. Njikohësisht filozof, mjek etc.

¹⁴⁷ *Ibid.*

¹⁴⁸ Girolamo Tiraboschi, *Storia della letteratura italiana*, Tomo VII, Parte II. Firenze: Molini & Landi, 1810, 413.

^{149*} Pietro Bembo, poet, shkollar e kardinal italian. Figurë tepër e shqueme, sikurse ajo e astronomit të famshëm Nicolaus Copernicus dhe ajo e filozofit dhe e teologut Desiderius Erasmus Roterodamus.

¹⁵⁰ *Ibid.*

Latinis interpretibus inculcatam pervolvit."¹⁵¹ Jo ma pak lavdues asht Tiraboschi i cili e vën në krye të kapitullit mbi filozofinë e shek. gjashtëmbëdhjetë, pasue nga Popanazzi "*hiç ma pak i shquem për kah hollësia e mendjes, por ma i kufizuem në dije*".¹⁵²

Thomeu shkroi dhetë dialogë mbi argumente të ndryshme filozofikë edhe letrarë, sikurse divnimi,¹⁵³ shpikja e emnave, loja me zare, lutjet, pavdekësia e shpirtit, etc.¹⁵⁴ *De immortalitate animae* (Padova, 1524), kushtue Bembo-s, bazohet mbi konceptin platonik-aristotelik të vetëlëvizjes (*autokineton*). Auktori e rimerr intelektin e përveçëm të Averroë-s, por nuk asht i sigurt për pavdekësinë individuale. Thekson nyjen mes trupit dhe shpirtit, dhe përbashkon Platonin me Aristotelin, tue shtue njado ide të inatizmit¹⁵⁵ në procesin gnosologjik themelue mbi empiriken,¹⁵⁶ dhe kështu paraprën kundërshtinë mes inatizmit dhe empirizmit. Përktheu dhe parafranoi disa traktate të Aristotelit dhe të Galenit, dhe shkroi edhe një "*mélange de très beaux recuiles*".¹⁵⁷ *Varia storia libri tres*, hartue në rininë e tij, u botue në pleqninë e tij, gja të cilën Bayle e sheh si të "peshueme" dhe madje të rrallë.¹⁵⁸ Iluministri frâng shton se Thomeu pat një vëlla, i cili po të kishte jetue (vdiq me sa duket prej

¹⁵¹ "Ma i pari ndër të gjithë, dha mësim librat e Aristotelit dhe përsosi shkollën [peripatike], të nisun prej interpretuesve latinë". Ibid, 414.

¹⁵² Ibid, 412.

¹⁵³* Në gegënishten e hershme: *parashikimi*.

¹⁵⁴ Bayle, vep. cit., 130.

¹⁵⁵* Doktrinë filozofike, nisjue prej Platonit e rimarrë prej Kartezit, Leibniz-it etc., e cila i njeh trunit/mendjes njerëzor/e ide, norma dhe koncepte (para se me lindë, në fazë embionale), të cilat i paraprijnë përvojës së mavonshme, mbas fazës së lindjes.

¹⁵⁶ *Enciclopedia filosofica*, Centro di studi filosofici di Gallarte, Venezia, 1957.

¹⁵⁷ Bayle, 130.

¹⁵⁸ Ibid, 130.

ndishkut) kishte me e mbërritë famën e të parit, kaq erudit e gjenial ishte.¹⁵⁹

Dokumente historike dhe dëshmi autoritare e vërtetojnë origjinën shqiptare të t'katërt humanistëve të marrë në shqyrtim. Me dyshim asht ndërkaq ajo e Michael Marullus {Mihail Marulos}, poeti-ushtar, fort i dashtun për Croce-n.¹⁶⁰ I lémë në Kostandinopojë në 1453, në vjetin që qytetit u pat pushtue prej turqve, Marulos emigroi së pari në Raguzë, mandej në Ankonë, ku u stabilizue me familjen e tij. Studio letërsi dhe filozofi (admirues i pashoq i Lukrecit, për të cilin përgatiti një botim)¹⁶¹ në Venedik dhe Padovë. U rreshtue, ende i njomë, ndër stratiotët, ushtarë të kalorisë së lehtë në shërbim të Serenissima-s, të Mbretnisë së Napolit, të Papatit e të kujtdo që i paguente. Stratiotët, vinin prej anëve të ndryshme të gadishullit ballkanik, por së shumti ishin shqiptarë.¹⁶² Marulos u rreshtue ushtar ma heret në batalionin e Nicola Ralla-s, lakonias,¹⁶³ e ma vonë lidhi miqsi me Manilius Rhallus, i thirrur Spartanus, një tjetër poet-ushtar. Simbas Philippon, në gjysën e dytë të shek. pesëmbëdhjetë shqiptarët e Moresë përbanin gjysën e popullsisë.¹⁶⁴ Mistra, qyteti bizantin afër Spartës së moçme, del në një tekst që ban pjesë në një përmbledhje

¹⁵⁹ Ibid, 131.

¹⁶⁰ Benedetto Croce, *Michele Marullo Tarchaniota: e Elegie per la patria perduta*. Bari: Laterza, 1938.

¹⁶¹ Bayle, Tomo X, 345.

¹⁶² Zef Valentini, "L'emigrazione stradiotica in Italia", *Rivista d'Albania*, n. 3 (1943): "Stradioti o albanesi, soldati di cavalleria leggera reclutati nella penisola balcanica dalla Repubblica di Venezia". Khs.edhe G. Devoto e C. C. Oli, *Dizionario della lingua italiana*. Firenze: Le Monnier, 1971.

¹⁶³ Bayle, Tomo X, 345.

¹⁶⁴ Alfred Philippon, "Zur Ethnographie des Peloponnes", *Petermanns Geographische Mitteilungen* 36 (1980), 8.

poezish arbëreshe.¹⁶⁵ Simbas Sathas që i ka kushtue stratiotëve një vëllim të plotë të veprës së tij monumentake, Rhallus del në listën e emnave të familjeve ma të njohuna shqiptaro-morease.¹⁶⁶ E ama e Marulos ishte prej Argos. Argolida ka qenë (e pjesërisht asht edhe tash) zonë shqipfolëse e Moresë, dhe kryeqendra e saj Nauplion (quejtë prej venedikasve Napoli i Romanias),¹⁶⁷ qendër e rekrutimit të stratiotëve. Ka mundsi që Marulos ka qenë një prej atyne gjashtëqind grekëve, të cilët ishin në të vërtetë me origjinë të përzieme – shqiptare, rumune, sllave – shembuj të shumtë në periudhën pasuese të pushtimit të Greqisë nga ana e ushtarëve të Stefan Dushanit, që e thirrte veten mbret të Grekëve e të Serbisë, përpos se të Shqiptarëve. Por, origjina etnike dhe përkatësia kulturore janë dy gjana të ndryshme, që nuk duhen me u ngatërrue. Atdheu i Mihail Marulos që e paraqitet në poezitë e tij me pseudonimin Constantinopolitanus, nuk mund të jetë tjetër veçse Greqia, e cila për të (si humanist i flaktë) asht atdheu jo aq i Greqisë bizantine sesa ai i poezisë klasike dhe i mitologjisë pagane. Aq ma tepër që një shqiptar, s’kishte me pasë shumë merak me e lidhë patroniminë e tij me atë të së amës, siç vepron Marulos, që del Constantinopolitanus dhe Tarchaniota në të njejtën kohë: tue u indentifikue kështu me gjyshin kah e ama, Mihail

¹⁶⁵ Giuseppe de Rada, *Rapsodie di un poema Albanese*. Firenze, 1866, raps. I, 4. Shih Arshi Pipa, *Albanian Literature: Social Perspectives*. Munich: Trofenik, 1978, 50.

¹⁶⁶ Constantine N. Sathas, *Documents inedits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen Age*, Tomo 4. Paris: Maisonneuve et Cie., 1880-90, XLV-LXI. Shih Pipa, *Albanian Literature*, shënimi 70, 45.

^{167*} Simbas kontekstit mesjetar, cilësimi ‘i Romanias’ i përket diferencimit të tokave të Perandorisë Bizantinase, që e banin venetët për me e dallue nga Napoli në Itali. Pra, Nauplion [Nafplio/a ose Nauplio etc.] asht port bredgedar në Peleponez.

Tarchaniota, ra për atdhe (“Tarchanius dux”)¹⁶⁸ tue luftue kundër turqve pikërisht në vjetin ku Mista, e cila u mposht e mbramja, shënoi fundin e perandorisë bizantinase (1460).

Nji stratiot prej Nauplionit që njihet si shqiptar asht Manoli Blessi, i cili luftoi për Venedikun dhe ishte ushtar me pagesë. Shkroi poema popullore në dialektin venet, përzie me fjalë greke, tue i thadrue në burlesk bamat e veta me kah pak Margutte dhe Baldo.¹⁶⁹ Sathas përfshiu në vëllimin e tij mbi stratiotët disa prej “barcoletave” të tij, soneteve dhe vargjeve të tjera. Kompozimi ma i gjatë i tij (148 sekstina në trajtë balade, botue në Venedik në 1570), titullohet “Barzelletta de quadro compagni strathiotti de Albania, zuradi di andar per il mondo alla ventura, capo di loro Manoli Blessi da Napoli di Romania” {Ndodhia e katër shokëve strathiotë të Shqipërisë, betuar të bredhin për zulmë: kreu i tyre Manoli Blessi prej Napolit të Romanias}. Balada kallëxon peripecitë e shokëve për zulmë gjatë udhëtimit në Rusí, përmes vendeve të ndryshme europiane, dhe ka si refren (në tetërrokështa të modelit shqiptar, me thekse në të tretën e të shtatën rrokje) strofën vijuese: “*No là semo de Albania / Strathiotti palicari / chie in cavallo, in terra, in mari, / nol stimemo la Turchia*”. {Prej Shqipërie jemi / Palikara¹⁷⁰ strathiotë / kush në kalë, përdhé, në dete / Turqia s’na hy në sy}.

Humanizmi italian e ka krye tashma ciklin e vet, vulgarja {gjuha e vulgut, e popullit, masës} e ka shfronsue latinishten. Në Venedik u pat botue, në 1606

¹⁶⁸ Michaelis Marulli, *Carmina*. Edidit Alessandro Perosa, Turici: Thesaurus Mundi, 1951, Epigrammata 11, 17: “*Mortuoi pro patria*”.

^{169*} Margutte, personazh komikogrotesk i Luigi Pulci-t në poemën epiko-kalorsiake *Morgante* [shek. XV]. Baldo, fabulist i shek. XII-XIII.

^{170*} Greq. παλικάρι në kontekstin historik të kohës, asht një riosh i rekrutuem në ushtrinë greke për me luftue kundër turqve.

Maestro di campo generale i Giorgio Basta-s {Gjergj Basta}. I lemë në Roccaforzata në Tarantino, dikur popullue prej shqiptarësh (ma shumë se njëqindesëdhjetë mijë në fundin e shek. shtatëmbëdhjetë në një kanton, skicue në kartat e vjetra rajonale të Shqipnisë, për me e dallue prej territorit ngjitur banue prej grekëve, e quejtë Greqi),¹⁷¹ Basta ishte një prej gjeneralëve evropianë ma të lakuem të kohës, në shërbim të perandorit habsburgas. “Fameux général de l’armée”, e quejti Bayle, “commissaire général de la cavallerie en 1580”, tue nënvijëzue aftësinë e tij si teoricien i kalorisë së lehtë, mjeshtëri e shqiptarëve, që u dalluen së shumti në shërbim të Serenissima-s (*kapeletët*, për të cilët flet Manzoni në *Të fejuemit*)¹⁷² si edhe të Mbretnisë së Napolit, ku patën emnin *camiciotti* {këmishtarët} për shkak të tunikave tynë të zeza. Vepra në lidhje me këtë temë, *Governo della cavalleria leggiare*, u botue në Frankfurt në 1612. Një gjeneral italian, i njohun për studimet shqiptare, Eugenio Barbarich shprehet kështu në një artikull mbi Bastën: “*praktika e gjatë katërdhjetëvjeçare e fushatës nëpër luftnat e rrehta të Flandrës, të Francës dhe të Transilvanisë, i kanë dhanë Gjergj Bastës një vlerë të jashtëzakonshme praktike teorisë së tij të kthjellët dhe të ndritshme, e cila do të rimerret prej Montecuccoli-t. Me u kujtue sot njëmbasnjë asht vepra e shpagimit historik të detyrueshëm, i propagandës së mirë nxjerrë pre traditave tona*”.¹⁷³ Antonio Gramsci e citon pasazhin tue komentue: “*Prej pikëpamjes së historisë së kulturës, mund të ishte interesante me e ditë se*

¹⁷¹ Primaldo Covo, “Casali albanesi nel Tarentino”, Roma e l’Oriente, 1921, 21.

¹⁷² “U pat dërgue në Bergamo një skuadron *kapeletësh*, i cili duhej me i ba sogje kufinit, që me vrojtue landzknehtët; e ata ishin dreqi vetë, shtat e hije, dhe banin tana të zezat”. *I promessi sposi*, kap. 29, 30. {Citimi i masipërm asht përkthimi im, LK. Shënim: Landzknehtët (Lands+Knecht): kambësorë mercenarë, gjermanë të shek. XV; termi në shumës italisht: *lanzichenecchi*.}

¹⁷³ Eugenio Barbarich, “Un generale di cavalleria italo-albanese: Giorgio Basta”, *Nuova Antologia* (16 agosto 1928).

Farnese ishte italian dhe Napoleoni korsikas [e Gramsci shqiptaro-sard mund të shtohet]...: por historikisht veprimtaria e tyre individuale asht përfshirë në shtetin ku ata janë marrë me shërbye apo në shoqërinë ku ata kanë vepruar.¹⁷⁴ Tue i vû shëj kësaj, me këtë e mbylli këtë artikull, e po i kujtoj studiuesve shqiptarë se zelli i tepruem në gjurmimin e vlerave kulturore të kombit shqiptar të shmangë prej të vërtetës historike, tue u kapërthye edhe me ‘internacionalizmin e tyre proletar’. Për këta studiues, jo vetëm që “*origjina shqiptare e M. Marulos asht e padyshimtë*”,¹⁷⁵ por me të njëjten origjinë kishte me qenë edhe humanisti tjetër i shek. pesëmbëdhjetë, Massimo di Arta, i thirrur Agioriti apo edhe Massimo il Greco {Maksim Greku}.¹⁷⁶ E vetmja provë e shqiptarisë së tij asht se leu në Artë, qytet në grykën e Ambrakisë e cila, e pushtueme prej normanëve të shek. XVI, “*kaloi nëpër të gjitha duert e pushtuesve mesjetarë*”¹⁷⁷ – shqiptarë, grekë, frangë, turq – prej 1356 deri në 1449, pra para se me lé artioti (ndërmjet 1470 dhe 1480). Maksim Greku i cili studioi në Itali e mandej u ba murg në Malin Athos, jetoi gjatë në Moskë e vdiq (në 1556) i internuem në një manastir rus për arsye politike. Me ia mveshë prejardhjen shqiptare dikujt me këtë të dhana, asht barabar si me quejtë shqiptar dikënd që ka lé prej prindëve të cilët nuk i dihen, në një anije tregtare shqiptare që velëzonte në Mesdhë.

¹⁷⁴ Antonio Gramsci, *Quaderni del carcere*, a cura di V. Gerratana. Torino: 1975, Einaudi, 384.

¹⁷⁵ Mikel Prennushi, vep. cit., 68. Vepra asht e mbushun me përfundime dhe pohime të pathemelta. {Përkthimi simbas versionit italisht të Pipës}.

^{176*} Dhanë në kllapa si trajtë shqipnimi jo si përkatësi etnike: njohë si Μάξιμος ὁ Γραικός apo versione të ndryshme.

¹⁷⁷ *Enciclopedia italiana di scienze, lettere e arti*, vol. IV. Roma: Treccani, 628.

Përktheu nga italishtja: Lisandri Kola

Marrë nga: Arshi Pipa, "Umanisti italo-albanesi", Albanica 3-4, 32-43

Humanistë arbëreshë

Me të drejtë shqiptarët përlavdojnë Skanderbegun si Heroin kombëtar që u orvat me bashkue Shqipninë dhe me luftue pushtuesin e huej. Por përveç kësaj arsyeje madhore atdhetare është një tjetër, e rendit kulturor. Në shekullin XV hidhen themelet e një vetëdijeje kombëtare në formë të shkrueme, me Skanderbegun si strumbullin e saj. Gjurnën e parë të kësaj vetëdijeje e gjejmë te Formula e Pagëzimit e vjetit 1462, e shkrueme shqip në një letër që Kryepeshkvi i Durrësit, Pál Engjëlli, krahu i djathtë i Skanderbegut, u dërgon priftënvët katolikë mbas një vizite pastorale gjatë së cilës kishte diktue sjellje të palejueshme nga doktrina kishtarë. Teksti i letrës përmendë Skanderbegun si mbrojtësin njëherit të lirisë kombëtare dhe të fesë katolike. Nji prift italian i shekullit XVIII, Giammaria Biemmi, i cili shkroi një histori të Skanderbegut, përmendë Pál Engjëllin si auktorin e së parës vepër monografike mbi Skanderbegun, botue në Venedik më 1480 me pseudonymin Antivarinus. Disa historianë mendojnë se dëshmia e Biemmit është çpikje e tij. Por është e sigurtë se më i lashti humanist shqiptar, Gjon Gazulli (Johannes Gazulius), pinjuell i një familjeje mirditase të shpërngulun në Raguzë dhe doktor i Universitetit të Padovës më 1430, me cilësinë e tij si ambasador i Raguzës ndërhyri pranë Papës Nikolla V për me i ardhë në ndihmë Skanderbegut, me të cilin kishte lidhje diplomatike nepërmjet dy vëllezënvët të Gjon Gazullit, ambasadorë të Skanderbegut pranë republikës dalmate. Marin Barletti (Marinus Barletius), i cili bëni të njohun Skanderbegun në Europë me veprën e famëshme të vetën, *Histori e jetës dhe punëve të Skanderbegut, princi i Epirotasvet*, botue në Venedik kah fundi i dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XVI, e quen veten "prift shkodran" në veprën tjetër, *Mbi rrethimin e Shkodrës* (1504). Në po këtë vjet u botue në Brescia *Panegjyriku* (Panegyricon) i humanistit tjetër shkodran, Marin Beçikemi (Marinus Becichemus), që përmban, mes tjerash, versionin e tij të dy rrethimevet të Shkodrës nga Turqit, më 1474 dhe më 1478-79. Nji tjetër vepër historike mbi Skanderbegun, shkruet latinisht dhe përkthye italisht me titullin *Komentari i punëve të Turqvet dhe të Gjergjit Skanderbeg, princit të Epirit*, u botue në Venedik më 1539. Vepra është e Dhimitër Frangut (Demetrio Franco) nga Drishti, arkëtar i Skanderbegut dhe kushërri i Pál Engjëllit. Vepra e Frangut, një përmbledhje e asaj të Barletit, është më kritike se historia e tij e romancueme, qëllimi i së cilës është me bërë për vete lexuesin me anë të elokucencës, jo me kërkuar të vërtetën historike. Mjeshtër i elokucencës që edhe Marin Beçikemi, i cili, mbas pushtimit të Shkodrës nga Turqit, mërgoi në Raguzë, ku shërbeu si rektor i shkollavet raguzane. Nga Raguzë kaloi në Venedik, ku hapi

nji shkollë për studimin e lëndëve letrare. Vdiq më 1520 në Padovë ku dha mësim si profesor i retorikës në universitetin e famshëm të këtij qyteti.

Nikollë Leonik Thomeu (Nicolaus Leonicus Thomaeus) lindi në Venedik nga një babë shqiptar (orthodoks, simbas emnit) me prejardhje ndofta durrsake. Në Firenze studioi greqishten në shkollën e greqistit ma në zà të kohës, Demetrio Calcondila. Mbas u dorëzua prift, e kaloi jetën tue mësue filozofi në Universitetin e Padovës deri sa vdiq (1531). Iftitar i Aristotelit, qe, ndër humanistët e kohës, i pari që shpjegoi dhe komentoi Aristotelin në origjinalin greqisht, i çmuem dhe i nderuem nga personalitete të kohës si Erasmi, Koperniku, Pietro dhe Pierre Bayle (i cili shkruen gjatë mbi të te vepra e famëshme e vetja, *Fjalor historik dhe kritik*; Konitza përktheu shqip artikullin të *Albania*). Thomeu shkroi dhetë dialogë filozofikë dhe letrarë, tue përfshirë veprën "*Mbi pavdekshmërinë e shpirtit*", fenomen për të cilin ai nuk është i sigurtë.

Studiuntarët shqiptarë të periudhës komuniste radhisin si shqiptarë dy humanistë tjerë, Michele Marullo dhe Massimo d'Arta. Provat mungojnë, në vend të tyre ka hamendje. Kështu, për shembull, shqiptarsia e Maksimit t'Artës arsyetohet me entymemën kallpazane se Arta është qytet shqiptar, një qytet që, para se të lindte Maksimi (rreth 1470-1480) kishte ndërrue zot - shqiptar, grek, frëng, turk - jo më pak se katër herë gjatë më pak se një shekulli.

Çka mund të nxirret si përfundim prej këtij vështrimi fluturak mbi humanizmin shqiptar? Ai ka markë venedikase. Në qytete të republikës adriatike si Venediku, Padova, Brescia, studjuen, botuen dhe dhanë mësim pesë humanistë shqiptarë: një matematikan-astronom (Gazulli), dy historianë, një profesor i retorikës dhe një filozof. Tre nga të pestët qenë shkodranë, lindun në Shkodër ose në afërsitë e këtij qyteti, i katërti në Raguzë, qytet-shteti sllav me kulturë italiane, aleat i Skanderbegut. Të pestët qenë priftëri katolikë, të cilët, siç ishte zakon atëherë ndër humanistët, shkruen dhe mësuen në gjuhë latine. Kjo shpjegon pse gjatë periudhës gati gjysmë-shekullore të diktaturës komuniste në Shqipëri, nën trysinë e kulturës byzantine, serbe në fillim e mandej ruse, humanizmi shqiptar, ky fenomen zëmadh kulturor që lidhë botën shqiptare me kulturën romane dhe që krijon terrenin për zhvillimin e letërsisë shqipe, u qit në harresë ose u përmend kalimthi së për sy e faqe.

GJERGJ FISHTA

Shënim: Po e shohim me vend me botue kolonën mbi zanin e Gjergj Fishtës si autor në *The Columbia Dictionary of Modern European Literature* (1980: 252-3), ku Arshi Pipa asht kontribues në këtë edicion si edhe përpilues i tekstit mbi Fishtën. Kjo kolonë asht e randësishme, përpos mendimeve kritike (koncize) të Pipës mbi veprën e figurën e Gj. Fishtës, sepse në kohën që Françeskani i Madh ishte i ndaluem në Shqipninë komuniste, emni i tij qarkullonte ndër edicionet ma autoritare në Amerikë.

Ky akt, i përfshimjes së GJ.F. në këtë Fjalor, dëshmon detyrën dhe rolin e Diasporës në Shtetet e Bashkueme [ku Pipa ishte zani ma përfaqgues mbas viteve '70 e mbrapa] për me zbardhë të plotë historinë e keqshkrueme të Shqipnisë enveriane. Sikurse vrehet, optika e Pipës—sidomos në rrafshin politik—mbi Fishtën nuk asht aspak deduksion pozitivist, por mveshet prej një kritikizmi objektiv. Në disa momente kjo e fundit del edhe për epikën e Poetit, tue paraqitë kështu qëndrimet e Pipës për mospërzimjen e gjinive letrare: si rasti i satirës në epikën fishtiane. Tashma asht e ditun, se pozicioni i A.P. për çështjet e letërsisë asht strikt dhe klasik, i formsuem simbas konceptimeve teorike të kritikës europiane të gjysës së parë të shekullit XX.

Kjo kolonë, në kushtet dhe rrethanat e receptimit të veprës së Poetit në Shqipninë e asaj kohe (1980) apo edhe të Diasporës Shqiptare, asht 'dosja' ma e plotë për praninë e letërsisë shqipe në Letërsinë Moderne Europiane e gjithashtu asht një mesazh i qartë se autoriteti akademik triumfon mbi diktaturën dhe censurën. Kaq rreshta, flasin ma shumë se qindra monografi mbi Fishtën mbas ramjes së sistemit komunist shqiptar.

L.K.

Fishta, Gjergj (1871-1940), poet shqiptar i lémë prej prindësh fshatarë në një fshat afër Shkodret. Frat Franciskan, i shpallun prej adhuruesve të vet si poet kombtar; ai asht figura ma e jashtëzakonshme midis përfaqguesve të rij të lëvizjes romantike shqiptare (shih ALBANIAN LITERATURE). Fishta studioi thelogji në Bosnje, ku lexoi poetët kroatë si Kačić dhe Ivan Mažuranić (shih CROATIAN LITERATURE), e u


ndikue prej temave tyne dhe modeleve të poezisë gojore. I frymëzuem prej këtyne shkrimtarëve dhe prej poezisë gojore të Shqipnisë Veriore, Fishta shkroi *Te Ura e Rzhanicës* (1905), një kangë epike që përkujton betejën e shqiptarëve kundër malazezëve në 1878. Dy vjet ma vonë, ai botoi një tjetër kangë epike, *Vranina*, e cila trajton një përplasje kufini të 1858 ndërmjet malazezëve dhe shqiptarëve kryesue prej Oso Kukës, një hero shkodran i kangëve folklorike. Këto vepra së bashku me *Anzat e Parnasit* (1907), një përmbledhje poezish satirike, e stabilizuen Fishtën si figurën letrare kryesore të kohës së tij. Në 1913, Fishta themeloi *Hyllin e dritës*, një revistë shqiptare me ndikim në të cilën ai botoi poema të tjera epike, lirika të ndryshme, dhe artikuj polemikë. Vëllimet e mavonshme të poezisë së Fishtës, përfshijnë *Mrizin e zanavet* (1924), një përmbledhje poezish politike e didaktike, dhe *Vallen e Parrizit*, një tubë hymnesh fetare nën stilin e *Inni sacri* të Alessandro Manzoni-t. Fishta gjithashtu shkroi disa melodrama dhe një burlesk satirik, *Gomari i Babatasit* (1923), në të cilin ai përtallë kundërshtarët e tij politikë.

Përveçse ishte një shkrimtar i frytshëm, i cili lidhi kokrra pothuajse në krejt gjinitë poetike, ai ma së shumti dahet në shëj për veprën e tij të jetës *Lahuta e Malcís* (1937). Kjo poemë epike asht një cikël prej 30 kangësh në tetërrokësh të rimuem, trajta e vargut kombtar, që këndon heroizmin dhe virtytet e malsorëve gegë në betejat e tyne kundër malazezëve dhe serbëve. Poema pat fillue si lidhni e zakonshme epizodesh, e mbrapa u përpunue në një katranzë ma të gjanë, tue përfshî si përpjekjen për pavarësi kombtare si edhe ndodhi të tjera që përkonin me moton vetjake të Fishtës, e cila ishte “atmë e fé”. Në riní të vet, dhe der m’tash kangët ma të mira, Fishta qe i zoti me përkapë shpirtin heroik të modeleve të tij, rapsoditë folklorike, që i mundsuen atij me qenë rapsod i mrekullueshëm. Polemika dhe ideologia i shoqnoi kangët e mavoshme, tue u ba sidomeqenë të mbingarkueme dhe të teprueme, dhe në të cilat satira politike e Fishtës shpesh

u kthye në parodí dhe karikaturë. Por, epika e tij zakonisht mbahet si vepra ma përfaqësuese e letërsisë shqipe dhe ajo asht përkthye në italisht dhe gjermanisht.

Pasioni i Fishtës për politikën ishte i pandamë prej vokacionit të tij fetar dhe letrar. Ai botoi një fletore, *Posta e Shqypnís*, një zâdhânse e autoriteteve austro-hungare të okupacionit gjatë Luftës I Botënore. Ai ishte xêvends-president i Parlamentit të parë shqiptar në 1921, dhe mbrapa kryesoi disa delegacione qeveritare jashtë. Mbasi vendi pat pranue pa bza okupacionin italian, ai u ba anëtar i Akademisë Fashiste të Italisë në 1939. Për shkak të aktivitetit politik të Fishtës, randue edhe prej sllavofobisë së tij, gjatë komunizmit shqiptar ai u ba delja e zezë (bête noire) dhe veprat e tij u ndaluen. Deri tash kritika letrare nuk ka mbërritë me e caktue vendin e fuqisë së pamatë të fjalës dhe të madhshtisë së Fishtës. Ai mbetë autori ma kontrovers në letërsinë shqipe, objekt i lavdatave hiperbolike dhe i shpërfilljeve të forta. Një përkthim i *Lahutës së Malcís*, përkthye nga M. Lambertz-i, duel në 1958.

Përktheu nga anglishtja: Fr. Cencor Ambrozi



GIORDANO BRUNO

I

«Për shenjten fé! për t' lumen kishën tonë!
Shpërblimi i qiellit pret n' amshim besnikët!
Por zjarm ka për mohuesit, heretikët!
turra ktu poshtë e ferri andej gjithmonë!»

Nji përqethje gjarpnoi, nji amen i fikët
u-ngjit nga turma n' terr tu' i bâ jehonë
domenikanit shkurtabiq n' amvonë
qi i gacullonte syni i paqerpikët.

Shenjin dha bazilika e i prini korit;
ushtuen prej kodrash tinguj kumbanarësh
e u-mbush me jone qielli i rimtë i frorit.

Ishte Shën Valentini, e ndaj dritarësh
me gjeth ndër flokë e gema maresh,
vajzat albione i faleshin dashnorit.



II

E ndihej n' ajr një flim lulesh i njomë
qi kishin çelë mbas murit mbanë shtërheret.
Ngutej vera me kthye atë vjetë m' heret
si me përcjellë, tue e pastrue n' aromë,

at shekull gjaku gjithë avuj koleret
me martyrin e shkencës bash mbi Romë.
Frynte një flad i butë qi i hynte n' dhomë
e i rinte parzmin n' afsh t' ambël predeveret.

Predeverë për botën se për të jo m'!
Kish sosun jeta e tij. Por keq s' i vinte:
se si shqipe qi e plasi me tufâ

era mbi breg prej krepave ku rrinte,
lajmin e mirë tue vdekë ai dheut i binte
se furtuna qi e shqeu zente me prâ.



III

Nji tjetër shpirt agonte n'histori
për tre shekuj gatue n' anrrat e motit,
heretik i pagzuem me flakë t'agzotit,
me voj shtypshkronje i lyem, nji shpirt i rí.

E trashigonte arratin e pilotit
Vikingas me nji mall për bukuri
qi pat Heleni. Verbi i tij: Njeri.
S i digjte mâ thymjame Sabaothit;

s i trembej djallit, i adhuronte shtatin
çveshun natyrës, nanë e perendeshë.
Tagër arsyeje feja e tij, pa meshë,

pa miazma kryptash. Lente aty Akuinatin
me gjithë mjeshtrin e tij, e tu' i buzqeshë
Demokritit, profet shpallte Sokratin.



IV

E qe, mbi trevat ku seliti Poli
ka dalë e i frÿn pozaunes Koperniku.
Ja shembi tokës hjerarkín, ja fiku
qiellit shkëlqimin! Trandet Kapitoli,

qitet kushtrim: Duhet luftue anmiku!
Dje nga familja fara e keqe doli.
E sot çka si pa t' keq Thornasi foli
me bujë e shpallë Nolani, heretiku!

Lidhu, fatos! Mendimi qi u-përflak
nuk birret mâ ndër shekuj! Shif, një plak
po ngjet tash njato shkallë qi ti përshkove!

Gulshon, përgjysë i verbët, shpinën lak,
e mbrîn te praku i tmerrshëm... «A i mohove?»
Ai çon gishtin përpjetë: «Eppur si muove!»



V

Nuk kishte hanë por kupa e kthielltë agonte
nji vezullim opali i madhnueshëm,
gjigant qi i turret qiellit shungullueshëm
tempulli i Pjetrit dukej n' horizonte.

Nji meteorë u-fik. Ndenji mendueshëm
përdhé mbi bykun: gjallë ishte edhe sonte.
te muri n' ball qi nji bishtuk ndriçonte
nji Krisht i drunjtë ja ngulte sÿt trishtueshëm.

Krisën hapa... nji çels u-fut te dryni.
Ai brofi m' kambë, i ngrimë... Dikush tash hyni...
nuk hyni, vetëm kryet te dera qiti:

Jezuiti! E vështroi thue e pështyni.
«O vllá i gabuem, ende s' është vonë...» E priti.
S erdhi gjegje e rrëfyesi shpejt rëshqiti.



VI

Ti për ungjillin e dashnís eprore
kryqin pate shpërblim, o Galilé!
E tash tjerë farisej, asish qi bé
bâjnë n' emnin tand shpërblejnë me t' njajtën kore

nji tjetër bir njeriu, dhe me korté
(si ty dikur) ndër «Agnus Dei» me kore
te shtylla e çojnë (o tallje e kob!) therore
për ty qi flije u-bane ashtu i pafé!

Hypokritë! E përdhosën besën tande.
Skam? Thjeshtësí?... Dafrungë e mirakandel!
Mëshira e tyne, ahmarrje e patënzonë.

Edhe kur vrasin hypokritë (s ju kande
me derdhun gjak!) Por dridhu, o Babylonë!
Kush s asht i dliër mbaron heret a vonë.



VII

T' falem fis Prometheu, qi shembulltyrën
e qiellit ngrehe ktu mbi dhé vigane,
e qi me brushë ndër muret Vatikane
kreve çka kreu yt vllá i madhi me lyrën!

Me trajta e ngjyra t' ngurta kurr nuk prane
Zotit tue u-mundue me i ngjá fëtyrën,
e çka furis kreshnike ata s t'i byrën,
me tempull eurythmik i dole m'ane!

E pashë me hanë e brita nga çudija!
E pashë me diell e me gazmend u-lbyra!
Se n'at vepër ku shkrihen arti e dija

m'u-zhvillue para sýsh e gjithë madhnija
e ardhme e Njeriut; e kur atë e këqyra
qela s m'u-duk e randë, s m'u-duk mënxyra.



VIII

Harmoní qi krejt botën e paskâje
qeverisë, sipër saj e brenda soje!
ku t'kundërtat pajtohen prej nevoje
n' amshim e një jete, shkaku e rrâje!

Si me t' kuptue? Me çfarë tjetër përvoje
mâ mirë se me këtë mendje qi pa prâje
e njëjta ngelë pa humbjen e kurrgjâje,
mendime tue flakrue andej me kroje?

E këtë mendje u-përpoqën me e prangosun!
E shif! një pikë e tkurrun me t' pasosun,
shkendijë e Arsyës qi depërton gjithsin,

shpërtheu ajo n' liri e u-derdh n' hapsinë,
tue njoftë ashtu, landë e shpirt njëjsh brumosun,
pakufinin, e deshi Perendín.



IX

E doli prap n'dritare. Hyjt shakmizë
i qëndisshin pëlhurën pambarimit
mbi valë etheri bruze prej shkëlzimit.
E u-dridh kur e mendoj veten kërthizë

t' asaj bote pa fund qi, bash pse shqimit
asisoj, ka për qendërr çdo kokrrizë,
čas mbas çasi e mendja tu' e lëvizë
qi atë perfshin me rrezgun e mendimit.

Me teh t' mendimit, me kullësë t' arsyes,
qi forcën bājnë e krenarin njerzore;
jo me at vegim përçart, at shkulum rrëmbyes

lave qi shfren prej t' errtave llogore
ku kafsha flën, e qi me titull fyes
quhet zbulim a profeci hyjnore.



X

Jo për të, dijetarin nalt mbi fronin,
ishte ajo fé, por për ata me llofin
e shqiseve, për turmat qi s e shofin
Zotin ndryshe veç t' endun me zakonin

e prallave foshnjore e kurr s e njofin.
E ju-kujtuen dyshimet qi xhakonin
e rí munduen, qortimet pse Platonin
pëlqente e kishte n'iri Filosofin.

E si mohoi. Mandej ravgimet: hija
mbi Gjenevë e Servetit; mandej nami
n' Sorbonën e Abelardit e ku Okkami

doktrinën shpalli kah u-mbars liriya;
mandej shpifjet e kallat; Gjermanija;
nxansi i pabesë e Vatikani, i mbrami.



XI

Prej qele n' qelë tërthuer një jetë beteje,
me pendën shpatë, kalorës i arratisun
i mendimit, kaloi ai pa kondisun
askurrkund, trevë mbas treve, fë mbas feje,

me zemrën e shpërdame t' pakandisun,
si e ka kush është i hjedhun n' gjetje s' reje;
krenar, përçmues, idhnak, me duf ndër deje
rrebeli, qi me të shpate tue grisun

tisat e qiellit shkoi qi tjerët thurën;
e qi ndër pranga i kalbun, me torturën
e Prometheut, si prindi i vet sublim

përbuzje u flaku atyne qi premtim
jetën e i folën për me bënë abjurën
e pritë tash aty vdekje e amshim.



XII

Dhe e pau veten për shtyllë. Përqark hordhija
e korbave shenjtnue n' aromë thymjani;
shandanë ku digjet (para mishit) vjami;
e uratë e psalm. Ndër praqe, mbi çatija,

e poshtë te sheshi brufullon gërdhami.
E shajnë, e gjuejnë, pështyjnë veprat e tija.
Nji plakë përshpirtshëm bie nji dorë karthija,
dhe i nipi foshnje i hjedhë nji gem bajami.

Brambullon stiva, çohet flaka n' qiell...
Nji ças: nji ferr!... Mandej ka shqisë tjëra,
e shpirt e trup përzihen me ajr e diell.

E bâhet hî. Andej e merr tash era,
e ngjeshë me tokë, prej kah, kur vjen prendvera,
me bimën lén e rishtas endet miell.



XIII

Jo, ti nuk vdes! Feniks nga hini ngjallun,
jo prej atij qi la Savonarola,
as vashat frenge, as edhe trimi Kola
qi e lau me gjak te republika e shpallun,

por prej hinit t'amshuem ndër aureola
tjetër shenjtñije, qi martyrja e tallun
la Hypatija, dritë jo zjarm tue kallun,
qi mendjen bindë qi s bindën toga as stola.

Ndrrohen kohnat. Bakonin ndjek Bakoni,
Gilberti Paracelsin, epin proza.
Sot filosofë muros in kisha e froni;

nesër borges in u ban apotheoza.
Ka lé Kartezi! E, shif, si Hyperjoni
mbas Luciferit, vjen yt vllá Spinoza.



Marrë nga: Arshi Pipa, *Libri i burgut*, 1994. Tiranë: Eurorilindja
(anastatik i bot. I, Romë, 1959), 179-87.

LETËR DEPARTAMENTIT TË SHTETIT TË SHBA^a

Federata Panshqiptare e Amerikës
VATRA

19 Qershuer, 1991

Të Ndertit James A. Baker,
Sekretar i Shtetit
Departamenti i Shtetit
2201 C Street NW
Washington, Dc 20520

I dashtun Z. Sekretar,

Shqiptaro-amerikanët janë të shenduem për lajmin se ju së shpejti keni me e vizitue Shqipninë. Ne besojmë se vizita juëj ka me qenë vendimtare në nisjen e marrëdhënieve të reja ndërmjet Shteteve të Bashkueme dhe vendit tonë të prejardhjes.

Ashtu siç me siguri jeni vû në dijeni, situata në Shqipni asht kaotike, kryesisht sepse ekonomia e vendit asht në rrenim. Popullsia e saj po des ûnit, puna nëpër fabrika e kooperativa asht ndërpre, qeveria e ka humbë kontrollin e qeverisjes, dhe anarkia ka vërshue. Në këtë rrugë pa krye e ka çue regjimi despotik që shpallë një ideologji fanatike, përmbushë prej burokratëve të paaftë. Partia Komuniste ma së fundit e ka kuptue se monopoli i saj i pushtetit nuk asht ma i qëndrueshëm dhe kështu që

ka vendosë me e nda pushtetin me partitë opozitare. Tash në qeverinë e re të koalicionit, Kryeministri asht prapëseprapë Komunist. Qeverimi dikatorial asht braktisë e xëvendsue me hegjemoní. Krejt kjo tingëllon ma demokratike, por s'asht ashtu. Nji hap drejt demokracisë kishte me qenë me e nda pushtetin në pjesë të barabarta. Ne besojmë se ju do të pajtoheni me arsyetimin e kërkesë sonë që njena prej dy pozicioneve të nalta në hierarkinë e shtetit, Presidenti i Republikës ose Kryeministri, duhet me i përkritë opozitës.

Nji kërkesë e dytë i shqetëson shqiptaro-amerikanët. Sa u takon lajmeve në media, Ministri gjerman i Punëve të Jashtme ka shtrur çështjen e “rehabilitimit” për ekzilentët politikë dhe refugjatët. Edhe pse nuk e miratojmë thanien e tij, i jemi mirënjohës Z. Genscher për shqetësimin e tij mbi të drejtat politike të ekzilentëve shqiptarë dhe të refugjatëve. VATRA, Federata Panshqiptare e Amerikës, i hapi dyert e saj për ekzilentët politikë mbas Luftës II Botënore, dhe ka vijue me veprue kështu për refugjatët politikë të ardhun prej Shqipnie dhe zonave shqipfolëse në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Në Shqipni, ekzilentët politikë janë cilësue si tradhtarë të vendit thjesht pse e kanë braktisë atë. Ata vepruen kështu për me i shpëtue shtypjes dhe përndjekjes së Komunizmit, jo sepse ata kishin ba krime. Prandej ata nuk kanë nevojë për rehabilitim. Krejt ajo çka kanë nevojë, dhe kërkojnë, asht leja për me vizitue atdheun dhe nëse ata duen, të drejtën për me pasë za në jetën e tij politike. Kjo asht praktikë e njohun në vendet e tjera të Europës Lindore ku ish-Komunistët sunduen, por ende jo në Shqipni. Ne jua kërkojmë ju Z. Sekretar që me e advokue këtë të drejtë për ne.

Ne gjithashtu ju lusim që me e përdorë prestigjin tuej, që me u sigurue se literatura e botueme në Shtetet e Bashkueme dhe në vendet e tjera demokratike, tue përfshî libra dhe revista me autorë ekzilentët dhe refugjatët

shqiptarë, me u lejue me hy dhe me qarkullue lirshëm në Republikën e Shqipnisë.

Ju urojmë shumë suksese në vizitën tuej ballkanase, dhe njimend besojmë se ju keni me i përmbushë kërkesat tona.

Jueji, me nderime,

Arshi Pipa
Profesor Emeritus
Kryetar i VATRËS

cc: Z. Hans-Dietrich Genscher, Bonn, Gjermani
Z. Richard Schifter, Departamenti i Shtetit
Znj. Susan Sutton, Departamenti i Shtetit
Partia Demokratike, Tiranë, Shqipni
Partia Socialiste (Komuniste), Shqipni

Letra shtetarëve^b

Këshilli Kombtar Shqiptaro-amerikan
1166 Joseph Campau
Hamtramck, MI 48212

4 Fruer, 1990

Z. George Bush
President i Shteteve të Bashkueme
Shtëpia e Bardhë

Z. President:

Shqiptarët në Kosovë po bahen subjekt i një vale të re arrestimesh, burgimesh dhe vrasjesh (28 e më shumë për sa thonë burimet zyrtare), që përvijojnë represionin e Marcit 1989. Edhe tash, si atëherë, arsyeja për këtë është shfaqja sporadike e protestës kundër ndryshimeve në kushtetutën e Jugosllavisë, çka e privon krahinën shumë prej autonomisë së saj. Goditja e 1989 u dënua prej medias së vendeve demokratike, s'u miratue prej Amnesty International, dhe u kritikue prej Parlamentit Europian. Kongresi Amerikan nuk e miratoi politikën jugosllave në një rezolutë të përbashkët të House of Representatives dhe Senatit.

Represioni i përgjakshëm i 1981 dhe 1989 po përsëritën sot, e këtë herë po kërcënon me luftë civile. Nëse ndodhë kjo, ka me pasë një tjetër *intifada*, me pasoja fatale jo vetëm për vendet e Ballkanit, por gjithashtu edhe për Europën e vendet në NATO. Ju bajmë apel, Z. President, për me përdorë prestigjin tuaj dhe të zyrës suaj që me e parandalue katastrofën.

Si qytetarë amerikanë me prejardhje shqiptare, ne e çojmë zanin tonë për me protestue mbi përndjekjen e pamëshirshme të shqiptarëve në Kosovë, Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi. Shqiptarët janë tue protestue se ata nuk pranojnë me u trajtue si shtresë e dytë qytetarësh në një shtet federal, kushtetuta e të cilit u garanton të drejta të barabarta të gjithë qytetarëve të saj. Mendojmë se kuraja civile e kosovarëve meriton ma shumë admirim sesa ndëshkim. Cilat janë kërkesat e tyre? Ata duen zgjedhje demokratike, për me i ushtruar presion drejtuesit pro-serbë që me dhanë dorëheqjen. Ata e saktësuen këtë me lirimin e të burgosunve politikë kosovarë, me ndalesën e gjyqeve politike, dhe abrogimin e ligjeve si diskriminim kundër atyne ngaqë nuk janë grup etnik sllavojugorë. Ata kanë qenë tue jetue tash një dekadë në një shtettrrethim, gja të cilën kishin me dashtë me e zhba menjherë. Dhe ata duen që krahina me u kthye në gjendjen e maparshme, librue prej kontrollit serb. Këto janë kërkesa të ligjshme në traditën e demokracisë Perëndimore dhe në frymën emancipuese të kohëve tona. Dhe ne, qytetarët amerikanë të një shteti federal që e kemi mohue sundimin kolonial për hir të idealeve të demokracisë, i mbështetesim kërkesat e tyre.

Tue besue në ndërhyrjen tuej të menjihershme,

Me nderime,

Për Këshillin Kombtar të shqiptaro-amerikanëve
Arshi Pipa
134 G Street, SW
Washington, DC 20024

23 Prill, 1990

Z. James A. Baker
Sekretar i Stetit, Shtetet e Bashkueme të Amerikës
Departamenti i Stetit
2201 C Street, NW
Washington, DC 20020

I dashtun Z. Sekretar:

Kjo letër asht shkruar në gjuhë të zhvillimeve të mbrame në punët e jashtme shqiptare, në lidhje me të cilat zyra juaj asht e mirinformuar. Në anën tjetër si qytetarë amerikanë me prejardhje shqiptare, ne besojmë se perceptimi ynë ka me qenë i dobishëm në vlerësimin e situatës së tashme.

Sikurse e dini, më 7 Prill, 1990, Z. Ramiz Alia, Sekretar i Parë i Partisë së Punës së Shqipërisë, shprehu dëshirën e tij për me vendosë marrëdhënie "miqsore" me Shtetet e Bashkueme. Kështu, qeveria shqiptare asht tash e gatshme me rivendosë marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkueme, të cilat u prishën në Qershtor 1939, mbas okupimit prej trupave italiane.

Trajtimi jomiqësor i misionit të SHBA-ve në Tiranë në 1945 prej auktoriteve të Komunistëve shqiptarë e bani të pamundur me i përtëri marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve në atë kohë. Po ashtu as propozimet e përsërituna të Shteteve të Bashkueme qysh në 1974 nuk kanë qenë të frytshme, për shkak të qëndrimit të vazhdueshëm anmiqësor prej qeverisë shqiptare ndaj Shteteve të Bashkueme. Tash asht qeveria shqiptare që po e ban ofertën. Arsyeja kryesore për ofertën e Shqipërisë asht rritja ndërkombtare e presionit mbi Shqipërinë për me u destalinizue, tue ndjekë kësodore zgjimin e vendeve të

tjera të Europës Lindore. Nji arsye tjetër asht shkatërrimi ekonomik i vendit, të cilin qeveria u përpoq me e mëkambë tue përmbyllë marrëveshje tregtare me vende të ndryshme europiane. Prapë nji arsye tjetër asht imazhi i keq ndërkombtar i Shqipnisë, shkak i të dhanave të mjerueshme të t'drejtave njeriut, siç dëshmohet prej raporteve të ndryshme, tue përfshî atë të Amnesty International dhe së fundmi të Minnesota Lawyers International Human Rights Committee.

Si pionere e Demokracisë Perëndimore dhe si prîjse e gjithmbarshme e lëvizjes për të drejta njerëzore dhe civile, SHBA nuk duhet me vendosë marrëdhanie me nji shtet si Shqipnia staliniste pa pasë së pari dakordsinë e qeverisë së saj për pikat e maposhtme:

- a) Të burgosunit politikë dhe të internuemit duhet të lirohen menjihërë.
- b) Politika e diskriminimit të vizave ndaj qytetarëve të SHBA duhet të abrogohet. Çdo qytetar i SHBA duhet të jetë i mundshëm me hy e me dalë prej Shqipnie simbas dëshirës, veçmas ose në grupe, pa u bezdisë prej Sigurimit shqiptar.
- c) Personat familjarë që duen me emigrue në Shtetet e Bashkueme duhet me u lanë me veprue kështu pa asnji pengesë.
- d) Gazetat e SHBA, periodikët dhe librat, përfshî botimet fetare në anglisht ose shqip prej anëtarëve të komunitetit shqiptar në Shtetet e Bashkueme, duhet me u lejue me hy në Shqipni dhe me qarkullue atje.

Këto janë kërkesa minimale që ne i paraqesim si qytetarë amerikanë me prejardhje shqiptare. Sidoqoftë, qeveria e Shteteve të Bashkueme mundet me dëshirue me shtue kërkesa me natyrë ma të përgjithshme që i mëshâjnë të drejtave njerëzore e demokratike, të tilla si,

- e) të drejtën për me formue parti të tjera përpos asaj Maksiste-Leniniste dhe parti që nuk kontrollohen prej Partisë së Punës së Shqipnisë;
- f) të drejtën për zgjedhje të lira, të mbikqyrura prej një delegacioni nga Shtetet e Bashkueme;
- g) të drejtën për besim të lirë.

Ne mendojmë se porositë apo kërkesat për një pajtim të tillë duhen me u ba si parakushte për qeverinë e Shteteve të Bashkueme që me e pranue ofertën e Shqipnisë, tash që qeveria staliniste po prirret me e ble legjitimitetin e SHBA me një çmim. Përmes vendosjes së marrëdhanieve diplomatike me Shtetet e Bashkueme, qeveria e Tiranës shpreson me e përmirësue imazhin e diskretitue të Shqipnisë.

Parashtroi me nderime,

Arshi Pipa
134 G Street, SW
Washington, DC 20024

7 Maj, 1990

Shkëlqesës së Tij Javier Peréz De Cuéllar
Sekretar i Përgjithshëm
Organizata e Kombeve të Bashkueme
United Nation Plaza
New York, NY 10017

I dashtun Z. Sekretar i Përgjithshëm:

Kërkesat e përsërituna të Komisionit të Kombeve të Bashkueme për të Drejtat e Njeriut që me e inspektue gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipni ma së fundi kanë ngadhënyje. Qeveria shqiptare ka pranue me pritë një delegacion të kryesuem prej Shkëlqesës Suej për me e vizitue atë vend.

Si qytetarë amerikanë me prejardhje shqiptare, rekomandimi ynë i përndershëm për ju, – nëse e vizitoni burgun e Burrelit, ku qelitë e tij me gjasë kanë me u ndreqë dhe me u lye rishtas, – asht që me pyetë për vorrin e Gac Çunit, një djalë i ri që u la me deké atje në Prill të 1956 prej një sulmi akut të apendicitit vetëm pak ditë para se dënimi i tij me mbarue. Nëse ju e vizitoni mensën e kampit të punës me detyrim në Spaç, e cila mund të jetë ba me u dukë si kafehane, ju lutem kërkoni me pá vorret e katër të burgosunve që u pushkatuen si udhëheqës të revoltës së Majit 1973. Nësa në Shkodër, ndoshta keni me lypë me pá sesi duken Vorret e Martirëve – ky asht një vend ku më 4 Mars 1946 Ati Jezuit Gjon Fausti, Xêvends-Privingjal i Jezuitëve Shqiptarë, u pushkatue dhe u vorrue së bashku me shtatë seminaristë dhe shokë.

Me siguri shoqnuesit tuej shqiptarë nuk kanë me kërkue falje për gurët identifikues që mungojnë mbi vorre. Simbas metafizikës staliniane, tradhtarët dhe anmiqtë e

popullin nuk janë persona, i.e., njerëz që nuk kanë ekzistue ndonjiherë. Dhe një person që nuk ka ekzistue kurrë nuk mundet kurrësi me pasë një gur vorri. Shoqnuesit me mirësjellje kanë me ju thanë se faji, nëse ka ndonji, për vrasjet në fjalë lidhet me klanin e Mehmet Shehut, i cili kontrolloi aparatin e Sigurimit pothuajse prej në krye të herës deri në spastrimin e 1982, kur Hoxha e asgjatoi klanin. Në lidhje me këtë logjikë, Kryexhelati ma shumë duhet me u lavdue sesa me u fajdue që e ka pastrue Shqipninë pre një mbetje' të tillë njerëzore.

Kjo letër u shkruar me ngut, shty prej dëshirës sonë që me mbërrë te ju përpara nisjes suaj për Shqipni. Ju lypim falje për mangësitë e saj. Ju urojmë sukses në nismën tuaj të fisme që me prë pak qetë në jetën e vajtueshme dhe të padejë të një populli, dënue me robni pothuaj tash një gjysë shekulli.

Parashtroi me nderime,

Arshi Pipa
Profesor Emeritus
University of Minnesota

24 Shtator, 1990

Z. James A. Baker
Sekretar i Shtetit
Departamenti i Shtetit
2201 C Street, NW
Washington, DC 20020

I dashtun Z. Sekretar i Shtetit,

Në takimin e Qershuerit 1990 të Konferencës mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, neni 5 iu shtue rregullores së saj ekzistuese. Neni vën theksin mbi sistemin shumëpartiakësh si thelbsor për demokracinë perëndimore dhe tërthorazi dënon natyrën antidemokratike të konceptit të Partisë-Shtet tue denoncue politikat e Shqipnisë staliniste.

Kryetari i saj, Ramiz Alia, siç e dini, e ka rrëzue nenin në fjalë. Ideja e tij, sikurse asht shprehë në një prej fjalimeve të tij, asht për me pasë zgjedhje “demokratike” në Shqipni me rrypat e ndryshëm përçues të pushtetit të Partisë Komuniste Shqiptare, që sillen si parti demokratike.

Mendova me jua sjellë në vëmendje këtë informacion, tue marrë parasysh se z. Alia së shpejti ka me vizitue Shtetet e Bashkueme dhe ndoshta me u drejtue në Kombet e Bashkueme. Ai ka me u mundue me e bindë popullin amerikan dhe botën, se procesi i “demokratizimit” nisë prej tij në Shqipni asht “i pakthyeshëm”. Synimi i tij asht me e ble legjitimitetin demokratik prej veprimeve sikurse pranimi i Shqipnisë në CSCE, e gjithashtu pranimi i Shteteve të Bashkueme për me rivendosë marrëdhanie diplomatike me Shqipninë.

Gjegjja për manovrën e Z. Alia asht se ajo çka thirret demokraci me vlerë sigurohet vetëm nga një sistemi shumëpartiakësh përmes zgjedhjeve njëmend të lira. Përdërisa një opozitë e ligjshme nuk ekziston në Shqipëri, asht kot me folë për demokraci.

Me nderime,

Arshi Pipa
Profesor Emeritus
University of Minnesota

cc. Senator De Concini
Congressman Hoyer
Congressman Lantos

Letër Presidentit të Shteteve të Bashkueme^c

Federata Panshqiptare e Amerikës
VATRA

21 Janar 1992

Të Perndertit George Bush
President i Shteteve të Bashkueme
Shtëpia e Bardhë
Washington, D.C. 20500

I dashtun Z. President:

Në një fjalim të mbramë, Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Hans-Dietrich Genscher, propozoi me u dhanë status bashkëpunimi çështjeve të Republikave Baltike, Bullgarisë dhe Rumanisë sikurse edhe shteteve pasuese të Jugosllavisë “me perspektivën e anëtarësisë së plotë në të ardhmen në Tregun e Përbashkët” (*The Week in Germany*, January 10, 1992).

Kjo letër asht me ju kujtue me dashamirësi se një prej shteteve pasuese të Jugosllavisë që po shpërbahet asht Kosova, e cila asht themelue në Republikë të Kosovës në Shtatuer-Tetuer të këtij vjeti.

Siç e dini me siguri, Kosova vijon me u drejtue prej qeverisë serbe si krahinë serbe, megjithëse 90 për qind e popullsisë së saj janë shqiptarë shqipfolës. Nuk asht nevoja me i theksue egërsitë mizore ba prej qeverisë serbe kundër kosovarëve, pse përgjithtas po dihen. Mjafton me përmendë këtu rastin e një ish-gjykatësi rrethi të motnuem, arrestue dhe rrahë për dekë prej policisë serbe në Nanduer 1991. Apeli ynë për ju asht që dëshira e shprehun e ma se dy milionë kosovarëve të njihet prej qeverisë së Shteteve të Bashkueme.

Shqiptaro-amerikanët po ashtu e mbështesin referendumin për autonominë e shqiptarëve të mbajtur prej shqiptarëve që jetojnë në republikën e Maqedonisë, dhe përbajnë ma shumë se çerekun e popullsisë së asaj republike.

Na gjithashtu dëshirojmë me sjellë në vëmendjen tuej rastin e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh që jetojnë në Republikën e Malit të Zi. Të privuem kaherë prej të drejtave tyne bazike, shumë prej këtyne njerëzve i kanë lanë trojet e tyne, kund 20.000 janë vendue në Shtetet e Bashkueme.

Në krejt këto tri republika, çka dikur ka qenë Jugosllavi, shqiptarët janë trajtue si qytetarë të dorës së dytë. Abuzimi i të drejtave tyne civile dhe njerëzore ma së paku duhet me përfundue.

Parashtroi me nderime,

Arshi Pipa
Kryetar i VATRËS

SHTOJCË^c

Mbi VATRËN dhe *Diellin*

Në Verën e 1991 u zgjodha kryetar i VATRËS, Federatës Panshqiptare të Amerikës, themelue në 1912. Pa qenë anëtar i asaj organizate, kam qenë kontribuues i zellte i organit të saj, *Diellit*. E dija se VATRA ka të meta serioze në organizim, të cilat i kam diskutue në dy artikuj të gjatë botue në Dielli, “Për riorganizmin e VATRËS” (16 Gusht 1983), dhe “Për shpëtimin e VATRËS” (28 Fruer 1987). Prej një delegacioni që më kontaktoi në Fruer 1991, mora vesh se editori i *Diellit* ishte mbështetës i regjimit stalinist shqiptar. Më dftuen një numër të *Diellit* mbushë me artikuj e materiale dokumentative mbi ployën e Kosovës, por mezi m’xûnë në gojë situatën tragjike të dheut amë tue nënvizue eksodin parak të qytetarëve shqiptarë. Nji sjellje e tillë ishte dyherash e metë; dallimi ndërmjet Shqipnisë dhe Kosovës tue marrë anën e kësaj të mbrames në dam të pjesës tjetër të Shqipnisë etnike, në të njejtën kohë përkrahte propagandën e klikës së Tiranës që donte me e ndikue diasporën shqiptaro-amerikane për mos me ba ndonji kritikë ndaj saj. Për shkak të asaj propagande, diaspora u përça, siç dëshmohej prej demonstratave në New York, ku ato që u prînë prej VATRËS kundër regjimit të Tiranës mbanin flamurin shqiptar me një birë të djegun bash te vendi i yllit të kuq Marksist-Leninist, ndërsa demonstratat kosovare prî prej një demagogjie të squetë protestuen ndaj barbarizmit serb tue valëvitë flamuj me yllin internacionalist. Në një kohë që krejt vendet komuniste të Europës Lindore, tue përfshî Bashkimin Sovjetik por tue përjashtue Shqipninë, po zhbanin hovshëm regjimet e tyne staliniste, një pjesë e konsiderueshme e diasporës shqiptaro-amerikane kishte ngadhënjye mbi propagandën e Tiranës. Drejtues fetarë thurën lavdata për arritjet e Shqipnisë së Enver Hoxhës, dhe personalitete të VATRËS vizituen nxanësin e tij

Ramiz Alinë, tue e komplimentue atë për mençuninë e tij si burrë shteti.

I gjendun përballë kësaj situate, me gjysë zemre pranova me garue për kryesinë e VATRËS në zgjedhjet e Verës 1991, mbasi e kthjellova se arsyeja ime vendimtare pse po e baja këtë ishte për me i ba VATRËN dhe *Diellin* si leva demokratike për me përshpejtue rrëzimin e regjimit të lëkundshëm shqiptar, ndërkohë që me mbështetë përpyekjet e kosovarëve për vetëpërcaktim siç pat veprue *Albanica* me numrin e posaçëm kushtue problemeve ë Kosovës.

E dija që përfshimja ime me VATRËN kishte me m'i damtue përlllogaritë e mia kohore sa i takon publikimit të *Albanica*-s si e përkatërmuejshme. Ajo çka nuk dija dhe zor se e kisha pritë, ishte se tue u përpyekë me vû pak rënd në punët e VATRËS kisha me përfundue tue i kushtue krejt kohën time asaj. Dyshoj nëse financat e saj janë auditue ndonjiherë. Dhe në dekadën e përparshme *Dielli* ka mbijetue me lëmoshat e njerëzve dhe të editorëve të papaguem. Pika e dobtë ishte menaxhimi. Në dosjen time të trashë të VATRËS, një letër e datës 1 Marc, 1984 drejtue Harry Stoiias, atëherë kryetari i VATRËS, kritikonte paaftësinë tronditëse të menaxherit të *Diellit* – ky person tevona u ba kryetari i VATRËS. Nji letër e nji të pajtuemi, e datës 25 Prill 1991, e sqaron ma mirë shkallën e keqmenaxhimit:

Të Dashtun miq, e kam në mungesë shumë *Diellin*, sidomos kur kam pague aq shumë dhe kam marrë aq pak... Për vitin 1989 kam marrë [6] numra. Për 1990 kam marrë vetëm [3]. A ka pasë të tjerë? Për habi, çeku im i 2 Marcit 1989, nuk asht depozitue në llogarinë tuej... deri më 28 Jan., 1991 – pothuej dy vjet ma vonë.

E shkrueme prej nji ish misionari fetar në Shqipni, ajo letër u pat botue në numrin Gusht-Shtatuer të *Diellit* me shënimin: “Kjo letër po botohet për anëtarët e VATRËS

për me mësue mbi neglizhencën skandaloze nga ana e kryesisë dhe *laissez faire* nga ana e Bordit të Nëpunësve”. Shënimi mund t’i ketë idhnue ish-nëpunësit që u rizgjodhën për me shërbye për 1991-92, vitin e kryesisë sime në VATËR. Ban vaki edhe kështu. Në mungesë të një editori dhe sepse kisha me udhëtue jashtë, ia besova drejtimin e *Diellit*, numrin Tetuer-Nanduer, një grupi prej tre nëpunësish, njëni prej të cilëve ishte sekretari i VATRËS. Rezultati ishte një ngatërresë e shëmtueme simbas shabllonit të një tabloidi shqiptar botue në New York. Mbas kësaj përvoje të idhtë, vendosa me vijue i vetëm si editor derisa të gjehej një person kompetent. Por, kurrkush s’u gjet. Për atë pozicion pati pak aplikime, dhe asnjëni prej tyre nuk i përmbushte pritshmënitë e komisisë *ad hoc*. Dhe përfundova tue editue krejt shtatë numrat e mbetun.

Ishte e qartë, shkak ishte ngurresa e VATRËS për me pague qoftë edhe një rrogë modeste. Më patën thanë se numri i pajtimtarëve e tejkalonte njëmijshin. Nëse vërtet kështu, aty tepronin mjaft parë sa për një rrogë të përshtatshme. Mbas përpjekjeve të kota për me e ndreqë situatën, zbulova se lista e adresave ishte e vjetrueme dhe nuk ishte përditësue motit. Një kopje u pat kthye me një shënim me shkrim të kuq: “Pash hatrin e Zotit, boll e postuet këtë! robi ka vdekë kaherë”. Meqë vetëm pak kopje u kthenin, dukej se të pajtuemit po e merrnin gazetën. Vetëm ma vonë, mbasi punësuem një firmë nga Bostoni specializue në shërbimet postare, mora vesh se pjesa ma e madhe e të pajtuemve nuk i kishin pague qyshkur detyrimet. Ndër 1347 emna të rënduem alfabetikisht në një shtypshkrim të kompjuterizuem, ma pak se një e katërta ishin pajtues që kontribuonin. Kjo i bjen si me thanë, se *Dielli* ishte një gazetë anakronike. Ndërkaq, kanunorja e VATRËS vazhdonte me qenë ajo që kishte rishqyrtue Konitza në 1926. Emni i saj me të mëdhaja si Federata Panshqiptare e Amerikës, përnjimend për dy dekadat e para të ekzistencës së federatës, tash ishte pesë me hiç. Një Fond Studentësh

nga VATRA në fillimet e gjashtëdhjetave (diskutue prej meje në dy numrat e *Diellit* të Marcit 1961) nuk e prodhoi një Doktor në një të tretën e shekullit. Kryeletra e VATRËS mbante si adresë të “selisë së saj qendrore”, – ky togfjalësh ishte i gabuem, – zyrën e vjetër të VATRËS quejtë seli qendrore ndërkohë që kishte prâ s’këni kur një zjerm pat damtue ndërtesën e Kishës Orthodokse në të cilën bante pjesë edhe zyra. E tash selitë qendrore, nëse ndokush ka dëshirë me e përdorë këtë togfjalësh, le t’i gjejë në ndonji skutë papafingosh të depos që ka në pronësi Kryetari i Nderit të VATRËS. Përshkrimi i *Diellit* në faqen e parë të gazetës si “gazeta shqipe më e vjetër në botë” ishte një ekzagjerim tjetër (e korrigjoj) prejse kishte fletore edhe ma të vjetra se *Dielli*. Edhe ma domethanëse për ramjen e VATRËS, ishte se anëtarësia e saj në zonën e Bostonit u pat tkurrë në një numër të paktë të moshuemish, ngaqë shumica e shqiptarëve bostonas ishin bashkue me organizatën kundërshtare të VATRËS, LIRIA. Roli i VATRËS si institucion kulturor u paksue ndieshëm në dy dekadat e fundit. Shqiptarët e sapoardhun, kryesisht prej Malit të Zi dhe Kosovës, nuk janë anëtarësue. Dhe për sa i takon aktiviteteve kulturore në nivel akademik, VATRA pat sponsorizue vetëm tri në 33 vjet: një seminar në Boston në Tetuer 1960 me pjesëmarrjen e Nolit, organizue nga Peter Prifti; një tjetër me rastin e 60-vjetorit të *Diellit*, ujdisë prej Hamdi Oruçit në Tetuer 1969; dhe një të tretë mbledhë prej Fr. Arthur Liolin në Shtatuer 1982. Ndokush s’ka çka me pritë ma tepër prej një organizate ku Bordi i Nëpunësve dhe anëtarët e Bordit, krejt bashkë njizetë kur unë u bana kryetar i VATRËS, ka vetëm tre a katër vetë me arsim të naltë.

Përpyekja për me e ndreqë këtë situatë kulturore dhe politike në një vjetë, periudha kohore që i caktova vetes për atë qëllim, asistue prej dy nënkryetarësh të zgjedhun për me nda barrën e drejtimit, ishte nisjativë e rrezikshme. Sidoqoftë e mora atë rrisk. Gjaja e parë për mue ishte me udhëtue në Boston aty ku botohej *Dielli*. Qortova bocat e

numrit të parë të gazetës, të cilat i kisha redaktue, dhe vizitova shtypshkrojtjen që shtypte dhe shpërndante gazetën. Mandej kontaktova disa ish nëpunës të VATRËS, përfshî edhe Z. Anthony Athanas, Kryetarin e Nderit, të cilit i shpreha dëshirën time për me vizitue depon e tij që mbante sendet e VATRËS në përkujdes të tij. Gjaja tjetër që bana, ishte me sigurie një zyrë në Manhattan, në sajë të mirësjelljes së Z. Marian Cubi, për degët e New York-ut dhe të New Jersey-t ku jetonin shumica e donatorëve të VATRËS dhe pajtimtarët e *Diellit*. Mbrapa vijova me e ndryshue thelbsisht përbamjen e Bordit. Në kohën kur u largova prej VATRËS, bordi i saj i Nëpunësve përfshinte një Sekretarë për Organizatën e Grave të VATRËS, një Sekretarë të Rinisë së VATRËS, dhe një Sekretarë për degët e New York-t dhe New Jersey-t. Nandë anëtarë të Bordit kishin diplomë universiteti. Bordi takohej pothuajse krye mueji dhe procesverbalet ma të randësishme të takimeve publikoheshin në *Dielli*.

Ndryshimet në drejtim dhe në Bordin e Nëpunësve u pasqyronin në shtyllat e *Diellit*. Botimi i numrit të Korrikut pat vû sinore midis zellnikëve të Kosovës që kishin ba njerëz vesh shurdh për gjimimet e njerëzve të anijes së Shqipërisë dhe kritikës së *Diellit*, që e fajsonte klikën staliniste të Tiranës për një asî fatkeqsie kombtare të turpshme, e në të njëjten kohë tërhiqte vëmendjen mbi ployën e Kosovës; krejt faqja e parë i kushtohej “Krizës së Kosovës” dhe një artikull, “Albanian in Macedonia Are Deprived of Representation” [*Shqiptarët e Maqedonisë janë të papërfaqsuem*], u botue në faqet 4 dhe 5. Një ribotim i artikullit tim të 1983, “Për riorganizimin e VATRËS”, u ballafaq me problemin kulturor, tue propozue një program për rijetëzimin e VATRËS. Numri përfshinte disa artikuj prej shkrimtarëve të rij shqiptarë disidentë. Pjesa në anglisht në *Diellin* dygjuhësh u paksue, një pasaktësi u ndreq në numrin pasardhës. Për shkak të gjuhës së përdorun letrare, editorialet, njoftimet zyrtare, rubrika “*Dielli Post*”, një pjesë e artikujve dhe e

procesverbaleve të takimeve ishin në gegënishten letrare ndërsa pjesa tjetër në toskënishten letrare, veprim i VATRËS kësisoj për mos me përfillë vendimet e qeverisë së Tiranës për me ndaluar përdorimin e gegënishtes letrare.

Numri i Korrikut 1991 i *Diellit* gjithashtu përmban një lajmim sa i takon drejtimin të gazetës. Mund të duket e çuditshme për joamerikanët se editori i *Diellit*, qysh në fillimet e VATRËS, nuk ka qenë pjesë e Bordit të Nëpunësve, çka përfshin kryetarin, xhëvëndskryetarin, sekretarin, menaxherin dhe arkëtarin, dhe ka pasë statusin e një punojësi. Për ma tepër, editori përzgjidhej prej Bordit të Nëpunësve e nuk zgjedhej si nëpunësit në kuvendin e përvitshëm të VATRËS. Metoda e përzgjedhjes shpesh ishte torturuese, tue u varë ma shumë prej favoritizmit sesa prej meritës. Ai që kishte ndikim ma të madh në lidhje me këtë ishte Kryetari i Nderit të VATRËS, i cili i njohun si pajtori i VATRËS, ndihmonte me subvencione bujare.

Ai më pat kontaktue mue kah fundit i pesëdhjetave, kur unë punoja si kashier në një hotel në New York. Dhe ma vonë, gjatë një pikniku të VATRËS, ku në atë kohë jepja mësim në Georgetown University në Washington D.C. Ai më ofroi një rrugë të majme nëse kisha me pranue me u ba editor i *Diellit*. Ai u duk sikur u fye kur i thashë se e konsideroja drejtimin e *Diellit* si shërbim ndaj kombit, jo si punë me ba parë.

Kështu filloi, mendoj, mospëlqimi i tij ndaj meje i cili pasoi me një shfaqje dramatike në zgjedhjet e VATRËS së 1991. Kur u numëruen votat dhe unë u shpalla fitues tue mposhtë kandidatin e tij, ai u ndërkye dhe iku, tue deklarue se ai nuk donte me pasë ma kurrfarë pune me VATRËN. Pa më ba përshtypje reagimi i tij, i shkrova një letër këshilluese, dhe fill mbrapa, i shoqnuem prej Harry Stoiat, arkëtarin e VATRËS e ish-kryetar, shkova dhe e vizitova në shtëpinë e tij në Boston, ku ai po lëngonte prej një kambe të aqun.

Kur bordi i VATRËS vendosi, mbas propozimit tim, për me kremtue një simpozium me rastin e 80-vjetorit të themelimit të VATRËS, i shkrova Z. Athanas një tjetër letër, tue i kujtue dëshirën time për me pasë një inventar mbi trashëgiminë e VATRËS që ishte nën kujdes të tij. Mendimi im ishte se mes atyne sendeve mund të kishte materiale dokumentare, që mund të hidhnin dritë të re mbi historinë e diasporës shqiptaro-amerikane dhe mbi historinë e Shqipnisë *tout court*, meqë dihej se shumica e atyne sendeve i përkisnin Konitzës, Ministrit të Shqipnisë në Washington. Tue qenë se nuk mora përgjegje, ngrita çështjen e punësimit të një avokati në takimin me Bordin. Vendimi im u duk se dha efekt. Pak kohë mbrapa, Z. Athanas la me kuptue se ai kishte dëshirë me e plotsue kërkesën e VATRËS. Më 4 Prill, 1992 dy delegatë të VATRËS udhëtuen për në Boston. Z. Athanas i priti ata për zemërsisht dhe i shoqnoi ata te depoja e tij në Swampscott, quejtun General Glover House. Se çka gjeten ata atje dhe në çfarë kushtesh, drue se me e kallzue kisha me ia rikallë mninë Z. Athanas. Nji studiuesi shqiptar që i kërkoj me e pá depon e tij, ai iu gjej: “S’kemi asgjë prej Konitzës, përpos disa dokumenteve pa randësi të VATRËS”. Se a janë të parandësishme a jo, unë do të la lexuesin me e vendosë mbas leximit të materialeve të panjohuna prej dosjes së Konitzës, të cilat i ka botue së mbrami Dr. Klosi në antologjinë e tij *Quo vadis, Shqipëri?* Ose artikullin e Klosit në këtë numër,¹⁷⁸ i cili përmban një inventar paraprak të gjetjeve të tij.¹⁷⁹

^{178*} Pipa i referohet *Albanica* 3-4, 113-20. Kudo që numri rendor në nënvijë ndiqet me yllth, nënkupton se janë shënime të përkthyesit.

¹⁷⁹ Po rendisim këtu gjetjet ma të randësishme. Dosja Konitza përmban letra, përkthime; një bllok të Konitzës (?) me shënime gjuhësore; një skedar librash mbi njerëzit e shquem të kulturës e të politikës; tre dorëshkrime nga Kostë Chekrezi; arshiva të VATRËS për 1910, 1916-20, 1935-36; koleksione të lidhuna të *Diellit*, qysh prej 1926; sasi kopjesh nga Konitza (*Nën hijen e*

Klosi citon fjalimin e Nolit në përkujtimoren e Konitzës (7 Marc, 1943):

There has been a rumor that we have not taken care of Konitza's library. This is not true... Mr. Vasil Pani and Mr. Peter Tyko went to Washington and packed the library into thirty-two wooden boxes, which they stored in VATRA's name at the Fidelity storage in Washington... [T]he library will remain there until the end of war, when it will be sent to Albania, according to Faik Konitza's expressed desire.¹⁸⁰

Dhe Klosi komenton: “32 arka që sot s’kanë lënë pothuaj asnjë gjurmë, me përjashtim të atyre pak të mbeturave të depos së Swampscott. Mënyra sesi është sjellë me trashëgimin e Konitzës... ka lënduar jo vetëm një pasuri kulturore shqiptare, por edhe amanetin e vetë shkrimtarit”.¹⁸¹

Artikulli i Klosit mbi VATRËN përfshin dy tekste të Konitzës. I pari asht një paragraf prej artikullit të Diellit, i datës 7 Korrik 1922, tjetri një letër drejtue VATRËS, e datës 14 Gusht, 1940. Paragrafi i *Diellit* asht një përshkrim përmendor i kontributit të VATRËS mbi çështjen shqiptare përgjatë periudhës së artë të VATRËS, ndërsa letra asht një keqardhje e ndieme për ramjen e VATRËS. Ai ishte ngj boll me ngatërresat shkatërruese të komunitetit shqiptar. Ai e kërkoi shpërbamjen e VATRËS. Mbasi vegjetoj për një pesë vjet të tjera, organizata muer do transfuzion gjaku prej emigrantëve politikë, që lanë vendin amë për me i shpëtue

hurmade), Noli (*Album, Don Kishoti i Mançës*), Kayiam (*Rubaiat*), Camaj (*Rrathë, Njeriu më vetee me të tjerë*), Logoreci (*The Albanians*), Fehime Pipa (*Elementary Albanian*), *The Albanian Struggle in the Old World and New* etc.

^{180*} Khs. *Al.*, 3-4, 119-20. L.K.

^{181*} *ibid.*, 120. L.K.

persekutimit komunist. VATRA mbijetoi si trup i sëmudë që lëngonte prej pafuqisë të moshës së shtyeme. Kur u ndodha përballë drejtimit, ishte pa' kthye në një që po jepte shpirt e mezi ecte. S'do të kisha pranue kurrë me e sherue një kufomë të gjallë! Ngushëllimi im asht që me u përpjekë me e ringjallë VATRËN; isha i dobishëm në shpengimin e Konitzës, dënue prej stalinizmit shqiptar me vdekje intelektuale përmes harresës. Plani im për simpoziumin që me përkujtue 80-vjetorin e themelimit të VATRËS, ishte gjithashtu për me nderue Konitzën me rastin e pesedhetëvjektorit të tij të vdekjes. E ndieja për detyrë për me e ba këtë po ashtu, sepse emni i kësaj të përkohshme' nuk asht pothuaj rasti që përngjet me të përkohshmen e Konitzës.

Punimi im mbi Konitzën, botue në numrin e Prillit 1944 të *Kritikës*, mbyllet me pohimin e maposhtëm:

Na duket, ndërmjet atyne dy poleve të kombit
qi janë gega e toska, se i pari përban ma tepër
landën, brumin e shqiptarit dhe i dyti trajtën,
frymën. Dhe në se gjejmë ma të madhin
përfaqësues të gegnís te Fishta, ndeshim
kulmin e faqes tjetër, jo te Naimi, jo te Noli,
por te Konica.¹⁸²

I përktheu nga anglishtja: Lisandri Kola.

Marrë nga: *Albanica*, 1^a (Winter 1990), 146-151; *Albanica*, 2^b (Spring 1991); 181-2; *Albanica*, 3-4^c (Winter 1992), 214-20.

^{182*} Shih *Kritika*, 2 (Prill, 1944), 46.



- Optikon

- Alexis Elizabeth Junçaj

- **Avi Patel**

- Maria Mejia

- **Selma Zuhrić**



Optikon presents a selection of the students' contributions [AY 2021-22] on the *Albanian Literature of Exile* course, instructed by L. Kola, at the University of Michigan, Ann Arbor, on the work of Arshi Pipa. These articles focus on analyzing Pipa's critical essays, mainly on Kosovo (Alexis Elizabeth Junçaj, *The Era Before The War*; Selma Zuhrić, *Kosovo in Question*) and the political situation during the communist regime in Albania (Avi Patel, *The Darkest Era in Albanian History*). This selection also includes an interesting observation of Pipa's review of E. H.'s *Titoites* (Maria Mejia, *Analysis of Arshi Pipa's 'Enver Hoxha, The Titoites'*).

THE ERA BEFORE THE WAR¹⁸³

During the War in Kosovo, like other genocides in human history, the aggressor gradually dehumanized and built a genuine disdain for an ethnic group that ended in the desire to exterminate them. In this research paper, we will investigate the tension between Serbia and Kosovo before the war and genocide that took place in the late 1990s. Albanian scholar Arshi Pipa dissects the era leading up to the Kosovo war in his 1989 academic, socio-political journal, "The Political Situation of the Albanians in Yugoslavia, With Particular Attention to the Kosovo Problem: A Critical Approach." This research paper will reflect on the writing of Pipa using his opinion, prior to the ethnic cleansing of Kosovar Albanians, to expose the shortcomings in the prevention of the Kosovo War. The research, along with Pipa's observations compiled in this piece, presents two recurring themes that could have influenced the ethnic cleansing of Albanians in Kosovo. The first theme examines who can claim victimhood in this conflict, while the second theme questions Serbia depriving Kosovo of republic status and preventing it from merging with Albania.

For brief context, the tension between ethnic Albanians of Kosovo and Serbians began once the Turks left Kosovo, however it wasn't until 1966, when Aleksandar Ranković fell from the power, that Kosovars vocalized their discontent that Kosovo wasn't a republic. Unlike Macedonia and Montenegro, the 1974

¹⁸³ Reflection on A. Pipa, "The Political Situation of The Albanians in Yugoslavia, With Particular Attention to The Kosovo Problem: A Critical Approach." *East European Quarterly*, 23(2), 1989, 159-81.

constitution recognized Kosovo as a federal unit without making it a republic. When former Yugoslavia was within reach of economic collapse, the youth and intellectuals of Kosovo were persistent in their yearning for liberation from the Serbian state. However, the Serbian state repressed their desire which amplified Kosovar nationalism, uniting the people to reciprocate. Consequently, in the spring of 1981, these individuals ensued violent demonstrations across Pristina demanding more autonomy. The protestors were met with war tanks and machine guns sent by the Serbian state to repress their demands (Pipa).

